

Plani i Menaxhimit të Mbeturinave Komuna e Drenasit 2015–2020

Përgatitur nga Grupi Punues i Komunës së Drenasit, me mbështetjen
e projektit për ShQK të GIZ-së dhe Fondacionit për Autonomi dhe
Qeverisje Lokale, FLAG

Drenas–Glllogoc

Parathënie nga Kryetari i Komunës	4
Mirënjohje	6
Shkurtesat.....	7
Përkufizimet e Mbeturinave	8
1 Hyrje dhe konteksti nacional për menaxhimin e mbeturinave	11
1.1 Qëllimi i planit	11
1.2 Historiku kombëtar i menaxhimit të mbeturinave	12
1.3 Politikat, strategjia dhe korniza ligjore kombëtare	13
1.4 Rolet dhe përgjegjësitë në nivel rajonal dhe lokal.....	15
2 Konteksti lokal, korniza strategjike dhe profili i komunës	16
2.1 Konteksti lokal i menaxhimit të mbeturinave.....	16
2.2 Korniza strategjike lokale	17
2.3 Profili i komunës dhe analiza e situatës.....	18
2.4 Organizimi i menaxhimit të mbeturinave.....	19
2.5 Sasitë dhe përbërja e mbeturinave.....	20
2.6 Mbledhja dhe transportimi i mbeturinave, praktikat, stafi dhe asetet	22
2.7 Trajtimi dhe riciklimi i mbeturinave.....	26
2.8 Tërheqja dhe deponimi i mbeturinave.....	27
2.9 Analiza financiare e sistemit të tanishëm të menaxhimit të mbeturinave	28
2.10 Buxheti komunal për mbeturinat.....	33
3 Analiza SWOT	34
3.1 Përmbledhje e pengesave dhe fyteve të ngushta kryesore.....	34
3.2 Situata institucionale për menaxhimin e mbeturinave	36
3.3 Sasitë dhe përbërja e mbeturinave.....	37
3.4 Mbledhja dhe transporti i mbeturinave.....	38
3.5 Trajtimi dhe riciklimi i mbeturinave, ndarja e mbeturinave në lloje në vend krijim	40
3.6 Deponimi përfundimtar i mbeturinave.....	43
3.7 Financimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave.....	44
3.8 Ndërgjegjësimi.....	45
4 Planifikimi i menaxhimit të mbeturinave	47
4.1 Fushëveprimi i planit (përkufizimi hapësinor dhe i përkohshëm, objektivat e mbeturinave).....	47
4.2 Planifikimi strategjik (vizioni dhe objektivat)	47
4.2.1 Vizioni.....	47
4.2.2 Objektivat.....	48

4.3	Plani i punës	49
4.3.1	<i>Identifikimi dhe skanimi i opsioneve (komponentët e MN-së)</i>	49
4.3.1.1	Opsionet për zgjerimin e shërbimit dhe pajisjet për mbledhjen e mbeturinave	49
4.3.1.2	Monitorimi i mbeturinave	50
4.3.1.3	Riciklimi.....	50
4.3.1.4	Kompostimi.....	52
4.3.1.5	Masat e korigjimit për deponitë ekzistuese.....	52
4.3.1.6	Menaxhimi i rrjedhave të tjera të mbeturinave	53
4.3.1.7	Mbeturinat e ndërtimit dhe rrënimit.....	53
4.3.1.8	Mbeturinat e rrezikshme	53
4.3.1.9	Mbeturinat mjekësore.....	53
4.3.1.10	Mbeturinat shtazore.....	53
4.3.1.11	Struktura institucionale.....	54
4.3.1.12	Vetëdijesimi dhe pjesëmarrja publike	54
4.3.1.13	Financimi i shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave	54
5	Matrica e planit të punës, temave të planit, objektivat, treguesit, të dhënat, programet dhe masat	57
6	Plani financiar dhe i veprimit për planin afatshkurtër dhe afatmesëm	62
6.1	Planifikimi financiar, kontribuuesit, aktorët, partnerët, grupet e synuara dhe kohëzgjatja	62
7	Monitorimi dhe rishikimi	68
8	Referencat.....	70
9	Shtojca 1. Planet e veprimit (për masat).....	72
10	Shtojca 2: Fotografi nga punëtoritë e mbajtura më 2 korrik dhe 16 dhjetor të vitit 2015.....	86
11	Shtojca 3: Lista e njerëzve që i kanë kontribuar përpilimit të planit të MMN-së të Drenasit	88
12	Shtojca 4: Vendimi i Këshillit Komunal të Drenasit për Planin Komunal të Menaxhimit të Mbeturinave, Komuna e Drenasit 2015–2020	89

Parathënie nga Kryetari i Komunës

Të nderuar qytetarë të Drenasit dhe të nderuar lexues,

Plani i Menaxhimit të Mbeturinave që ju prezantojmë në këtë botim është i një rëndësie të veçantë për komunitetin e Drenasit. Ky plan përmbledh aspiratën tonë për mjedis të pastër e të shëndetshëm, me komunitet që redukton mbeturinat dhe riciklon çdo ditë, që përdor burimet në mënyrë të qëndrueshme, duke inkurajuar ekonominë e gjelbër. Këtë aspiratë të bashkësisë së Drenasit do ta arrijmë bashkërisht, duke ndërmarrë hapat për ta përmbushur atë.

Komuniteti dhe komuna jonë janë të angazhuar që nëpërmjet këtij plani t'i kontribuojmë zbatimit të politikës së BE-së dhe arritjes së objektivave kombëtare të Republikës së Kosovës për mbeturinat, mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin e njerëzve dhe për ndjekjen e hierarkisë së mbeturinave. Në këtë mënyrë reduktojmë sasinë që prodhohet dhe që shkon në deponi dhe nëpërmjet një menaxhimi të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm të mbeturinave, adresojmë sfidat e ndryshimit të klimës dhe uljen e gazrave që hidhen në atmosferë.

Ky plan është kontribut i Këshilli të Partneritetit për një Mjedis të Shëndetshëm, i cili gjatë procesit të planifikimit identifikoi dobësitë dhe avantazhet e komunitetit tonë dhe të shërbimit aktual të mbeturinave, analizoi me kujdes skenarët për t'i dhënë zgjidhjet më efektive si dhe përpiloi vizionin dhe objektivat që synojmë të arrijmë për të zhvilluar një shërbim modern dhe të qëndrueshëm të mbeturinave.

Këshilli i Partneritetit për një Mjedis të Shëndetshëm u institucionalizua si një organ këshillues i Komunës sonë për hartimin e planit, këshill i cili mbajti një sërë takimesh dhe planifikon të tjera në vazhdimësi, duke i kontribuar kështu jo vetëm planifikimit, por edhe zbatimit dhe monitorimit të planit. Gjatë gjithë procesit të hartimit të Planit, Komuna e Drenasit dhe anëtarët e Këshillit të Partneritetit patën mbështetjen e vazhdueshme të GIZ dhe FLAG. Në përpilimin e Planit janë përfshirë dhe kanë dhënë kontribut përfaqësues të Kuvendit Komunal, përfaqësues të institucioneve publike në komunë, specialistë të fushës nga komuniteti dhe organizata të shoqërisë civile.

Ndihemi krenar për angazhimin jo vetëm të institucioneve, por edhe të komunitetit, duke dhënë mendime për problematikat e shumta dhe duke propozuar zgjidhje, të cilat finalizohen

me shumë profesionalizëm nga grupi i punës së Komunës, GIZ dhe FLAG, të cilët kanë dhënë një ndihmesë të vazhdueshme për realizimin e këtij plani.

Si rezultat i kësaj pune dhe bashkëpunimi të vyer, kemi përpiluar Planin tonë që përmban vizionin, qëllimet dhe objektivat tona dhe 73 masa që synojnë menaxhimin bashkëkohor të mbeturinave duke na bërë pjesë të përpjekjeve globale në ruajtjen e mjedisit për brezat që vijnë.

Jemi të vetëdijshëm se zbatimi i këtij plani ambicioz është një sfidë e madhe dhe kërkon mbështetje të vazhdueshme politike, financiare, fuqizim të kapaciteteve organizative dhe njerëzore të komunës dhe ne jemi të gatshëm të ofrojmë mbështetjen e plotë të komunës. Ne inkurajojmë qeverinë, donatorët dhe shoqërinë civile të na mbështesin në arritjen e objektivave të planit dhe realizimin e misionit të komunës për ofrimin e shërbimeve cilësore dhe krijimin e kushteve për mirëqenie të qytetarëve tanë.

Ndërkohë ne do të punojmë për të rritur në vazhdimësi kulturën e ndarjes në burim të mbeturinave, mbështetjen ndaj iniciativave reduktuese dhe ricikluese, si dhe inkurajimin e një qytetarie aktive dhe partneriteteve të qëndrueshme me komunitetin dhe biznesin, si dy aktorët kryesorë në realizimin me sukses të planit.

Komuna e Drenasit më këtë plan shpreh jo vetëm angazhimin për të trajtuar mbeturinat si burim dhe vlerë për komunitetin, por dhe gatishmërinë për të marrë në konsideratë çdo zhvillim dhe prioritet kombëtar dhe rajonal që i kontribuon një komune të pastër, të çliruar nga mbeturinat dhe tërheqëse për vizitorët.

Ju faleminderit,

Z. Nexhat Demaku

Kryetari i Drenasit

Mirënjohje

Ky publikim është pjesë e projektit Shërbime Komunale të Qëndrueshme (SMS, Menaxhimi i Mbeturinave), nëpërmjet të cilit FLAG dhe GIZ kanë ndihmuar në hartimin e Planeve të Menaxhimit të Mbeturinave (PMM) të pesë Komunave në Kosovë: Drenas, Gjilan, Pejë, Mitrovicë dhe Prishtinë. Këto plane u përpiluan së bashku me stafin e komunës përmes ofrimit të trajnimit mbi planifikimin strategjik, i cili fuqizoi kapacitetet e stafit lokal për të hartuar dhe për të monitoruar PMM, përfshi plane veprimi, organizative dhe financiare për komponentët e tyre.

Hartimi i këtij Plani është fryt i kontributit shumëpalësh të hisedarëve të komunitetit të Drenasit, udhëhequr në këtë përpjekje nga Kryetari i Komunës, Z. Nexhat Demaku dhe Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë, Znj. Hyrije Xhemajlaj -Thaçi, koordinatori i Planit Z. Afrim Prokshi, me mbështetjen e Znj. Drita Binaj, GIZ, kanë ndërmarrë koordinimin dhe organizimin e punës.

Skuadra e FLAG, Alba Dakoli Wilson, Artan Rroji dhe Dr. Iain Wilson, kanë ndërmarrë udhëheqjen metodologjike dhe lehtësimin e takimeve për rrahjen e ideve dhe identifikimin e sfidave, objektivave dhe masave. Redaktimi i dokumentit të planit përfshin kontributin e dhënë nga Ridvan Sokoli.

Kontribut të vyer në mirë-ecurinë e organizimit gjatë gjithë procesit ka dhënë Drita Binaj, Specialiste e GIZ për Menaxhimin e Mbeturinave.

Shkurtesat

AMMK	Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
DShPE	<i>Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë</i>
FLAG	Fondacioni për Autonomi Vendore dhe Qeverisje
GIZ	<i>Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit</i> (Shoqëria për Bashkëpunim Ndërkombëtar)
KEDS	Kompania Kosovare për Distribim dhe Furnizim me Energji Elektrike
KMD	Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë
KRM	Kompania Rajonale e Mbeturinave
MM	Menaxhimi i mbeturinave
MMN	Menaxhimi i Mbeturinave të Ngurta
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MN	Menaxhimi i Mbeturinave
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PKMMN	Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave të Ngurta
PMMN	Plani i Menaxhimit të Mbeturinave të Ngurta
QRA	Qendra e Regjistrimit të Automjeteve
ShQK	Shërbimet e Qëndrueshme Komunale
SWOT	Përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet
TIK	Teknologjia e Informimit dhe Komunikimeve
ZhEL	Zhvillimi Ekonomik Lokal
ZRRUK	Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim

Përkufizimet e Mbeturinave

Përkufizimet që janë përdorur në këtë dokument janë ato që janë përdorur në Ligjin Nr. 2012/04-L-060 për Mbeturinën.

Bio-mbeturinë – mbeturinat biodegraduese nga kopshtet, parqet, ushqimet dhe mbeturinat e kuzhinës nga familjet, restorantet, objektet turistike, shitoret me pakicë dhe mbeturinat e ngjashme nga impiantet për përpunimin e ushqimit

Deponi – vendi i caktuar dhe rregulluar për mbeturina, ku do të vendosen mbeturinat nën apo mbi sipërfaqe të tokës

Deponim përfundimtar i mbeturinave – operimet të cilat ofrojnë zgjidhje përfundimtare për mbeturinat të cilat nuk mund të ripërdoren apo përpunohen, duke mos rrezikuar mjedisin apo shëndetin e njeriut¹.

Deponim – çdo operim i cili nuk është përpunim, as në rastet kur operimi ka për pasojë sekondare rikuperimin e substancës apo energjisë²

Kompostim – trajtim i mbeturinave të biodegradueshme nën veprimin e mikroorganizmave në prezencën e oksigjenit, i cili kryhet me qëllim të prodhimit të kompostit nën kushte të kontrolluara

Konsumator – personi i cili ka lidhur kontratë për shërbime me ofruesin e shërbimeve ose merr shërbime të caktuara sipas Ligjit Nr. 04/L-060 “Për Mbeturinën”, Republika e Kosovës

Kullim – (leachate) çdo lëng që rrjedh ose i shpërlarë nga mbeturinat e deponuara dhe që shkarkohet nga deponia ose gjendet brenda deponisë

Liçenca për menaxhimin e mbeturinave – leje me shkrim e cila lëshohet me vendim të Ministrisë, me të cilën vërtetohet se janë plotësuar kushtet sipas Ligjit Nr. 04/L-060 “Për Mbeturinën”, Republika e Kosovës

Mbeturinë – substancë apo objekt që prodhuesi apo zotëruesi e hedh, ka për qëllim ta hedhë apo është i detyruar ta hedhë

Mbeturina industriale – mbeturinat të cilat krijohen nga aktivitetet, proceset industriale, prodhimtari artizanale dhe veprimtari të tjera prodhuese

Mbeturina inerte – mbeturinat të cilat nuk pësojnë ndonjë ndryshim të rëndësishëm fizik, kimik dhe biologjik në vendet ku janë deponuar si:

- i. mbeturina inerte që nuk treten, nuk ndizen ose nuk reagojnë fizikisht apo kimikisht, nuk zbërthehen biologjikisht në kontakt me materiet e tjera dhe nuk ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut;

¹ Shtojca I (Lista D) e Ligjit Nr. 04/L-060 “Për Mbeturinën”, Republika e Kosovës

² Shtojca I (Lista D) e Ligjit Nr. 04/L-060 “Për Mbeturinën”, Republika e Kosovës

- ii. tërë kullimi dhe përmbajtja ndotëse e mbeturinës, mbetjet ekotoksike duhet të jenë të vlerës së papërfillshme dhe të mos rrezikojnë cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Mbeturina komerciale – mbeturinat të cilat vijnë nga objektet që përdoren për qëllimet e tregut ose biznesit, sportit, edukimit, rekreacionit, por nuk përfshihen mbeturinat industriale

Mbeturina komunale – mbeturina nga amvisëritë dhe mbeturina nga aktivitetet e tjera të cilat, për shkak të përbërjes dhe natyrës së tyre, janë të ngjashme me ato të amvisërisë

Mbeturina medicinale – mbeturina të cilat krijohen gjatë kryerjes së shërbimeve medicinale

Mbeturina të parrezikshme – mbeturinat që nuk paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut dhe që nuk posedojnë karakteristika të mbeturinave të rrezikshme

Mbeturina të rrezikshme – mbeturinat që paraqesin një apo më shumë veti të rrezikshme³

Mbeturina të veçanta – mbeturinat të cilat për nga natyra e krijimit dhe trajtimit konsiderohen të veçanta⁴

Mbeturina të vëllimshme – mbeturinat me përmasa të mëdha fizike nga pajisjet dhe makineritë, grumbullimi, transportimi dhe largimi i të cilave bëhet në mënyrë të veçantë

Mbledhje – mbledhje dhe transportim i mbeturinave duke përfshirë klasifikimin paraprak në lloje dhe magazinimin e mbeturinave për qëllime të bartjes deri në objektin për trajtim ose deponim të mbeturinave

Mbledhje e ndarë – nënkupton mbledhjen, kur grumbullimi i mbeturinave bëhet në mënyrë të ndarë në lloje, të klasifikuar sipas natyrës dhe pajisjeve për të lehtësuar trajtimin specifik

Menaxhim i mbeturinave – aktivitetet për evitimin dhe reduktimin e prodhimit të mbeturinave dhe ndikimit të tyre në mjedis dhe shëndetin e njeriut, mbledhjen, transportin, trajtimin, ripërdorimin, përpunimin, riciklimin dhe deponimin përfundimtar të mbeturinës, përfshirë monitorimin dhe kujdesin edhe pas kryerjes së këtyre aktiviteteve

Parandalim – masat e ndërmarra para se substanca, materiali apo produkti të bëhet mbeturinë, për të redukuar:

- i. sasinë e mbeturinës, përfshirë ri-shfrytëzimin e produkteve ose zgjatjen e jetëgjatësisë së produkteve;
- ii. efektet negative të mbeturinave për mjedisin dhe shëndetin e njeriut;
- iii. përmbajtjen e substancave të dëmshme në materiale dhe produkte.

Përdorim i mbeturinave – çdo operim, veprimtari që kryhet për qëllime riciklimi ose ripërdorimi të mbeturinave, pjesërisht ose në tërësi, duke përfshirë edhe çdo aktivitet të specifikuar⁵

³ Shtojca III (Lista H) e Ligjit Nr. 04/L-060 "Për Mbeturinat", Republika e Kosovës

⁴ Nenit 38 paragrafi 4 i Ligjit Nr. 04/L-060 "Për Mbeturinat", Republika e Kosovës

⁵ Lista R dhe lista D, në shtojcat e Ligjit Nr. 04/L-060 "Për Mbeturinat", Republika e Kosovës

Përgatitje për ri-përdorim – operimet e përpunimit, kontrollimit, pastrimit apo riparimit, gjatë të cilave produktet apo komponentët e produkteve që janë bërë mbeturina janë përgatitur në mënyrë që të mund të ri-përdoren pa ndonjë paratrajtim

Përpunim i mbeturinave – operim, rezultati kryesor i të cilit është vënia në shërbim e mbeturinave për qëllime të dobishme, duke zëvendësuar materialet e tjera të cilat përndryshe do të duhej të përdoreshin për të plotësuar një funksion të caktuar, apo përgatitja e mbeturinës për të plotësuar ato funksione në ndonjë impiant apo në ekonominë e gjerë⁶

Person – person fizik ose juridik i cili është i involvuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi në proceset për menaxhimin e mbeturinave

Prodhues i mbeturinës – çdo person, veprimtaria e të cilit krijon /prodhon mbeturinë ose çdonjëri që merret me para-procesim, përzierje apo operime të tjera që rezultojnë në ndryshimin e natyrës apo përbërjen e mbeturinës

Riciklim – çdo operim i përpunimit nga i cili materialet mbeturinë janë rikthyer në produkte, materiale, substance, qoftë si origjinale apo për qëllime tjera. Kjo përfshin rikthimin e materialeve organike, por nuk përfshin përfitimin e energjisë dhe ripërpunimin në materiale që përdoren si karburante apo për operimet e mbulimit të mbeturinave

Ri-përdorim – çfarëdo operimi me të cilin çdo produkt apo komponent, i cili nuk është mbeturinë, përdoret përsëri për të njëjtin qëllim për të cilin është destinuar

Stabilizim i mbeturinës – çdo trajtim i mbeturinës me metodën e caktuar me qëllim të zvogëlimit të ndikimeve negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

Stacion transferi – vendi apo objekti të cilat plotësojnë kushtet e caktuara paraprahe për shkarkimin e mbeturinave, në mënyrë që ato të përgatiten për transport deri në impiantet dhe instalimet për magazinim, procesim, trajtim dhe deponim përfundimtar të mbeturinave

Zotërues i mbeturinës – prodhuesi i mbeturinës apo personi që e posedon mbeturinën

⁶ Shtojca II (Lista R – lista e operimeve potenciale) e Ligjit Nr. 04/L-060 “Për Mbeturinat”, Republika e Kosovës

1 Hyrje dhe konteksti nacional për menaxhimin e mbeturinave

1.1 Qëllimi i planit

Plani Komunal i Menaxhimit të Mbeturinave të Ngurta (PKMMN) i Drenasit është dokument planifikimi që e mundëson zbatimin e *Strategjisë së Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave* dhe *Planin e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave* në nivel lokal, duke i kontribuar zbatimin të politikave dhe përmbushjes së objektivave kombëtare. Ai po ashtu synon realizimin e sa vijon:

- i) mbledhjen e të dhënave për mbeturinat komunale, duke e ofruar një përshkrim të rrjedhave të mbeturinave dhe përgjegjësive, karakteristikave dhe vëllimeve të mbeturinave që duhet të menaxhohen dhe një përkufizim të shtrirjes gjeografike të planit,
- ii) një vlerësim të skemave aktuale të mbledhjes së mbeturinave, pajisjeve dhe personelit si instalacioneve për deponim dhe ripërtëritje të mbeturinave, duke e përkufizuar bazën e shërbimeve dhe aktivitetëve aktuale për menaxhimin e mbeturinave,
- iii) opsionet e menaxhimit të mbeturinave që do ta mundësonin mbledhjen dhe përpunimin e mbeturinave sipas objektivave kombëtare dhe kontekstit lokal,
- iv) shërbimin cilësor, duke i përcaktuar mënyrat dhe instrumentet që e garantojnë një cilësi të tillë, duke përfshirë p.sh. treguesit kryesorë të performancës, procedurat dhe burimet njerëzore dhe financiare, shkathtësitë, rregullat,
- v) kornizën institucionale, organizative dhe regullatore, duke i rekomanduar masat dhe instrumentet për përmirësimin e komponentëve organizativë, kontributet publike dhe private dhe përgjegjësitë për mbledhjen, transportimin, riciklimin dhe trajtimin e mbeturinave,
- vi) nevojat financiare dhe investimet, duke i përkufizuar ato që janë të nevojshme për realizimin dhe ofrimin e qëndrueshëm të shërbimeve dhe procedurave të menaxhimit të mbeturinave, dhe
- vii) burimet financiare për investime dhe një strategji për Drenasin që i mbulon shpenzimet, duke e krijuar një mjedis të favorshëm për ta siguruar financimin nga qeveria dhe nga burimet e jashtme, si dhe kthimin e shpenzimeve.

1.2 Historiku kombëtar i menaxhimit të mbeturinave

Sipas Ligjit Nr. 04/I-060 për Mbeturinat dhe Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Mbeturinave të Ngurta (MMN-në), komunat e Kosovës janë përgjegjëse për hartimin e planeve komunale të tyre për menaxhimin e mbeturinave, të cilat do të merren me, në veçanti, sa vijon:

- sasinë dhe llojet e mbeturinave që pritet të krijohen dhe origjinën e mbeturinave të cilat do të shfrytëzohen, ose deponohen sipas planit, në vendin e caktuar,
- programin për mbledhjen e mbeturinave komunale nga amvisëritë, mbeturinat komerciale dhe mbeturinat industriale,
- programin për mbledhjen, grumbullimin dhe ndarjen e mbeturinave të rrezikshme nga mbetjet e tjera, ose ndarjen e llojeve të mbeturinave,
- propozimet për teknikat e mundshme për ripërdorimin dhe riciklimin e komponentëve të ndryshme nga mbeturinat komunale,
- programin për vetëdijesimin publik dhe edukimin në lidhje me menaxhimin e mbeturinave,
- përshkrimin e lokacioneve për pajisjet dhe objektet për trajtimin dhe largimin e mbeturinave, përfshirë kushtet teknike të nevojshme për dizajnimin e objekteve të reja,
- paralogaritjen e shpenzimeve të menaxhimit të mbeturinave dhe burimet e financimit për realizimin e projekteve të planifikuara, dhe
- mundësitë për bashkëpunimin midis dy apo më shumë komunave.

Është e qartë se, megjithatë, të gjitha kërkesat e ligjit të ri për mbeturinat mund të mos plotësohen menjëherë, ndërsa zhvillimi në të ardhmen duhet të shihet si proces dinamik që nxitet nga administrata dhe nga njerëzit pjesëmarrja aktive e të cilëve është e domosdoshme. Qytetarët e Drenasit janë po aq përgjegjës sa edhe qeveria lokale e tyre për realizimin e suksesshëm të përmirësimeve të nevojshme.

Komunat në tërë Kosovën përballen me një sfidë të madhe në ofrimin e shërbimeve për qytetarët e tyre. Nga to kërkohet që ta luftojnë varfërinë, ta përforcojnë ekonominë lokale dhe ta promovojnë demokracinë, ndërsa në të njëjtën kohë ta përmirësojnë infrastrukturën dhe t'i furnizojnë banorët e tyre me ujë, rrymë, shërbime shëndetësore, mbrojtje të mjedisit dhe transport. Standardet e përmirësuar për mbledhje të ndarë, trajtim dhe largim të mbeturinave sigurojnë se do të çojnë në shpenzime më të mëdha për ofrimin e këtyre shërbimeve. Prandaj, sfidë është që të krijohen zgjidhje që i përmirësojnë standardet e shërbimit dhe që i minimizojnë ndikimet negative, dhe që, në të njëjtën kohë, mbështeten nga popullata dhe mund të realizohen në kuadër të strukturave dhe kushteve aktuale.

1.3 Politikat, strategjia dhe korniza ligjore kombëtare

Legjislacioni i Kosovës i veçantë për këtë sektor është në proces të shtjellimit dhe harmonizimit me objektivat e BE-së, edhe pse ende është i paplotë. Me rëndësi të veçantë për menaxhimin e mbeturinave në komuna janë ligjet për mbeturinat, vetëqeverisen lokale, ndërmarrjet publike dhe partneritetet publike private. Megjithatë, këto ligje ende duhet të harmonizohen. Disa pjesë të tyre dyzohen me njëra tjetrën, ndërsa përmbajnë paragrafë kundërtshënës.

Ligji Nr. 2012/04-L-060 për Mbeturinat e zëvendëson Ligjin Nr. 2005/02-L-30 për Mbeturinat, me anë të të cilit janë vënë në zbatim standardet evropiane në Kosovë, që janë standard edhe për detyrat që janë përpara. Ligji 04-L-060 ka për qëllim i) evitimin dhe reduktimin sa më të madh të mundshëm të gjenerimit të mbeturinave, ii) ripërdorimin e komponentëve të përdorshëm nga mbeturinat, iii) zhvillimin e qëndrueshëm përmes mbrojtjes dhe ruajtjes së resurseve natyrore, iv) parandalimin e ndikimeve negative të mbeturinave në mjedis dhe në shëndetin e njeriut, dhe v) deponimin përfundimtar të mbeturinave në mënyrë të pranueshme mjedisore.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH-ja) e ka përgatitur Planin Kombëtar dhe Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Mbeturinave. Sipas Ligjit 04-L-060 (neni 9), kjo strategji përmban:

1. një përshkrim dhe vlerësim të gjendjes aktuale të menaxhimit të mbeturinave;
2. caqet dhe masat themelore për menaxhimin e mbeturinave;
3. masat që duhet të merren për menaxhimin e mbeturinave komunale të ngurta dhe mbeturinat e parrezikshme;
4. masat që duhet të merren për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme;
5. udhëzimet për përpunimin dhe trajtimin e mbeturinave në përputhje me parimet e mbrojtjes së mjedisit;
6. udhëzimet për ruajtjen e sigurt apo largimin e mbeturinave;
7. udhëzimet për masat e sigurisë dhe prodhimin dhe standardet administrative teknike për t'i arritur qëllimet për menaxhimin e mbeturinave;
8. nevojat afatgjata të Republikës së Kosovës në fushën e menaxhimit të të gjitha llojeve të mbeturinave sipas këtij ligji.

Plani strategjik përpilohet nga MMPH-ja në bashkëpunim me ministritë dhe autoritetet e tjera kompetente, aprovohet nga qeveria për një periudhë dhjetëvjeçare dhe rishikohet çdo pesë vjet.

Strategjia Kosovare për Mjedisin e miratuar në vitin 2004 dhe Plani Kosovar i Veprimit për Mbrojtjen e Mjedisit i përgatitur në vitin 2006 janë dokumente të tjera që kanë të bëjnë me çështjet e menaxhimit të mbeturinave.

Udhëzimi Administrativ Nr. 15/2012 për Menaxhimin e Deponive të Mbeturinave e ka shfuqizuar një udhëzim të mëparshëm (10/2007) dhe është në pajtim me nenin 93(4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 33, paragrafin 4 të Ligjit Nr.04/L-060/2012 për Mbeturinat si dhe me nenin 19(6.2) të Rregullores së Punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 09/2011. Me tjerash, në të janë radhitur llojet e mbeturinave që nuk duhet të hidhen në deponi dhe janë vënë kufizime për elemente dhe përbërës të ndryshëm që rrjedhin nga to si dhe janë caktuar kushte për operatorin e deponisë.

Ligjet kombëtare të tjera që duhet të merren parasysh kur përgatitet dhe zbatohet menaxhimi i mbeturinave të ngurta komunale përfshijnë sa vijon:

1. Ligji Nr. 2009/03-L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit,
2. Ligji Nr. 2008/03-L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 17, në të cilin parashihet se komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuar në legjislacionin e zbatueshëm, në fushat që vijnë: zhvillimin lokal ekonomik, planifikimin urban dhe rural, shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin, zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit, mbrojtjen e mjedisit lokal dhe ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të nxehtësie lokale, etj.,
3. Ligji Nr. 2008/03-L-087 për Ndërmarrjet Publike (NP-të), i cili e përcakton kornizën ligjore për shërbimet komunale; sipas këtij ligji, NP-të që merren me menaxhimin e mbeturinave janë pronë e një apo më shumë komunave, ndërsa të drejtat e aksionarit ushtrohen nga Komisioni Komunal i Aksionarëve,
4. Ligji Nr. 2011/04-L-045 për Partneritetet Publiko-Private,
5. Ligji Nr. 2003/14 për Planifikimin Hapësinor,
6. Ligji Nr. 2004/24 për Ujin.

Ka edhe shumë udhëzime administrative nënligjore që kanë të bëjnë me menaxhimin e mbeturinave, duke përfshirë sa vijon:

Draft/2015, Menaxhimi i mbeturinave nga ndërtimi dhe rrënim i ndërtesave (qershor 2015)
15/2012, Menaxhimi i deponive të mbeturinave (dhjetor 2012)
19/2012, Menaxhimi i automjeteve mbeturinë dhe komponentëve të tyre (gusht 2012)
20/2012, Eksportimi, importimi dhe transiti i mbeturinave (gusht 2012)
23/2012, Menaxhimi i gomave të përdorura dhe mbeturinë (dhjetor 2012)
05/2013, Menaxhimi i vajrave të përdorura dhe mbeturinë (nëntor 2014).
13/2013, Katalogu shtetëror i mbeturinave (qershor 2013)
16/2013, Vlerat kufitare të koncentrimave për komponentët e rrezikshme në mbeturina (qershor 2012)
22/2013, Menaxhimi i mbeturinave njerëzore mjekësore dhe të veterinarisë (nëntor 2014)

07/2014, Kompetencat e mbajtësve, prodhuesve dhe importuesve të mbeturinave (prill 2014)

09/2014, Licenca për Menaxhimin e Mbeturinave (nëntor 2014).

1.4 Rolet dhe përgjegjësitë në nivel rajonal dhe lokal

MMPH-ja është organi kombëtar që e udhëheq hartimin e politikave, zbatimin e ligjit dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve për mbrojtje të mjedisit, përfshirë menaxhimin e mbeturinave, burimeve të ujit, ajrit, dheut dhe biodiversitetit. Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, raportimi për mjedisin është detyrë dhe përgjegjësi e Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, AMMK-së.

Sipas Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, komunat i ushtrojnë kompetencat e tyre brenda juridiksionit të tyre për t'i arritur disa qëllime dhe për të ofruar shërbime për qytetarët e tyre. Mirëmbajtja dhe ofrimi i shërbimeve publike dhe komunale, përfshirë menaxhimin e mbeturinave, janë pjesë e kompetencave vetanake të komunave. Në Drenas, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës dhe Strehimit është përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave, shërbime këto që ofrohen nga dega e Kompanisë Rajonale "Pastrimi" në Drenas. Aksionarë të kësaj NP-je janë komuna e Prishtinës, Fushë Kosovës, Obiliqit, Lipjanit, Drenasit, Graçanicës dhe Podujevës. Që nga viti 2012, kësaj kompanie i duhet të aplikojë në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për licencë për t'i mbledhur dhe larguar mbeturinat e ngurta në Komunën e Drenasit. Para vitit 2012, kjo kompani e ka marrë licencën e saj nga Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Mbeturina (ZRRUM-i)⁷.

Deri në fillim të vitit 2012, mbeturinat e mbledhura janë hedhur në deponinë industriale të fabrikës së Ferronikelit, por që nga ajo kohë janë dërguar në deponinë rajonale në Mirash, e cila drejtohet nga Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK-ja), kompani kjo e ndarë nga "Pastrimi" që është pronë e qeverisë.

⁷ Zyra Rregullatore për Ujë (ZRRUM-ja) ka qenë rregullator ekonomik i pavarur për shërbimet e ujit dhe të mbeturinave të ngurta në mbarë vendin dhe ka qenë përgjegjëse për licencimin e ofruesve të shërbimeve dhe caktimin e tarifave për shërbimet e rregulluara. Kjo zyrë e ka ndërmarrë edhe monitorimin dhe fuqizimin e zbatimit të standardeve të shërbimit për ofruesit e shërbimeve.

2 Konteksti lokal, korniza strategjike dhe profili i komunës

2.1 Konteksti lokal i menaxhimit të mbeturinave

Sipas Ligjit për Mbeturinat, përgjegjësitë dhe detyrat e komunave sa i përket menaxhimit të mbeturinave përfshijnë sa vijon:

- krijimin e sistemit për menaxhimin e mbeturinave sipas parimit të hierarkisë për menaxhimin e mbeturinave për territorin e tyre, hartimin e planit lokal të veprimtimit për menaxhimin e mbeturinave, sipas nenit 10 të këtij ligji dhe krijimin e kushteve për zbatimin e tij,
- hartimin e një raporti vjetor për menaxhimin e mbeturinave,
- rregullimin e përgjegjësisë dhe detyrimeve për kryerjen e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave, zbatimin e tyre dhe organizimin e menaxhimit të mbeturinave në territorin e tyre,
- mirëmbajtjen dhe mbajtjen e një sistemi të informimit publik dhe raportimin për punët e kryera siç është paraparë me këtë ligj dhe me aktet ligjore të tjera për menaxhimin e mbeturinave,
- zbatimin e procedurave të prokurimit për përzgjedhjen e personave të licencuar për mbledhjen, depozitimin dhe transportimin e mbeturinave të ngurta komunale në territorin e saj,
- evidentimin e vendeve të ndotura në territorin e tyre, hartimin e projekteve për sanimin e tyre me shënimet për lokacionin, karakteristikat hapësinore gjeometrike, llojin e ndotjes, sasinë e mbeturinave, afatet për përmirësimin e gjendjes dhe shënimet e tjera me rëndësi për realizimin e projekteve, dhe
- mbikëqyrjen dhe kontrollimin e aktiviteteve të menaxhimit të mbeturinave në territorin e tyre përmes inspektorëve komunal të mjedisit.

Neni 10 i këtij ligji i përcakton komponentët e planit komunal, duke përfshirë, mes tjerash, informatat për sasinë dhe llojet e mbeturinave, qëllimet dhe caqet e reduktimit të mbeturinave, programet për mbledhjen dhe deponimin e mbeturinave të amvisërisë, mbeturinave komerciale, industriale dhe të rrezikshme, ndarjen, riciklimin dhe kompostimin të mbeturinave, vetëdijësimin publik, masat dhe shpenzimet e tyre për menaxhimin e mbeturinave.

Përveç ligjeve kombëtare, Statuti i Komunës së Drenasit (i datës 16 shtator 2008) e saktëson menaxhimin e mbeturinave në Drenas si funksion vetanak (neni 81) dhe parasheh në veçanti (neni 82) se Drejtoria i Shërbimeve Publike dhe Emergjencave e mbikëqyr kompaninë e pastrimit dhe bashkëpunon me të për këtë shërbim. Kuvendi Komunal e ka miratuar Rregulloren Nr. 501-1768 të datës 27 dhjetor 2012 për menaxhimin e mbeturinave në këtë komunë.

2.2 Korniza strategjike lokale

Strategjia e Zhvillimit Lokal e Drenasit (2009) përfshin një vizion dhe mision për komunitetin si dhe disa objektiva të tjera e projekte për arritjen e tyre:

Misioni–Vizioni

Drenas do të jetë vend i infrastrukturës së zhvilluar, i një mjedisi të menaxhuar më mirë dhe i një shkollimi cilësor. Zhvillimi agroekonomik dhe industrial do të ofrojë mundësi për biznes dhe punësim për banorët ruralë.

Edhe Strategjia e Zhvillimit Lokal 2015–2019 e Drenasit jep një vizion dhe mision:

Vizioni

Komuna e Drenasit është e detyruar ta zbatojë modelin e liderit shumëdisiplinorë, probiznesor dhe ndërkulturor, duke e sjellë Drenasin si promovues të zhvillimeve, partneriteteve dhe investimit të përkushtuar dhe si rrjet të interesave të përbashkëta dhe afatgjate të qytetarëve, bizneseve dhe programeve ekonomike.

Misioni

Komuna e Drenasit, përmes zbatimit të qeverisjes gjithëpërfshirëse, llogaridhënëse dhe transparente dhe koncentrimin të lartë të vlerave të qytetarisë dhe demokracisë, synon ta sigurojë një mjedis të përshtatshëm për realizimin e projekteve dhe programeve zhvillimore në sektorin privat kryesisht përmes promovimit të potencialit të saj për zhvillim ekonomik dhe investim të brendshëm dhe të huaj, ku fokusi kryesor është që të shtohet punësimi dhe të përmirësohet mirëqenia e qytetarëve.

Menaxhimi i mbeturinave është radhitur në dokumentin strategjik si prioritet dytësor (pas prodhimit dhe zhvillimit bujqësor, zhvillimit të infrastrukturës dhe menaxhimit të tokës). Dy projekte përqendrohen në menaxhimin e mbeturinave—njëri në riciklimin e mbeturinave në vlerë prej 180,000€, ndërsa tjetri në ndërtimin e një deponie të mbeturinave (165,000€). Ndotja e mjedisit nga mbeturinat e ngurta përmendet si dobësi në analizën SWOT të strategjisë.

2.3 Profili i komunës dhe analiza e situatës

Komuna e Drenasit gjendet midis tokave të pasura bujqësore në Kosovën qendrore (figura 1) brenda kufijve të rajonit të Prishtinës dhe afro 32 km larg kryeqytetit. Kjo komunë ka një sipërfaqe prej 276 km² dhe gjendet në një lartësi mbidetare prej 1,072 metrave në pikën e saj më të lartë dhe 575 metra në pikën e saj më të ulët. Afër 40% e tokës është e pyllëzuar, ndërsa afër 60% është bujqësore.

Kjo komunë shtrihet përgjatë vargmaleve që shtrihen nga veriu dhe jugu përgjatë luginës së Drenicës, e cila gjendet midis rrafshit të Kosovës dhe atij të Dukagjinit. Ajo është e pozicionuar afër qendrave kryesore industriale dhe tregtare të vendit. Hekurudha dhe rruga kombëtare midis Prishtinës dhe Pejës kalojnë nëpër komunën e Drenasit, duke e lehtësuar kështu lëvizjen e njerëzve dhe të mallrave nëpër vend.

Komuna e Drenasit ka 35 zona kadastrale të ndara në 38 vendbanime. Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës – ASK, Komuna e Drenasit ka 58,531 banorë dhe 8 816 ekonomi familjare.




Figura 1: Vendndodhja e komunës së Drenasit në Kosovë

Ekonomia dominohet nga bujqësia, veçanërisht nga gruri dhe misri, ndërsa aty është edhe fabrika e Ferronikelit (e cila i ka siguruar 2,000 vende të punës në kulmin e prodhimit në vitin 1988) dhe një numër i madh i bizneseve familjare të vogla të bazuara në zejtarë dhe tregti. Kjo komunë i ka dy miniera si dhe gurthyes të gëlqeres.

Në vitin 2004, në këtë qytet është hapur një qendër tregtare, e cila i ka 134 dyqane dhe zyra. Në komunën e Drenasit janë gjithsej 1,720 biznese të regjistruara (P1) (edhe në P2 dhe në Strategjinë e ZhEL-së janë raportuar 2,447 biznese; OSBE, 1,921) si dhe 181 ferma dhe 2 tregje të perimeve dhe pemëve (nga një në Drenas dhe në Komoran; të dhënat nga P1) dhe dy tregje të kafshëve. Në vitin 2005, komuna e Drenasit dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë e kanë filluar një projekt për ta themeluar një park industrial me sipërfaqe prej 24 hektarësh në fshatin Korroticë e Poshtme, 17 km nga magjistralja Prishtinë–Pejë dhe 5 km nga aeroporti i Prishtinës.

Fabrika e Ferronikelit është ende punëdhënësi kryesor në këtë komunë, ndërsa pjesa më e madhe e fuqisë punëtore është e punësuar në bizneset private joprodhuese dhe të vogla familjare, siç janë dyqanet, autolarjet dhe pompat e benzinës.

Komuna ka një institucion parashkollor, 30 shkolla fillore dhe dy shkolla të mesme dhe 52 institucione, përfshirë administratën komunale, stacionin policor, gjykatën, qendrën shëndetësore, shtatë qendra të shëndetësisë familjare, pesë klinika, PTK (Posta dhe Telekom i Kosovës), çerdhet e fëmijëve, qendrën e shërbimeve sociale, QRA-në (Qendra e Regjistrimit të Automjeteve), kompaninë e furnizimit me energji elektrike (KEDS-in) dhe Kryqin e Kuq. Në Drenas institucione fetare janë: 15 xhami dhe një kishë katolike në ndërtim.

2.4 Organizimi i menaxhimit të mbeturinave

Komuna e Drenasit i ka dhjetë drejtori dhe një numër zyrash, nga një për kryetarin e Komunës, kuvendin, integrimin evropian dhe informimin për komunitet (shih figurën 2). Njëra nga drejtoritë është përgjegjëse për shërbimet publike dhe emergjencën, duke përfshirë, mes tjerash, për menaxhimin e shërbimeve të mbeturinave, transportin lokal, mirëmbajtjen e rrugëve dhe parqet publike, ujin dhe kanalizimet. Kjo drejtori i ka dy sektorë: shërbimet publike, planifikimin emergjent dhe shërbimi i zjarfikësve dhe shpëtim. Megjithatë, është një zyrtar që merret me menaxhimin e mbeturinave.

Komunikimi edhe me kompaninë e menaxhimit të mbeturinave, edhe me komunitetin është i mirë, edhe pse natyra e punës krijon vështirësi.

Në Drenas, mbeturinat mbledhen nga kompania rajonale e mbledhjes së mbeturinave “Pastrimi”, e cila selinë e ka në Prishtinë. Kjo kompani është pasardhëse e një ndërmarrje publike në Prishtinë që veprimtarinë e saj e pati filluar në vitin 1957. Aktiviteti kryesor i kësaj kompanie është transporti dhe mbledhja e mbeturinave komunale, ndërsa aktivitetet tjera përfshijnë pastrimin e rrugëve, shërbimet e dimrit, menaxhimin e varrezave dhe mirëmbajtjen e parqeve. Në vitin 2012, Dega e KRM “Pastrimi” në Drenas i ka pasur 19 të punësuar; tani i ka 21.




Figura 2: Organogrami i komunës së Drenasit (Strategjia e ZhEL-së 2015–2019)

2.5 Sasitë dhe përbërja e mbeturinave

Sasia e mbeturinave të dërguara në deponitë e Kosovës është rritur nga 150.600 tonë në vitin 2008 në 176.743 tonë në vitin 2009. Për përbërjen e mbeturinave është raportuar në tabelën 1.

Tabela 1: Përbërja e mbeturinave në Kosovë

Fraksioni i mbeturinave	Përbërja e MNK-ve, Kosovë (%)
organike	35.3
Qelq	21.0
Dru	11.0
Plastikë	9.4
Metal	9.3
Tekstil	8.2
Letër	4.6
të rrezikshme	1.2
Gjithsej	100.0

Në komunën e Drenasit mbledhen 300–350 tonë mbeturina të amvisërisë në muaj (2% e mbeturinave të tërë vendit).

Në P1, të cilin GIZ-i e ka shpërndarë në vitin 2015, është raportuar se në vitin 2014 janë larguar 2,827 tonë, d.m.th. një 200 tonë në muaj tonë mesatarisht, ndërsa në një pjesë tjetër të këtij raporti është raportuar se gjatë një periudhe shtatëditëshe janë mbledhur gjithsej 67 tonë, që është sasi ekuivalente me 9.5 tonë në ditë dhe 290 tonë në muaj. Në P1 janë raportuar 54.37 tonë në një javë (shih tabelën në paragrafin 2.13), ndonëse pastaj raportohen shifrat $19.56+20.86+26.53=66.95$. Gjithsej 2,827 tonë janë shkarkuar në 207 xhiro (d.m.th. një mesatare prej 13.66 tonëve për ngarkesë). Në një analizë të kohëve të fundit (Planco Consulting) është raportuar për 3,195 tonë në vit, për 2,795 familje të cilat janë shërbyer, me 6.2 persona/amvisëri, ekuivalente me 0.505 kg për person në ditë.

Deri në vitin 2012, pjesa më e madhe e mbeturinave komunale janë hedhur në deponinë e fabrikës së Ferronikelit pa u peshuar. Prandaj, shifrat nga ajo kohë duhet të konsiderohen si vlerësime të përafërta. Rrjedhimisht, në vitin 2014 në deponinë e Mirashit janë deponuar 2,661.68 tonë mbeturina, krahas 153 tonëve që janë depozituar në deponinë rajonale në Prishtinë dhe 12 tonëve që janë depozituar në deponinë rajonale në Mitrovicë në dhjetor të vitit 2014, duke e sjellë kështu gjithsej sasinë e mbeturinave që janë larguar nga Drenasi në 2,827.11 tonë.

Sipas kontrollimeve vizuale, një pjesë e mbeturinave përbëhen nga materialet potencialisht të riciklueshme, siç janë letra, kartoni dhe plastika. Prandaj, potenciali për ripërtëritje dhe riciklim është i madh, me një perspektivë të pastajme atraktive për kompanitë e riciklmit. Supozohet se mbeturinat organike përbëjnë 50% të totalit ndërsa pjesën tjetër e bëjnë llojet e tjera të mbeturinave.

Tabela 2: Parashikimi i mbeturinave (Infrastruktur & Umwelt, 2012: Rezultatet dhe plani i veprimit)

Qyteti, fshati	Sasia e mbeturinave (t/v)		Qyteti, fshati	Sasia e mbeturinave (t/v)	
	2013	2022		2013	2022
Qyteti i Drenasit	2,583	3,379	Gllanasellë	442	592
Çikatovë e Re	524	701	Godanc	127	171
Lagja e Ferronikelit	116	156	Gradicë	281	376
Shtrubullova	256	343	Kishnarekë	255	341
Poklek i Vjetër	252	338	Korroticë e Poshtme	230	308
Poklek i Ri	177	238	Krajkovë	147	197
Korroticë e Epërme	230	308	Likoshan	216	290
Zabel i Poshtëm	232	311	Llapushnik	767	1,026
Komoran	796	1,064	Negroc	254	341
Gllobar	344	461	Nekoc	643	860
Abri e Epërme	507	679	Polluzha	221	296
Arllat	299	400	Sankoc	275	369
Bajicë	554	741	Shtuticë	201	270
Çikatovë e Vjetër	344	460	Tërdec	302	404
Domanek	113	152	Tërstenik	1,005	1,343
Dobroshec	440	589	Vasilevë	147	197
Fushticë e Epërme	190	255	Verboc	289	386
Fushticë e Poshtme	177	238	Vuçak	99	133
Gjergjicë	119	160	Zabel i Epërm	114	153

IU-ja (2012) i ka përdorur të dhënat nga mesataret evropiane për t'i vlerësuar shifrat prej 1 kg për zonat urbane dhe 0.6 kg për zonat rurale. Koncepti dokumenti i hartuar nga IU-ja i përmban parashikimet e mbeturinave që janë raportuar në tabelën 2.

2.6 Mbledhja dhe transportimi i mbeturinave, praktikat, stafi dhe asetet

Komuna e Drenasit përbëhet nga 35 zona kadastrale të ndara në 38 vendbanime qyteti kryesor dhe një 37 fshatra afër tij. Shërbimi i menaxhimit të mbeturinave kufizohet në gjithsej 16 vendbanime.

Tabela 3: Vendbanimet* në komunën e Drenasit, statusi i përfshirjes së tyre në shërbimin e mbledhjes së mbeturinave, numri i banorëve dhe numrat dhe përqindjet e popullatës së cilës i ofrohet shërbim (Qendra për Edukim dhe Zhvillim të Mjedisit, QEZHM, 2015)

Emri	Që u ofrohet shërbim		Nr. i banorëve (2011)	Që u ofrohet shërbim (2011)		Nga QEZHM (2015)		Nr. i familjeve që u ofrohet shërbim (2015)
	2011	2015		Nr.	%	Nr. i banorëve	Nr. i familjeve	
Qyteti i Drenasit (përfshirë fabrikën e Ferronikelit)	y	y	10,383	9,212	89	6,122	1,048	
Çikatovë e Re	y	y	2,800	2,660	95	2,221	330	
Shtrubullojë	y	y	1,370	959	70	1,105	175	
Poklek i Ri	y	y	948	664	70	1,966**	322**	
Korroticë e Epërme	y	y	1,230	738	60	1,240	184	
Zabel i Poshtëm	y	y	1,240	682	55	1,077	170	
Komoran	y	y	4,244	127	3	4,400	806	
Gllabar	y	y	1,840	920	50	1,526	229	
Domanek		y	0	0		715	100	83
Kishnarekë		y	0	0		1,505	217	91
Korroticë e Poshtme		y	0	0		972	151	92
Krajkovë		y	0	0		1,181	181	57
Nekoc		y	0	0		2,649	452	353
Tërstenik		y	0	0		3,904	541	140
Verboc		y	0	0		1,190	173	63
Zabel i Epërm		y	0	0		565	72	29
Poklek i Vjetër	y		1,347	808	60	**	**	
16 vendbanime			25,402^	16,770	66	20,924	3,276	
Abri e Epërme						1,779	250	
Arllat						3,421	415	
Bajicë						2,306	356	
Çikatovë e Vjetër						1,261	188	
Dobroshec						1,457	215	
Fushticë e Epërme						984	127	
Fushticë e Poshtme						1,062	129	
Gllanasellë						1,591	243	
Godanc						357	57	
Gradicë						845	132	
Likoshan						600	88	
Llapushnik						3,433	522	
Negroc						1,536	193	
Polluzhë						1,017	136	
Sankoc						1,436	205	
Shtuticë						934	139	
Tërdec						1,121	159	
Vasilevë						634	89	
Vuçak						369	52	
						26,143	3,695	
19 vendbanime			58,527	16,770	29	58,481	8,846	

*, Dy vendbanime që janë përfshirë në dokumentacionin e mbulimit me shërbimin e mbledhjes së

mbeturinave në Drenas janë Gjergjica, që është në Arllat, dhe Tërpeza, që është në komunën fqinje të Malishevës; **, në shifrat e vitit 2015 janë kombinuar Pokleku i Vjetër dhe Pokleku i Ri; 38,083 përfshirë ato që janë hijezuar në gri (12,681).

Një pasqyrë e përgjithshme e gjendjes aktuale të mbledhjes së mbeturinave është paraqitur në tabelën 3, në të cilën janë përmbledhur të dhënat për vitin 2011 dhe 2015.

Fabrika e Ferronikelit gjendet brenda kufijve të Drenasit, ndërsa Pokleku i Ri dhe Pokleku i Vjetër janë lagje të fshatit Poklek, edhe pse këta ende janë emra jozyrtarë. Aktualisht shërbimi i mbledhjes së mbeturinave i ofrohet Poklekut të Ri, por jo edhe Poklekut të Vjetër. Gjergjica dhe Tërpeza janë vendbanime joformale; e para është në Arllat, ndërsa tjetra është në kufi brenda territorit të komunës fqinje të Malishevës.

Në vitin 2011, shërbime nuk u janë ofruar 29 vendimeve nga 38 sosh, ndërsa gjatë katër viteve të fundit janë përfshirë edhe shtatë fshatra të tjera. Aktualisht ky shërbim u ofrohet 16 vendbanimeve, ndërsa 19 fshatra janë pa të (edhe Pokleku i Vjetër).

Situata siç ka qenë në vitin 2011 është paraqitur në figurën 3, ndërsa siç ka qenë pas tri vitesh, në vitin 2014, është paraqitur në figurën 4. Zgjerimi e zonës së ofrimit të shërbimit është i qartë për tu parë, por ende është larg mbulimit të plotë.




Figura 3: Zona e shtrirjes së shërbimit të mbledhjes së mbeturinave në vitin 2011

Sipas pyetësorit, problemet më të zakonshme me të cilat përballet dega e “Pastrimit” në Drenas gjatë mbledhjes së mbeturinave nga fshatrat përfshijnë sa vijon:

- depozitim të mbeturinave inerte në kontejnerët e mbeturinave komunale, p.sh. mbeturinat e ndërtimit, mbeturinat e qelqit dhe biologjike (eshtrat)

- madhësia e madhe e disa materialeve të hedhura
- mbeturinat e kopshtit
- hiri nga stufat gjatë dimrit
- gjendja e keqe e rrugëve që i shton shpenzimet operative
- hedhja e mbeturinave nga fshatrat që nuk janë të përfshira në shërbim.




Figura 4: Zona e shtrirjes së shërbimit të mbledhjes së mbeturinave në vitin 2014

Nëpër fshatrat në të cilat nuk bëhet mbledhja e mbeturinave, popullata zakonisht ose i hedh mbeturinat kudo, ose i djeg. Ndonëse ka ca informata për deponitë ilegale, deponi të tilla po krijohen vazhdimisht, përkundër përpjekjeve të komunës, e cila po e shpenzon një pjesë të buxhetit të saj në pastrimin e deponive të tilla (shih më poshtë).

Mbledhja e mbeturinave bëhet nga kontejnerët dhe shportat që sigurohen nga shërbimet publike komunale, por edhe nga shportat dhe kontejnerët e tjerë në pronësi private. Thasët e plastikës nuk përdoren si kontejnerë për mbledhje të mbeturinave.



Mbledhja e mbeturinave në komunën e Drenasit (2015) bëhet duke përdorur 102 kontejnerë të vëllimit 1.1 m^3 dhe 4 kontejnerë të madhësisë 7 m^3 , krahas 2,501 kontejnerëve të madhësisë prej 120 litrave dhe 27 kontejnerëve të madhësisë prej 240 litrave.

Në vitin 2012 është raportuar se një pjesë e madhe e kontejnerëve kanë qenë në gjendje të keqe dhe kanë pasur nevojë për riparim dhe se atyre u kanë munguar rrotat apo nuk kanë qenë funksionale. Me sa duket nuk përdoren pajisje për saldimit në nivel lokal për mirëmbajtjen e kontejnerëve, edhe pse pajisje për saldimit përdoren në selinë e kompanisë në Prishtinë.



Kështu, vetëm një pjesë e kontejnerëve mund të lëvizin në rrota deri te kamionët për mbledhje të mbeturinave, ndërsa trotuaret e larta, zonat e pashtuara për mbledhje dhe qasja e bllokuar nga veturat e parkuara e pengojnë mbledhjen dhe largimin e mbeturinave.

Tabela 4: Llojet e kamionëve të mbeturinave që përdoren në komunën e Drenasit

Lloji	Kapaciteti m^3	Tonë	Viti i prodhimit	Numri
Kamionë shtypës Iveco për zbrazjen e kontejnerëve 1.1m^3	10	5	2002	2
Kamionë zbrazës Mercedes për transportimin e kontejnerëve 7m^3	7	12	2001	1
Mitsubishi 1.1m^3	5	2.5	2009	1
Kamionë shkarkues Man		14	1998	1
Traktor Ferguson me rimorkio	2			2
Totali				7
Pastrues i rrugëve	12,000 litra		2002	1

Në vitin 2011, autoparku që është përdorur për mbledhjen e mbeturinave në komunën e Drenasit i ka pasur tetë automjete për të cilat është raportuar në tabelën 3. Shumica e automjeteve e kanë tejkaluar jetëgjatësinë e tyre prej shtatë viteve dhe së shpejti do të duhet të zëvendësohen.

Deri në vitin 2015, ky autopark e ka pasur edhe një makinë borëheqëse dhe një kamion shkarkues Volvo, çfarë e ka sjellë numrin total të automjeteve për largim të mbeturinave nga tetë në dhjetë.



Krahas mbeturinave të ngurta komunale, mbeturinat e kafshëve largohen nga mishshitësit dhe nga mishtoret. Nuk ka informata për sasi të mbeturinave shtazore që prodhohen në këtë komunë e as për mënyrën se si ato trajtohen, përveç që përziehen me mbeturinat e amvisërisë.

. Aktualisht për mbeturinat e tilla përdoret tarifa prej 90€ për ton, e cila është e shtrenjtë edhe për komunitetin, edhe për kompanitë.

Një pjesë e mbeturinave në komunën e Drenasit mbledhen nga operatorët e tjerë (përveç kompanisë Pastrimi), ndërsa shkaktohet ndotje që hyn në komunë përmes rrjedhave të ujit që fillojnë në komunat fqinje.

Është ndërtuar një pikë e vetme transferi, që është financuar nga buxheti kombëtar dhe që është vënë në funksion në vitin 2012. Në këtë vend, mbeturinat ngarkohen nga automjetet për mbledhje të mbeturinave në kamionë për transportim (tërheqje) me vëllim të madh e pastaj dërgohen në deponinë në Mirash. Për transportimin në distancë të madhe është në dispozicion një kamion dhe dy kontejnerë. Në stacion të transferit është instaluar një peshor, e cila e mundëson regjistrimin e sasive të mbeturinave. Megjithatë, kjo peshorë nuk është në përdorim aktualisht, të dhënat për sasinë e mbeturinave të deponuar merren nga peshorja në deponinë në Mirash e cila është funksionale.



2.7 Trajtimi dhe riciklimi i mbeturinave

Nuk ka informata për trajtimin formal të mbeturinave apo riciklimin e mbeturinave të ngurta komunale. Megjithatë, në deponi zhvillohen aktivitete të riciklimit joformal. Sipas mbledhësve të mbeturinave, një kompani e riciklimit në Drenas i blen



mbeturinat e ndara të riciklueshme, edhe pse nuk ka informata për materialet që mbledhen për riciklim. Nuk ka informata për mbeturinat elektrike dhe të baterive të prodhuara në komunë, dhe mbeturinat e tilla nuk trajtohen ndaras nga mbeturinat e amvisërisë, nga të cilat ato nuk ndahen.

Mbeturinat mjekësore nga Qendra Mjekësore Shëndetësore e Drenasit digjen në incineratorin i cili ndodhet në objektin e QKMF – së. Duket se ka qasje në të dhënat e tilla dhe ato duhet të mbledhen.

Amvisëritë e fshatrave nuk e praktikojnë kompostimin, edhe pse disa familje që merren me bujqësi e ndërmarrin këtë praktikë.

2.8 Tërheqja dhe deponimi i mbeturinave

MMPH-ja ka dhënë urdhër për ta ndaluar hedhjen e mbeturinave komunale në deponinë e Ferronikelit. Që nga viti 2012, pas finalizimit të stacionit të ri të transferit, mbeturinat e amvisërisë nga komuna e Drenasit janë hedhur në deponinë rajonale në Mirash, 35 km nga Drenasi. Meqë kjo është një distancë relativisht e shkurtër nga komuna, është e arsyeshme të parashihet se numri aktual i kamionëve (tabela 3) do të mund të mbledhë dhe bartë një sasi prej 30 tonë të mbeturinave në ditë. Megjithatë, sasia e raportuar sillet nga 10–12 tonë në ditë (300–350 tonë në muaj), që nënkupton vetëm një xhiro çdo tri ditë apo kështu disi.

Deponia e Mirashit menaxhohet nga Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK-ja). Tarifa hyrëse në Deponinë e Mirashit është aktualisht 6€ për ton, ndërsa përdorimi i deponisë së fabrikës së Ferronikelit ka qenë pa pagesë. Kjo deponi është ndërtuar në vitin 2004 dhe 2005 në një gropë të mëparshme të linjitet si një deponi njëqelizore me një shirit deltine. Ajo zë një sipërfaqe prej afro 50 hektarë brenda komunës së Obiliqit. Kapaciteti prej 3.5 milion m³ është prituri të mjaftojë për 15 vjet, deri në vitin 2020. Siç u përmend më herët, kjo deponi e ka një peshore matëse funksionale. Aktualisht ka probleme mjedisore tejet të mëdha në këtë deponi dhe ajo ka nevojë që të rehabilitohet urgjentisht, edhe pse me gjasë do t'i shtojë shpenzimet e largimit të mbeturinave në masë të konsiderueshme.

Përveç deponisë kryesore, janë disa deponi joformale nëpër vendbanime të ndryshme, veçanërisht në zonat që nuk janë të përfshira në shërbim.

Është bërë rehabilitimi i disave nga këto 17 deponi, ndërsa deponi të tjera planifikohet të pastrohen këtë vit.

2.9 Analiza financiare e sistemit të tanishëm të menaxhimit të mbeturinave

Deri në vitin 2012, tarifat për menaxhimin e shërbimeve të mbeturinave në Kosovë i ka përcaktuar ZRRUM-ja (të cilat janë përcaktuar në Rregulla për Përcaktimin e Tarifave të Shërbimit për Shërbimet e Grumbullimit dhe Deponimit të Mbeturinave në Kosovë të datës 12 gusht 2008), por kjo kompetencë tani ka kaluar tek qeveritë lokale. Tarifat janë të detyrueshme për KRM “Pastrimi”.

Në vitin 2011, amvisëritë kanë paguar një tarifë standarde prej 4.14€ në muaj (plus TVSh-ja) për shërbimin e mbledhjes dhe largimit të mbeturinave (pothuajse të njëjtë me tarifat që janë zbatuar në Gjilan dhe në Pejë). Për largimin e mbeturinave me kontejnerë të përbashkët bizneset e vogla kanë paguar 5.57€ në zonën II dhe 7.78€ në zonën I, bizneset e mesme kanë paguar 6.67€ dhe 11.14€, ndërsa bizneset e mëdha kanë paguar 12.73€ dhe 19.08€ përkatësisht. Institucionet kanë paguar tarifë të njëjtë sikur amvisëritë për kontejnerët e përbashkët. Mund të aranzhohen kontejnerë të veçantë që kushtojnë 9.74€ për largimin e ngarkesës prej 1.1m³ dhe 37.8€ për largimin e ngarkesës më të madhe prej 7.0 m³.

Në tabelën 5 është raportuar për numrin e banorëve dhe numrin e amvisërive, bizneseve, institucioneve dhe kompanive industriale që janë regjistruar në këtë komunë në vitin 2011 si dhe për numrin e banorëve dhe numrin e amvisërive të cilave u ofrohet shërbim, përfshirë numrin dhe përqindjen e atyre që janë faturuar si dhe për të ardhurat për vitin përkatës. Numri i banorëve të Drenas ka qenë 58,531 (Regjistrimi i Popullsisë në Kosovë, 2011; IU, 2012), që kanë jetuar në 8,816 amvisëri. Në mesin e tyre, shërbim u është ofruar 16,770 banorëve që kanë jetuar në 2,500 amvisëri. Megjithatë, vetëm 1,248 e tyre janë faturuar (14% e numrit të amvisërive në këtë komunë). Të ardhurat nga këto fatura kanë qenë 35,043€, ose 57% e shumës së faturuar (1,248*4.14€=62,001€) pa TVSh).

Tabela 5: Të ardhurat për Degën e Kompanisë “Pastrimi” në Drenas, 2011

Lloji i paguesit	Nr. i banorëve	Nr. i njësive të regjistruara	Popullata e shërbyer	Njësitë e shërbyera	Nr. i faturave	% e faturuar	Të hyrat (€)
Amvisëritë	58,531	8,816	16,770	2,500	1,248	14	35,043
Bizneset	-	1,720	-	n/a	260	15	12,500
Institucionet	-	32	-	n/a	16	50	6,357
Industria	-	4	-	n/a	1	25	78,995
Gjithsej	-	10,542	-	-	1,525	14	132,895

Në ndërkohë, janë faturuar 260 nga 1,720 biznese (15%) që janë regjistruar në komunë. Të ardhurat kanë qenë 12,500€, që jep një mesatare prej 4€ në muaj për biznes. Kjo tarifë është e pafavorshme kur krahasohet me tarifat që janë caktuar për biznese (shih më lart). Nëse e marrim si shembull një faturë mesatare prej 8€ në muaj për biznes, shkalla e mbledhjes është 50% dhe kjo është nga ato biznese që janë faturuar. Me fjalë të tjera, shkalla aktuale e mbledhjes nga bizneset e regjistruara në komunë ka qenë 7.5% në vitin 2011.

Po ashtu, vetëm gjysma e institucioneve në komunë (nga 32 sosh) janë faturuar. Përkundër kësaj, përderisa gjithsej të ardhurat nga këto fatura duhej të kishin qenë 16*4.14*12=795€, ato

kanë qenë 6,357€. Kështu, duhet të ketë pasur shumë shkarkime të veçanta në kontejnerët e mëdhenj (1.1m³ ose 7.0m³ në madhësi) gjatë vitit, asnjëra nga të cilat nuk janë përfshirë në informatat që janë ofruar për analizim. Sidoqoftë, me të ardhurat prej 6,357€, shuma mesatare që është paguar për institucion ka qenë 397€ në vit, ose 33€ në muaj, ekuivalente me 3.5 kontejnerë 1.1m³ gjatë tërë vitit.

Për vitin 2011, një industri e madhe i ka paguar 60% të gjithsej të ardhurave për “Pastrimin”. Kjo kompani ka qenë Fabrika e Ferronikelit. Deri atë vit, toka e Ferronikelit është përdorur si deponia kryesore nga kompania për menaxhimin e mbeturinave “Pastrimi”, pa pagesë. Megjithatë, në vitin 2012, kompania Ferronikeli e ka anuluar kontratën e saj me “Pastrimin”, e cila rrjedhimisht i ka humbur 60% të të hyrave të saj.

Nuk ka informata për numrin e bizneseve, institucioneve dhe industrive të cilave u është ofruar shërbimi i mbledhjes së mbeturinave atë vit.

Në vitin 2012 dhe 2013, tarifat për amvisëri janë ngritur pak, nga 4.14€ në 4.31€, ndërsa ato për bizneset dhe industrinë kanë mbetur të njëjta sikur në vitin 2011. Duket se institucioneve u janë siguruar kontejnerë të veçantë, me tarifa të njëjta si në vitin 2011.

Tabela 6: Të ardhurat për degën e Kompanisë “Pastrimi” në Drenas, 2015 (të dhënat nga P1)

Kategoria	Nr. i banorëve	Nr. i njësive të regjistruara	Popullata e shërbyer	Njësitë e shërbyera	Nr. i faturave	% e faturuar	Të ardhurat (€)
Amvisëritë	58,531	8,816	19,336	2,886	2,451	28	91,164
Bizneset	-	1,720	-	n/a	412	24	13,969
Institucionet	-	46	-	n/a	23	50	18,721
Kontratrat	-	n/a	-	n/a	n/a	n/a	22,961
Gjithsej	-	10,612	-	-	2,886	27	146,815

Në tabelën 6 janë raportuar shifrat për vitin 2015 për indikatorët që janë raportuar në tabelën Tabela 4 për vitin 2011. Në vitin 2015, Drenasi i ka gjithsej 58,531 banorë (shih më lart), të cilët jetojnë në 8,816 amvisëri (P1, 2015). Kështu, gjatë katër viteve të fundit, numri i banorëve ka rënë pak, edhe pse numri i amvisërive të regjistruara është rritur, për 60. Në ndërkohë, numri i bizneseve të regjistruara mbetet i njëjti, ndërsa ai i institucioneve është rritur, në 52.

Përderisa numri i amvisërive dhe bizneseve të faturuara është rritur dukshëm—pothuajse është dyfishuar dhe rritur për afro 60% përkatësisht—si proporcion me numrat që janë regjistruar në komunë të ardhurat janë megjithatë të ulëta, në pothuajse një të katërtat. Ka të hyra të konsiderueshme (16% e totalit) nga kontratat e veçanta, pastrimi i rrugëve, shërbimet e dimrit, menaxhimi i varrezave dhe mirëmbajtja e parqeve. Megjithatë, amvisëritë tani ofrojnë 62% të të ardhurave të Pastrimit në Drenas.

Ka disa dallime midis të dhënave që janë ofruar në P1 dhe P2, përderisa këto të fundit janë raportuar në tabelën 7.

Tabela 7: Të ardhurat për degën e Kompanisë “Pastrimi” në Drenas, 2015 (të dhënat nga P2)

Kategoria	Nr. i banorëve	Nr. i njësive të regjistruara	Popullata e shërbyer	Njësitë e shërbyera	Nr. i faturave	% e faturuar	Të ardhurat (€)
Amvisëritë	58,531	8,816	19,336	2,886	2,886	33	91,164
Bizneset	-	2,447	-	n/a	339	14	13,969
Institucionet	-	52	-	n/a	52	100	18,721
Kontratrat	-	n/a	-	n/a	n/a	n/a	22,961

*, Planco Consulting raporton se ky shërbim u ofrohet 2,795 familjeve

Kështu, përderisa të ardhurat janë të njëjta në tabelat 6 dhe 7, numri i bizneseve dhe institucioneve të ndryshuara ndryshon, çfarë rezulton në përqindje të ndryshme të faturimit dhe pagesave. Megjithatë, përqindja e amvisërive dhe bizneseve të regjistruara në komunë që faturohen mbetet e ulët, përkundër disa përmirësimeve që janë bërë që nga viti 2011. Nga tabela 7 është e qartë se 67% e amvisërive dhe 86% e bizneseve të regjistruara në komunë nuk paguajnë për mbledhjen e mbeturinave. Është e qartë se çdo mbeturinë që prodhohet nga këto njësi do të mbetet jashtë shërbimit të mbledhjes. Një shpjegim i qartë është se janë vetëm 553 biznese aktive që janë regjistruar në komunë dhe që paguajnë tatim. Megjithatë, ekonomia joformale njihet si punëdhënësi më i madh (siç është potencuar në punëtorinë e korrikut të vitit 2015), në të cilin rast duhet të ketë një numër të konsiderueshëm të bizneseve të paregjistruara, asnjëri nga të cilët nuk i paguajnë as tatimet ndaj biznesit, as tarifat e mbledhjes së mbeturinave. Këto biznese ende prodhojnë mbeturina që duhet të mblidhen apo të hidhen në mjedis.

Midis 2011 dhe 2015, numri i amvisërive të faturuara është dyfishuar, nga 14% në 28%, përderisa të ardhurat nga amvisëritë janë rritur nga 35,043€ në 91,165€, për pothuajse tri herë. Kështu, të ardhurat potenciale nga ofrimi i shërbimit në tërë komunën do të sillte të ardhura të mëdha për Pastrimin. Krahës kësaj, është po ashtu e qartë se flota e tanishme e automjeteve do të mund të përballej arsyeshëm me kërkesën e shtuar, së paku në një fazë fillestare të zhvillimit. Në P1 raportohet se 5,151 amvisërive u është ofruar ofrimi i këtij shërbimi, çfarë do të thotë se 44% e atyre që u është ofruar shërbim e kanë refuzuar atë. Në ndërkohë, kanë mbetur edhe 3,695 amvisëri tjera, që përfaqësojnë 42% të komunitetit, të cilave duhet tu ofrohet ky shërbim.

Duke i përdorur të dhënat nga P1, është e qartë se të ardhurat potenciale nga ofrimi i shërbimit në tërë komunën do të arrinin në më shumë se 560,000€ (tabela 7). Për më tepër, të dhënat nga P2 tregojnë se ka shumë më shumë biznese të regjistruara (2,447) se sa që janë paraqitur në të dhënat nga P1, që paraqet të ardhura potenciale edhe më të mëdha. Megjithatë, për shkak të shkallës së panjohur të ekonomisë joformale dhe numrit të bizneseve ‘jo aktive’ të cilat funksionojnë aktualisht, ne mund ta caktojmë si minimum numrin prej 553 bizneseve aktive të njohura. Përfitimet potenciale nga këto biznese janë 53,088€ në vit.

Tabela 8: Numrat e amvisërive, bizneseve dhe institucioneve të regjistruara si dhe të ardhurat nga ato që faturohen dhe nga kontratat e veçanta dhe të ardhurat potenciale (të dhënat nga P1)

Kategoria	Të regjistruara	Nr. i të faturuarave	Të ardhurat (€)		Potenciale (€)
			të faturuara	të paguara	
Amvisëritë	8,816	2,451	139,630.00	91,164.48	457,515
Bizneset	1,720*	412	24,961.68	13,969.31	53,088
Institucionet	52	23	13,189.88	18,720.69	29,821
Kontratrat	n/a	n/a	20,212.35	22,961.13	20,212
Gjithsej	>10,618	>2,886	197,993.91	146,815.61	560,637

*, të regjistruara, por llogaritja për të ardhurat potenciale është bërë për 553 biznese aktive të njohura

Në tabelën 9 është raportuar për të ardhurat për vitin 2014 si dhe për mesataren për konsumator që paguan për vitin përkatës dhe në muaj. Është e qarta se pagesat mujore nga amvisëritë dhe bizneset janë shumë të ulëta, ndërsa ato nga institucionet janë shumë të larta.

Tabela 9: Të ardhurat vjetore dhe mujore nga konsumatorët (të dhënat nga P1 dhe P2)

Burimi i të ardhurave	Shuma (€)	Mesatarja vjetore (€)	Mesatarja mujore (€)
Familjet	91,164.48	31.6	2.63
Bizneset	13,969.31	41.21	3.43
Institucionet	18,720.69	585.02	48.75

Në tabelën 10 është raportuar për buxhetin për vitin 2014 për degën e “Pastrimit” në Drenas. Përderisa është e qartë se kjo kompani do të arrinte me shumë se sa vetëm t’i mbulonte shpenzimet e saj po të paguheshin të gjitha faturat, kjo kompani e ka lejuar një humbje prej 20,000€ në vitin 2014 (dhe kjo është pa i përfshirë shpenzimet e amortizimit të pajisjeve). Po të zgjerohej shërbimi, të ardhurat potenciale do ta bënë këtë kompani shumë fitimprurëse, çfarë do të mundësonte uljen e tarifave për konsumatorë, duke e pakësuar jashtëzakonisht sasinë e mbeturinave që ende lirohen në mjedis.

Tabela 10: Buxheti për Pastrimin, Dega në Drenas, 2014 (nga P1)

Kategoria	Shpenzimi (€)	Kategoria	Të ardhurat (€)	Bilanci (€)	Shuma e faturuar (€)
Pagat	88,838.55				
Telekomi	515.00				
Shpenz. operative	4,189.72	amvisëri	91,164.48		139,630.00
Energjia (naftë)	36,305.27	biznese	13,969.31		24,961.68
Shpenzimet e jashtme	17,951.67	institucionet	18,720.69		13,189.88
Kamionët	19,184.77	kontratrat	22,961.13		20,212.35
Gjithsej	166,984.98	total	146,815.61	-20,169.37	197,993.91

Çështje kryesore, megjithatë, mbesin mospagimi i faturave dhe numri i bizneseve që funksionojnë, që prodhojnë mbeturina dhe që nuk faturohen. Në ndërkohë, nuk ka ndonjë sistem të kompjuterizuar të regjistrimit të të dhënave (Teknologji Informativë dhe të Komunikimit, TKI) për llogaritjen dhe procedimin e faturave të konsumatorëve sipas sasive të mbeturinave të prodhuara. Një bazë e tillë e të dhënave duhet të krijohet dhe të furnizohet me të dhëna. Kjo do ta alarmonte menjëherë kompaninë për konsumatorët që kanë mbetur prapa me pagesën e faturave të tyre.

Në analizën e raporteve të Planco Consulting raportohet për një kosto prej 217,482€, afro 50,000€ më shumë se sa që janë raportuar në tabelë 10, e që kryesisht ka të bëjë me përfshirjen e shpenzimeve të amortizimit të pajisjeve.

Tabela 11: Vlerësimet e kostos (€/t) për mbledhjen dhe largimin e mbeturinave 2014

Kosto	Mbledhja e mbeturinave	Transferimi i mbeturinave	Deponia	Gjithsej MMN
Njësi direkte	34	10	6	50
Njësi indirekte	8	2	1	11
Gjithsej	42	13	7	61


Duke marrë parasysh sasinë e mbeturinave të mbledhura prej 3,600–4,200 tonë në vit, shpenzimet specifike në vitin 2011 janë ngritur nga 32 deri në 37€ për ton të mbeturinave. Këto shpenzime janë shumë të larta, posaçërisht kur merret parasysh se nuk është raportuar për ndonjë shpenzim të investimit. Vlerësimet e fundit (Planco Consulting, 2015) janë raportuar në tabelën 11, duke u bazuar në një shifër vjetore më të ulët prej 3,195 tonë të mbeturinave të mbledhura.

Tabela 12: Ndarja e detajuar e vlerësimeve të kostos për mbledhjen dhe largimin e mbeturinave, 2014

Cost Type		Annual Cost 2014									
		Waste Collection		Waste Transfer		Landfill		Street Cleaning, Others		Total SWM Cost	
Direct	Operational Equipment (Amortisation)	41,525 €		8,200 €		0 €		15,875 €		65,600 €	
	Operational Staff	34,080 €		13,560 €		0 €		0 €		47,640 €	
	Consumables for Operation	31,845 €		10,556 €		19,176 €		1,960 €		63,537 €	
	Subtotal Operational Cost	61%	107,450 €	18%	32,316 €	11%	19,176 €	10%	17,835 €	100%	176,777 €
Indirect	Garage (Amortisation)	400 €								400 €	
	Transfer Station (Amortisation)			613 €						613 €	
	Buildings on Landfill Site (Amortisation)					50 €				50 €	
	Workshop, Stores (Amortisation)	1,099 €		331 €		196 €		182 €		1,808 €	
	Office building (Amortisation)	1,380 €		415 €		246 €		229 €		2,270 €	
	Workshop Equipment (Amortisation)	699 €		210 €		125 €		116 €		1,150 €	
	Consumables (Workshop)	0 €		0 €		0 €		0 €		0 €	
	Indirect Staff	16,010 €		4,815 €		2,857 €		2,657 €		26,340 €	
	Other Indirect Cost	4,908 €		1,476 €		876 €		815 €		8,074 €	
	Subtotal IndirectCost	60%	24,496 €	19%	7,859 €	11%	4,350 €	10%	3,999 €	100%	40,705 €
Total SWM Cost		61%	131,946 €	18%	40,175 €	11%	23,526 €	10%	21,834 €	100%	217,482 €
Performance: Collection/Transfer/Landfill		3,195 t/a		3,195 t/a		3,195 t/a				3,195 t/a	
Direct Unit Cost		34 €/t		10 €/t		6 €/t				50 €/t	
Indirect Unit Cost		8 €/t		2 €/t		1 €/t				11 €/t	
Total Unit Cost		41 €		13 €		7 €				61 €/t	
Served Population		Average Cost of SWM Services per household per month									
2,794 households		Waste Collection		Waste Transfer		Waste Disposal		Street Cleaning		Total SWM Services	
Direct Cost		3.20 €		0.96 €		0.57 €		0.53 €		5.27 €	
Indirect Cost		0.73 €		0.23 €		0.13 €		0.12 €		1.21 €	
Total SWM Cost		3.94 €		1.20 €		0.70 €		0.65 €		6.49 €	
Total SWM Cost		Waste Collection - Transfer - Disposal				5.84 €		0.65 €		6.49 €	

Tarifa minimale që do t'i mbulonte shpenzimet është 6.49€ në muaj për amvisëri (78€ në vit), siç është raportuar në tabelën 12.

Figura 5: Shpenzimet e veçanta të polit projekteve që janë ndërmarrë në Komoran dhe Tërstenik



Në një analizë të mëhershme që është ndërmarrë në dy pilot projekte është përfshirë një ndarje e kostos e cila është paraqitur në figurën 5. Kjo është modeluar edhe në disa ngritje të vogla të shpenzimeve gjatë disa viteve të ardhshme (nga 37,200 në vitin 2013 në 40,400 në vitin 2017). Në këtë analizë është rekomanduar ndërmarrja e disa aktiviteteve të planit operativ dhe të veprimit. Dy nga qëllimet e këtyre pilot projekteve kanë qenë që të rritej përqindja e mbeturinave të prodhuara që mblidhen dhe përqindja e amvisërive që përfshihen në sistemin e mbledhjes së mbeturinave. Rezultatet dhe përfundimet e këtyre projekteve janë parashikuar me kujdes.

2.10 Buxheti komunal për mbeturinat

Përveç aktiviteteve të pastrimit që i ka ndërmarrë dega e “Pastrimit” në Drenas, një numër i vogël i aktiviteteve janë financuar ose realizuar nga komuna e Drenasit në vitin 2011 dhe 2012, përfshirë fushatat e pastrimit (1,800€), rehabilitimin e deponive të (19,500€), donacionin e MMPH-së për një vend për stacionin e transferit (në vlerë prej 25,000€), fushatat e vetëdijesimit (500€) dhe mirëmbajtjen e shportave të mbeturinave në parkun e qytetit përmes një punonjësi që paguhet nga Drejtoria i Shërbimeve Publike (3,360€ në vitin 2012).

Në vitin 2014, buxheti komunal ka qenë 10,982,419€, nga të cilat 75,000€ (<0.7%) janë përdorur për ofrimin e shërbimit të mbledhjes dhe largimit të mbeturinave (*Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal e Drenasit 2015–2019*).

Për vitin 2015, buxheti komunal për mbeturinat ka qenë 49,860€, nga të cilat 30,000€ kanë shkuar për blerjen e kontejnerëve, 15,000€ për rehabilitimin e deponive të vjetra, 3,360€ për mirëmbajtjen e kontejnerëve dhe 1,500€ për dy fushata të ndara të pastrimit.

3 Analiza SWOT

3.1 Përmbledhje e pengesave dhe fyteve të ngushta kryesore

Me anë të kësaj analize janë identifikuar një numër të metash kryesore në menaxhimin e mbeturinave të ngurta në komunën e Drenasit, duke përfshirë sa vijon:

- Mbulimi i ulët me shërbim – shërbime të MMN-s u ofrohen 58% ndërsa faturohen 33% të të gjithë banorëve sipas informatave në dispozicion
- Kjo situatë është përmirësuar që nga viti 2011, kur shërbim u është ofruar 29% ndërsa janë faturuar 14% e të gjithë banorëve
- Në përgjithësi, ka pajisje dhe personel të mjaftueshëm për zgjerimin e shërbimit
- Në vitin 2011 janë faturuar vetëm 14% e amvisërive, ndërsa kjo shifër tani është 28–33%, varësisht nga burimi i informatave. Megjithatë, shumica e faturave (85%) tani paguhen.
- Gjendja me bizneset është më e mirë se ajo me amvisëritë, meqë faturohen 75% prej tyre. Megjithatë, vetëm 56% e shumave të faturuara paguhen. Për, më tepër, ka një ekonomi të zezë të konsiderueshme, e cila po ashtu prodhon mbeturina dhe nuk faturohet.
- Të dhënat në dispozicion janë të pamjaftueshme për vlerësimin e plotë dhe planifikimin gjithëpërfshirës të shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave
- Shpenzimet e investimit deri më tani janë mbuluar nga fondet e jashtme—kombëtare dhe ndërkombëtare.

Krahas kësaj, kompania që i mbledh mbeturinat përballlet me disa sfida. e ato janë:

- hedhja e mbeturinave inerte (të ndërtimit) në kontejnerët e mbeturinave komunale
- madhësia e madhe e disa materialeve të hedhura
- hedhja e mbeturinave të kafshëve dhe mbeturinave mjekësore në kontejnerët e mbeturinave komunale
- mbeturinat e kopshtit
- hiri nga stufat gjatë dimrit
- gjendja e keqe e rrugëve, e cila i shton shpenzimet operative.

|

3.2 Situata institucionale për menaxhimin e mbeturinave

	<i>Favorizuese</i>	<i>Jo favorizuese</i>	
P ë r p a r ë s i t ë	Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë në komunë, përgjegjës për MM, sektori i shërbimeve publike Kompania rajonale për menaxhimin e mbeturinave "Pastrimi" grumbullon, transporton dhe deponon mbeturinat, kryen pastrimin e rrugëve, shërbimet e dimrit, në operim që nga 1957 Komuna Drenas është aksionare në kompaninë rajonale "Pastrimi" Komuna ka rregullore për menaxhimin e mbeturinave miratuar në 2012 Inspektorati i komunës u ka vënë gjoba klinikave mjekësore për mosrespektim të grumbullimit të ndarë të mbeturinave mjekësore dhe dërgimit të tyre në spital për asgjësim Marrëdhëniet e bashkëpunimit mes Komunës dhe "Pastrimi" janë të mira Marrëdhëniet mes Komunës dhe shoqërisë civile për çështjet e menaxhimit të mbeturinave janë bashkëpunuese Ka ndërgjegjësim të shtuar të anëtarëve të kuvendit të komunës për çështjet e mbeturinave, disa prej tyre u kanë kërkuar administratorëve për të raportuar për çështjen e deponive ilegale Dega në Drenas e "Pastrimit" ka rritur numrin e punonjësve nga 19 në 21 persona Personeli i "Pastrimit" është trajnuar për përdorimin e peshores në stacionin e transferimit	Numri i stafit të komunës që merret direkt me çështjen e menaxhimit të mbeturinave dhe pastrimin është i vogël, 0,5 kohë stafi Trajnime të pamjaftueshme të stafit të komunës për ngritjen dhe funksionimin e një sistemi modern të MM, aspekte të riciklimit, kompostimit, bashkëpunimit me sektorin privat Mungesa e një sistemi të integruar elektronik të matjes së performancës së MM Nuk ka sistem efektiv të matjes së performancës nga Komuna të kompanisë "Pastrimi" Nuk ka sistem efektiv të matjes së performancës së sistemit të menaxhimit të mbeturinave në komunë Të dhëna të pamjaftueshme dhe jo të rifreskuara periodikisht për të mundësuar një planifikim të mirë të MM Baza e të dhënave për familjet dhe bizneset nuk është e plotë dhe e saktë për të mundësuar tarifim efektiv për mbeturinat Komuna nuk e kushtëzon dhënien e licencave për mishtoret me dërgimin e mbeturinave shtazore në vendin e përcaktuar nga komuna Komuna nuk specifikon në lejet për rrënim të objekteve që u jep operatorëve privatë vendin e dërgimit të mbeturinave të rrënit Nuk ka një bashkëpunim efektiv të agjencisë së mjedisit të qeverisë me inspektoratin e komunës për gjobëvënien e shkelësve të legjislacionit dhe vendimeve të komunës për mbeturinat Inspeksioni i komunës, përbëhet nga 1 punonjës, më pak mundësi për të vënë gjoba për familjet dhe bizneset, të cilat nuk respektojnë legjislacionin dhe rregulloret për menaxhimin e mbeturinave Është e paqartë në statutin e Drenasit se cili departament ka përgjegjësinë e plotë për menaxhimin e mbeturinave (neni 81 dhe 82 i statutit të komunës)	D o b ë s i t ë
M u n d ë s	Komunat kanë kompetenca të plota ekskluzive për MM (Ligji nr. 04/ L-060, 2012 "Për Mbeturinat", neni 15) Legjislacioni kombëtar për menaxhimin e mbeturinave drejt përafrimit me të BE-së	Shënjestra në strategjinë kombëtare për mbetjet deri në 2016, shumë ambicioze për komunën Fonde dhe programe shumë të pamjaftueshme nga qeveria për arritjen e shënjestrave për 2016	K ë r c ë n

i t ë	Strategjia dhe plani kombëtar për MM ekziston dhe ka të përcaktuar shënjestrat për 2021 Legjislacioni i lejon komunës krijimin e ndërmarrjeve publike komunale, partneriteteve publiko private, ndërkomunale dhe të kontraktimeve Është detyrim ligjor i komunës të hartojë planin për menaxhimin e mbeturinave Bashkëpunimi ndërkomunal për MM, e drejtë ligjore e komunës Komunat rregullojnë ngritjen dhe funksionimin e sistemit dhe kushtet për mbledhjen, ndarjen, përpunimin dhe riciklimin e mbeturinave Detyrim ligjor që MM të bëhet përmes kontratave të veçanta të komunës me një apo më shumë operatorë publik ose privat të liçencuar Komuna ka të drejtë të mbledhë tarifën e shërbimit Inspektorati i komunës ka autoritetin për të vënë gjoba për mosrespektim të legjislacionit dhe rregulloreve për mbeturinat Gjobat për shkelësit e legjislacionit për menaxhimin e mbeturinave variojnë nga 5€ deri në 100€ (Raporti i Auditit për Mbeturinat, 2014)	Kërkohet edhe pëlqimi nga Komiteti i Partneritetit Publiko Privat (KPPP) brenda Ministrisë së Financave, për rastet PPP Agjencitë qeveritare nuk i dërgojnë komunës informacion periodik për sasitë e mbetjeve të rrezikshme që prodhohen në komunë Lidhje të dobëta të ekspertëve të qeverisë, akademisë dhe sektorit privat me ekspertët e komunës, për çështjen e menaxhimit efektiv të mbeturinave <i>Strategjia e RKS për Menaxhimin e Mbeturinave</i> përcakton shënjestra ambicioze për menaxhimin e mbeturinave, nisur nga situata aktuale në komuna: <table><tr><td><i>Shënjestra 2016 (Strategjia për mbeturinat)</i></td><td>%</td></tr><tr><td>Grumbullimi i mbeturinave komunale</td><td>80</td></tr><tr><td>Ndarja në lloje e mbeturinave komunale</td><td>30</td></tr><tr><td>Trajtimi i mbeturinave</td><td>35</td></tr><tr><td>Sasia e mbeturinave të hedhura në deponi</td><td>65</td></tr><tr><td>Sasia e mbeturinave të biodegradueshme të hedhura me mbeturinat komunale</td><td>70</td></tr></table>	<i>Shënjestra 2016 (Strategjia për mbeturinat)</i>	%	Grumbullimi i mbeturinave komunale	80	Ndarja në lloje e mbeturinave komunale	30	Trajtimi i mbeturinave	35	Sasia e mbeturinave të hedhura në deponi	65	Sasia e mbeturinave të biodegradueshme të hedhura me mbeturinat komunale	70	i n e t
<i>Shënjestra 2016 (Strategjia për mbeturinat)</i>	%														
Grumbullimi i mbeturinave komunale	80														
Ndarja në lloje e mbeturinave komunale	30														
Trajtimi i mbeturinave	35														
Sasia e mbeturinave të hedhura në deponi	65														
Sasia e mbeturinave të biodegradueshme të hedhura me mbeturinat komunale	70														

3.3 Sasitë dhe përbërja e mbeturinave

	Favorizuese	Jo favorizuese	
P ë r p a r ë s i t ë	Rreth 50% e mbeturinave të komunës vlerësohen organike, ndërkohë shifrat kombëtare flasin për 35% Tre të katërtat e mbeturinave të prodhuara janë të riciklueshme Ka peshore në deponinë në Mirash, e cila përdoret në mënyrë të rregullt Më shumë se gjysma e mbeturinave prodhohen në qytetin e Drenasit 0,5 kg/ditë për person prodhohet mesatarisht në komunë, bazuar në atë çfarë shkon në deponi (Planco Consulting, 2015), më pak se 0,7kg/ditë për person mesatarja në rajonet e Kosovës përveç rajonit të Prishtinës	Nuk ka informacion të saktë për përbërjen e mbeturinave që prodhohen në komunë Sasia e mbeturinave që prodhohet në komunë vjen në rritje nga viti në vit 2,827 tonë në vit mbeturina prodhohen dhe dërgohen në deponi (2% e Kosovës) Informacioni për mbeturinat e rrezikshme që nxirren nga familjet dhe bizneset mungon Nuk ka informacion sa mbeturina të riciklueshme mbledhen nga sektori informal Në stacionin e transferimit ka peshore, e cila nuk është në funksionim Komuna nuk ka informacion të plotë për mbeturinat mjekësore dhe të rrezikshme që prodhohen në komunë	D o b ë s i t ë

	<i>Favorizuese</i>	<i>Jo favorizuese</i>	
		Nuk ka informacion të saktë për sasi të mbeturinave shtazore që prodhohen nga mishoret dhe thertoret Mungesa e një sistemi të integruar elektronik të matjes së sasive dhe llojeve të mbetjeve NUK Rritja e sasisë së qelqit që nxirret si mbeturinë në komunë përbën problem Nuk ka sistem efektiv të raportimit të sasisë së mbeturinave komunale të prodhuara në komunë Komuna nuk ka të dhëna të sakta për sasinë vjetore të mbeturinave nga ndërtimet dhe prishjet e ndërtesave që prodhohen dhe të dhëna për sasi që riciklohen nga ndërtimet dhe prishjet e ndërtesave Komuna nuk ka të dhëna për sasinë e mbeturinave të rrezikshme që prodhohen nga familjet dhe bizneset tregtare Ka përzierje të mbeturinave ndërtimore me ato urbane të amvisërisë në kazanë apo mjedise publike Në komunë ka vend deponim me mbeturinat e kimikateve industriale nga shkretorja e Ferronikelit Çikatovë, me sip. 24 ha dhe zonë të ndikimit me sip. 71,37 ha (AMMK report, 2014)	
Mundësitë	GIZ ka mundësi asistence ndaj Komunës Drenas në lidhje me përcaktimin e sasisë dhe përbërjes së mbeturinave Përbërja e mbeturinave është e përcaktuar në nivel Kosove, strategjia për mbeturinat Ka eksperiencë në komunat e RKS për identifikimin e përbërjes së mbeturinave, p.sh. Prishtina me GIZ AMMK harton raport kombëtar periodik për mbeturinat dhe kimikatet, i fundit në 2014 Mesatarja ditore e mbeturinave komunale për kokë banori në Kosovë është 0,9 kg (AMMK raport, 2014) Shoqata e Komunave të Kosovës, me mbështetjen e GIZ, ka publikuar një analizë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave nga komunat e Kosovës, që mundëson krahasimin e Pejës me komunat e tjera	Nuk ka një sistem efektiv në nivel Kosove për mbledhjen dhe shpërndarjen e të dhënave të plota për sasi dhe përbërjen e mbeturinave të prodhuara, ricikluara, kompostuara dhe deponuara nga komunat	Kërçenimet

3.4 Mbledhja dhe transporti i mbeturinave

	<i>Favorizuese</i>	<i>Jo favorizuese</i>	
--	--------------------	-----------------------	--

	<i>Favorizuese</i>	<i>Jo favorizuese</i>	
P ë r p a r ë s i t ë	97 persona për km ² , dendësi e vogël në krahasim me Pejën 212 për km ² , Gjilanin 230 për km ²	58% të popullsisë së komunës i ofrohet shërbimi i mbledhjes dhe largimit të mbeturinave	D o b ë s i t ë
	58,531 popullsia, 6,7 persona mesatarisht për familje, 8,816 familje total	58% të familjeve të komunës u ofrohet shërbimi i mbledhjes dhe largimit të mbeturinave	
	10% e popullsisë jeton në qytetin e Drenasit	39% të bizneseve aktive u ofrohet shërbimi	
	96% e sipërfaqes është tokë bujqësore (39%) dhe pyje (57%)	16 nga 38 vendbanimeve u ofrohet shërbimi i mbledhjes së mbeturinave	
	28 pallate, 11.668 banesa private	Ka patur raste të ndërprerjes së shërbimit në disa fshatra pasi shumica e familjeve nuk paguan tarifën	
	1720 biznese të regjistruara (2015)	Një pjesë e madhe e kontenierëve janë në gjendje të keqe dhe në nevojë për riparim, me rrota që mungojnë ose jo funksionale	
	52 institucione (34 shkolla)	Hedhja e mbeturinave inerte në kazanët e komunës dhe të mbeturinave të vëllimshme, ka raste	
	553 biznese aktive	Ka raste të djegies së mbeturinave në kontenierë	
	89% e popullatës së qytetit të Drenasit merr shërbim	Hedhja në kontenierë e eshtrave të kafshëve, mbeturinave nga oborret, hirit të oxhaqeve, është fenomen	
	Shumica e familjeve brenda zonës së shërbimit kanë kontratë me "Pastrimin"	Raste të hedhjes së paligjshme të mbeturinave në vende publike, kryesisht në fshatrat ku nuk ofrohet shërbimi	
	Koshat private përdoren për hedhjen e mbeturinave nga banesat private	Nuk ka sistem komunal për mbledhjen e ndarë të mbeturinave	
	Në komunë ka një qendër transferimi, që operon që nga 2012, i ndërtuar me fonde të buxhetit të shtetit, me operim të pjesshëm	Shërbimi i mbledhjes së mbeturinave në qendrën e Drenasit nuk është shumë cilësor për arsye të cilësisë së kontenierëve	
	Peshorja në stacionin e transferimit është funksionale	Shërbimi i mbledhjes së mbeturinave në qendrën e Drenasit nuk është i mireorganizuar	
	Stacion i transferimi në Drenas përdoret edhe për grumbullimin e mbeturinave voluminoze dhe mbeturinave organike të parqeve	Nuk mbledhen veç mbetjet nga kopshtet e familjeve	
	Një kamion dhe dy kontenierë përdoren për transportin në distancë të gjatë nga qendra e transferimit, përballojnë kërkesat minimale për mjete	Nuk ka deponi për mbeturinat inerte (është caktuar lokacioni për një deponi, 2015)	
	Kontenierë të veçantë mund të sigurohen nga kompania, 9,74€ për largim të ngarkesës 1,1m ³ ; 37,80 €, për largim të ngarkesës 7m ³	Komuna nuk mbledh veçmas mbeturina të rrezikshme nga familjet	
	Mbledhja e mbeturinave nga sektori informal ka ulur sasinë që transportohet për në deponi	Pengim i mbledhjes së mbeturinave nga bordurat e larta, zonat e mbledhjes të paasfaltuara, bllokimi i kamionëve nga makinat e parkuara	
	'Pastrimi' nuk bën çdo ditë transportin e mbeturinave në deponi	Mjetet e grumbullimit dhe transportimit të mbeturinave janë pjesërisht të amortizuara	
	Pastërtia e zonave publike është e përmirësuar dallueshëm		
	Vendi për deponinë e mbeturinave inerte është miratuar		

	<i>Favorizuese</i>	<i>Jo favorizuese</i>	
		8 mjete të "Pastrimit" për mbledhjen e largimin e mbeturinave, shumica kanë më shumë se 7 vjet që janë prodhuar Kapaciteti i kamionëve në dispozicion shfrytëzohet në gjysmën e kapacitetit të tyre (30 t/ditë kapaciteti, 8 t për ditë, efienca në 2014) Rreth 102 kontenierë 1,1m³, 4 kontenierë 7m³, 2,501 kosha 120 litër dhe 27 kosha 240 litër (2015), të pamjaftueshëm për ofrimin me cilësi të shërbimit Në Drenas ka vetëm një kontenier të veçantë për eshtrat "Pastrimi" nuk ka pajisje për saldim për riparim të kazanëve dhe një pjesë e kontenierëve nuk zhvendosen mbi rrota për tek makina teknologjike për zbrazje Mungesë informacioni të saktë për kushtet dhe sasinë e mbeturinave në vend-hedhjet ilegale ekzistuese Një pjesë e hapësirave publike në zonat urbane nuk janë të pastruara cilësisht Stacioni i transferimit nuk ka kushtet teknike minimale, nuk është i lidhur me rrymë dhe ujë Ka kazanë ku vjen erë e rëndë sepse aty hidhen gjelltoreset dhe eshtra nga mishtoret Largësia e deponisë nga qyteti nuk inkurajon dërgimin e inerteve në deponi Jo të gjithë dyqanet kanë koshin e vet të plastikës për mbeturinat, komuna nuk ka rregullore që detyron që do biznes të ketë koshin e vet brenda kushteve të marrjes së lejes së aktivitetit të biznesit Nuk ka kamion të posaçëm për transportimin e mbeturinave shtazore	
Mundësitë	GIZ ka interes për të ndihmuar Komunën Drenas në përmirësimin e sistemit të mbledhjes dhe largimit të mbeturinave KfW planifikon të ndihmojë me investime sistemin e menaxhimit të mbeturinave në Drenas	Komunës i vijnë mbeturina shtesë nga operatorë që hedhin mbeturina nga komunat përreth Ndotje me mbeturina i vjen komunës edhe nëpërmjet sistemeve ujore që kanë burimin nga komunat përreth, p.sh. përmes deponisë të Lipjanit Pajisjet e saldimit të kontenierëve nuk ndodhen në degën e "Pastrimit" në Drenas, por në qendrën në Prishtinë	Kërçenit

3.5 Trajtimi dhe riciklimi i mbeturinave, ndarja e mbeturinave në lloje në vend krijim

	<i>Favorizuese</i>	<i>Jo favorizuese</i>	
--	--------------------	-----------------------	--

	<i>Favorizuese</i>	<i>Jo favorizuese</i>	
P ë r p a r ë s i t ë	Një kompani lokale ble mbeturinat e ndara nga sektori informal Ndarja e mbeturinave të riciklueshme bëhet kryesisht nga sektori informal Një kompani lokale grumbullon mbeturina të riciklueshme Riciklimi i qelqit ka kosto shumë të ulët në Drenas 52 institucione mund të përfshihen lehtësisht në sistemin e grumbullimit të ndarë të mbeturinave Ka kontrata me operatorë mjekësorë, klinikat për dorëzimin e mbeturinave mjekësore në spital, qendrën e mjekësisë parësore për trajtimin e tyre Kostoja mesatare për ton për kompostimin e pastër të mbeturinave organike është më e ulët se kostoja e dërgimit dhe grumbullimit të tyre në deponi, respektivisht 38,5 € dhe 61 € Në komunë janë 21 qendra grumbulluese dhe çmontuese të autobetjeve	Nuk ka politikë dhe program të miratuar nga komuna për ndarjen e mbeturinave në burim Komuna nuk ka miratuar një politikë të qartë nga kuvendi i komunës për mbështetjen e iniciativave private për ndarjen e materialeve të riciklueshme me anë të impianteve Nuk ka sistem publik të ndarjes së mbeturinave nga shërbimi publik i komunës Komuna nuk ka impiant të ndarjes së mbeturinave Stacioni i transferimit nuk plotëson kushtet minimale mjedisore për ndarje të mbeturinave Mjete financiare të pakta të komunës për stimulimin e ndarjes së mbeturinave në lloje në vend krijim dhe ripërdorimin e tyre “Pastrimi” nuk ka mjetet e nevojshme financiare dhe teknologjike për ndarjen e mbeturinave Nuk ka sistem publik që lehtëson kompostimin Përzjerja e mbeturinave të ngurta me ato të lëngëta në kazanë, dëmton cilësinë e riciklimit Nuk ka informacion për trajtimin dhe riciklimin formal të mbetjeve Komuna nuk ka të dhëna për numrin e mbledhësve të mbeturinave të riciklueshme Nuk ka informacion të plotë për sasi të mbetjeve organike të kompostuara, një numër i vogël i familjeve fermere bëjnë kompostim Komuna nuk ka një qendër për dorëzimin e mbeturinave të riciklueshme nga familjet dhe bizneset dhe nuk ka të zhvilluar një analizë për ngritjen e kësaj qendre Komuna nuk ka një plan për përdorimin e mbeturinave inerte për mbushje të hapësirave publike Komuna nuk ka bërë një hulumtim për investorët që kanë interes për riciklimin e mbeturinave të komunës Në komunë nuk ka një kyçje të institucionalizuar të sektorit privat në ndarjen në burim të mbeturinave Shkollat në komunë nuk janë të kyçura në ndarjen në burim të mbeturinave Komuna nuk ka një politikë të ofrimit falas për familjet të	D o b ë s i t ë

	<i>Favorizuese</i>	<i>Jo favorizuese</i>	
		qeseve plastike për ndarjen në burim të mbeturinave të kuzhinës Hedhja e mbeturinave mjekësore në kontenerët e koshat publik rrezikon shëndetin e njerëzve dhe dëmton cilësinë dhe vlerën e mbeturinave të riciklueshme Jo të gjitha mbeturinat mjekësore dërgohen në spital për t'u sterilizuar, djegur dhe deponuar Komuna nuk ka të dhëna të sakta se sa mbeturina mjekësore prodhohen dhe sa % e tyre dërgohen për sterilizim dhe asgjësim Shtëpitë e shëndetit nuk kanë kosha të veçantë për magazinimin dhe kamionë të veçantë për transportimin ditor të mbeturinave mjekësore tek spitali i Drenasit Komuna është larg shënjestrës kombëtare prej 30% për ndarjen e mbeturinave të riciklueshme	
Mundësitë	Mbeturinat mjekësore digjen në incinerator Potenciali për rikuperim dhe riciklim të mbeturinave është i madh Në deponinë e Mirashit, e cila u shërben 7 komunave, nuk ka ndarje informale në deponi të mbeturinave të riciklueshme GIZ po mbështet projektin për ndarjen në burim të mbeturinave të riciklueshme në qendër të qytetit në bashkëpunim me komunën, shkollat dhe bizneset e Drenasit Në komunën Drenas ka një kompani riciklimi që blen mbeturina të riciklueshme të ndara Interesi për rikuperim dhe riciklim të mbeturinave nga sektori privat është në rritje Personat që menaxhojnë mbeturinat e biodegradueshme duhet të jenë të licencuar (neni në 52) Në 2017 EC planifikoi ndërtimin e një impianti të trajtimit të mbeturinave shtazore Qeveria qendrore është shprehur se ka prioritet kompostimin e mbeturinave organike Në Kosovë ka rreth 85 operatorë që merren me grumbullimin e mbeturinave të riciklueshme Në Kosovë ka 6 operatorë të licencuar për riciklimin e mbeturinave (Raporti i AMMK, 2014)	Nuk ka informacion nga AMMK (raporti i 2014) se sa mbeturina mjekësore digjen në incineratorin e spitalit të Drenasit Shkalla e ulët e trajtimit, riciklimit dhe ripërdorimit të mbeturinave në nivel Kosove Nuk ka në Kosovë një impiant të trajtimit të mbeturinave shtazore	Kërcënimet

<i>Favorizuese</i>	<i>Jo favorizuese</i>	
Ka eksperiencë në Kosovë për kompostim të pastër (rasti i Klinës), por kjo iniciativë nuk ka vazhduar		

3.6 Deponimi përfundimtar i mbeturinave

<i>Favorizuese</i>	<i>Jo favorizuese</i>	
Deponia rajonale gjendet në Mirash të Obiliqit, me sip. 50ha, ndërtuar në 2004 me financim të BE, ka filluar operimi në 2005, gjendet 30–40 km nga qyteti Drenas, u shërben edhe komunave Prishtinë, Obiliq, Lipjan dhe Fushë Kosovë Kapaciteti total është 3.500.000 m³, ai muaj 6.000 ton Kohëzgjatja e deponisë planifikuar për 15 vjet 94% e mbeturinave janë deponuar në Mirash, 6% në Prishtinë e Mitrovicë, (2014) 7 vend–hedhje mbeturinash të rehabilituara, aktualisht në gjendje të mirë Ka një vend të caktuar për mbeturinat inerte dhe po identifikohet i dyti 17 deponi janë pastruar nga komuna 13 deponi parashikohen të pastrohen gjatë këtij viti; momentalisht po tenderohet pastrimi i deponive ilegale, sipas buxhetit të 2015, (15.000 €) Komuna ka një kornizë kontraktuale me operatorë privat për pastrimin e deponive ilegale Nxënësit e shkollave të mesme parashikohen që të ndërmarrin aktivitete për identifikimin e deponive ilegale	Të gjitha mbeturinat e grumbulluara dërgohen në deponi nga 'Pastrimi' (2,827 tonë në vit, 2014, 200-290 tonë në muaj, apo 2% të RKS) Sasia vjetore e mbetjeve që deponohen po rritet Dërgimi në deponi i mbeturinave komunale të përziera me mbeturina shtazore, inerte, të vëllimshme, të rrezikshme 5 vjet jetëgjatësi ka mbetur për deponinë Deponimi i mbeturinave në disa vende, në Mirash, fabrikën e ferronikelit, Prishtinë (6%), Mitrovicë Shumica e mbeturinave janë hedhur në deponin e fabrikës së Ferronikelit deri 2012, pavarësisht se deponia e Mirash ka filluar operimin në 2005 Deponia me probleme të ndotjes së mjedisit, kushtet teknike dhe teknologjike të deponisë jo të mira, mosfunksionimi i pompave ka sjellë si rrjedhojë edhe krijimin e një baseni me ujëra të ndotura të cilat përzihen me ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore (Raporti i AMMK, 2014) Nuk bëhet shtypja dhe mbulimi i rregullt i mbeturinave, që ka ndikuar në zvogëlimin e hapësirës për deponimin e mbeturinave (Raporti i AMMK, 2014) dhe uljen e jetëgjatësisë Djegia e mbeturinave në deponi është shpesh evidente (Raporti i AMMK, 2014) Mungesë e raportimit në kuvendin e komunës nga departamenti i shërbimeve publike për kushtet teknike, e mjedisore në deponi Një numër vend-hedhesh ilegale gjenden në disa fshatra, 4 vend–hedhje në gjendje të keqe Mungesë e një raporti me informacion të saktë dhe të përditësuar për kushtet dhe sasinë e mbeturinave në vend-hedhjet ilegale ekzistuese dhe masat që duhen ndërmarrë	D o b ë s i t ë

	<i>Favorizuese</i>	<i>Jo favorizuese</i>	
		Komuna nuk ka pronësi mbi deponinë, është rajonale Komuna nuk ka një sistem efektiv të monitorimit të deponive të egra -MAS Një pjesë e konsiderueshme e deponisë është mbushur me mbeturina inerte, nuk ka një të dhënë të saktë sa tonë mbeturina inerte gjenden në deponi Në fshatra nuk ka vende të përkohshme për hedhjen e mbeturinave inerte, kryesisht në fshatrat që janë larg deponisë së inerteve	
Mundësitë	Ka legjislacion kombëtar për kushtet mjedisore në deponi Liçencimi i kompanive për operimin e deponive bëhet nga Ministria e Mjedisit Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë (AMMK) përgatiti raportin vjetor për gjendjen e deponive në Kosovë Ministria e Mjedisit ka nxjerrë urdhër për ndalimin e hedhjes së mbeturinave komunale të ngurta në deponinë e ferronikelit	Kompania e Kosovës përgjegjëse për menaxhimin e deponisë, është faktor që ul përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të komunës në standardet e deponisë dhe investimet e nevojshme për të shmangur dëmet mjedisore dhe shëndetësore	Kërcënimet

3.7 Financimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave

	<i>Favorizuese</i>	<i>Jo favorizuese</i>	
Përparesitë	Tarifa e hyrjes në deponinë e Mirashit 6€ për ton e përballueshme nga komuna Drenas Rritja e tarifës nga 4,14€ (plus TVSH) në 4,31€, periudha 2012 –2013, ndihmon në përballimin e kostonë së shërbimit Gjatë periudhës 2011 – 2015, janë trefishuar të ardhurat nga familjet, nga 35,043€ në 91,165€ 2 herë është rritur faturimi për familjet dhe bizneset, për periudhën 2011-2015 85% e familjeve që u ofrohet shërbimi janë faturuar në 2015 (2,451 nga 2,886), 50% në 2011 (1,248 nga 2,500) 74,5% e bizneseve aktive që u ofrohet shërbimi janë faturuar, 412 nga 553 biznese (në 2015) Potencial i madh për rritjen e të ardhurave nga tarifa e MM, deri në 0,5 milion € 317,885€ potencial për rritjen e të ardhurave nga familjet e faturuara (91,164 € mbledhur në 2014) 28,126€ potencial për rritjen e të ardhurave nga bizneset e	60% e familjeve që faturohen paguajnë tarifën Faturimi i ulët për institucionet– 50% (23) Në disa fshatra familjet nuk kanë paguar tarifën, gjë që ka çuar në ndërprerjen e shërbimit Kushtet e këqija të rrugëve shtojnë kostot operative të "Pastrimit" 61€ kosto për ton për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave, e lartë Tarifa aktuale për MM përdoren ato të përcaktuara nga ZRRUK Komuna nuk ka përcaktuar tarifën me autoritetin që jep ligji për mbeturinat Tarifa për mbeturinat shtazore nuk është e përcaktuar nga komuna Nuk grumbullohet tarifa për thertoret dhe mishtoret 14% e shumës vjetore të faturuar është për bizneset,	Dobësitë

	<i>Favorizuese</i>	<i>Jo favorizuese</i>	
	faturuara (13,969 € mbledhur në 2014) 79% e shumës vjetore të faturuar është për familjet, 2015 74% e shumës vjetore nga tarifat paguhet nga familjet, 2015	2015 11% e shumës vjetore nga tarifat paguhet nga bizneset, 2015 7% e shumës vjetore të faturuar është për institucionet, 2015 15% e shumës vjetore nga tarifat paguhet nga institucionet, 2015 Kulturë e ulët e pagesës së taksave nga bizneset për komunën Papunësia e lartë në komunë Ekonomia informale është punësues i madh në komunë (punëtorja, Prill 2015) Nuk ka një politikë të qartë për shkallëzimin e tarifës për familje sipas gjendjes ekonomike 30% mospagesa nga faturimet, ose 53,927€ (123,854€ të mbledhura nga 177,781 faturuar) Kulturë e ulët e pagesës së taksave nga bizneset (auditi) Në Mirash ndodh që pagesa për eshtrat bëhet 6€ për ton, pasi janë të përziera me mbeturinat e tjera të kontenierëve publik, ndërkohë që për deponimin e eshtrave duhet paguar 90€	
Mundësitë	GIZ po asiston Komunën Drenas për profilizimin e klientëve dhe modelin e tarifave për mbeturinat, dhe për mekanizmat për inkasim Komuna cakton tarifat dhe mënyrën e mbledhjes së mjeteve financiare për MM (Ligji nr. 04/ L-060, 2012 për Mbeturinat, neni 15) Financimi i menaxhimit të mbeturinave sigurohet edhe nga buxheti i Republikës së Kosovës (neni 59) Mjetet e komunës mund të përdoren për stimulimin e ndarjes së mbeturinave në lloje në vend krijim dhe pas mbledhjes së tyre, edhe për riciklimin (neni 60)	Rehabilitimi i nevojshëm i deponisë në Mirash do të rrisë kostot e deponimit të mbeturinave, si rezultat edhe tarifën Tarifat aktuale për MM janë të përcaktuara nga ZRRUK dhe përdoren nga "Pastrimi" Tarifat për deponimin e mbeturinave komunale i cakton Ministria e Zhvillimit Ekonomik në bashkëpunim me komunën Amnistia në 2013 për subjektet që nuk kanë paguar tarifën e mbeturinave dekurajon rritjen e nivelit të inkasimit të tarifës	Kërcënimet

3.8 Ndërgjegjësimi

	<i>Favorizuese</i>	<i>Jo favorizuese</i>	
Përpaj	Pjesëmarrja e kënaqshme e bashkësisë në projektet e komunës për pastrimin Kulturë në 72% e familjeve të faturuara për pagesën e	Konceptet e minimizimit, ndarjes e riciklimit të mbeturinave pak të promovuara në komunë Hedhja e shpeshtë e mbeturinave në zona publike,	Do bëhet

r ë s i t ë	tarifës Informacioni i publikut për çështjet e mbeturinave është ndarë dhe bashkëpunuar me të gjithë administratorët e fshatrave Rreth 5,000 nxënës në shkollat e mesme mund të angazhohen në aktivitete Fushata sensibilizuese janë ndërmarrë nga CEDE në shkollat e komunës, me nxënësit dhe mësuesit, për çështjen e mbeturinave	sheshe mes pallatesh, jashtë kontenerëve dhe koshave Hedhja e shpeshtë e mbeturinave si xhama, dhera, inerte, kopshtari etj, në kazanë e kosha Hedhja e mbeturinave në mjedis është e zakonit në shumicën e fshatrave Konceptet e minimizimit, ndarjes e riciklimit të mbeturinave pak të promovuara në komunë Sistemi i informimit të publikut për çështjet e ndarjes, minimizimit, riciklimit, jo efçente Përfshirje e dobët e shoqërisë civile në iniciativat për vetëdijësimin e publikut Shoqëria civile ka përfshirje dhe propozime për vetëdijësimin Komuna ka bashkëpunim me OJQ vendore që janë të mirangazhuara për çështjet e mbeturinave Aktualisht nuk ka në kurrikulën e shkollave të mesme në Drenas mundësi përzgjedhjeje të menaxhimit të mbeturinave Komuna nuk ka një program për përfshirjen e komunitetit në monitorimin e cilësisë së shërbimit të pastrimit publik	i t ë
M u n d ë s i t ë	Emisione televizive kombëtare të shtuara për vetëdijësimin e popullatës për mbajtjen pastër, ndarjen, minimizimin dhe riciklimin Projekte donatore të shtuara për mbështetjen e OJF-ve për vetëdijësimin e publikut për mbeturinat dhe mbrojtjen e shëndetit	Mungesa e programeve qeveritare për vetëdijësimin e publikut për mbeturinat Fonde të pakta për shoqërinë civile nga donatorët për projekte të vetëdijësimin publik	K ë r c ë n i n e t

4 Planifikimi i menaxhimit të mbeturinave

4.1 Fushëveprimi i planit (përkufizimi hapësinor dhe i përkohshëm, objektivat e mbeturinave)

Ky plan i menaxhimit të mbeturinave përqendrohet në mbeturinat e ngurta dhe mbeturinat e ngjashme nga bizneset dhe industritë e vogla, si dhe në mbeturinat e ndërtimit. Është hartuar për një periudhë kohore prej pesë viteve, përkatësisht për vitet 2016–2020.

4.2 Planifikimi strategjik (vizioni dhe objektivat)

4.2.1 Vizioni

Vizioni ynë për menaxhimin e mbeturinave të ngurta është në përputhje me politikat e BE-së dhe me ato të Republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave dhe është hartuar nga Këshilli për Partneritetet për ta përshkruar drejtimin e ardhshëm dhe frymëzimin për ndryshimin e komunitetit tonë:

Drenasi: Komunë me mjedisin më të pastër dhe më të shëndoshë në Kosovë që i përdor burimet e veta për ta ushqyer konceptin e komunës pa mbeturina, me një komunitet që është krenar që është pjesë e sistemit 3R dhe që përfiton nga vlera ekonomike e mbeturinave.

Vizioni ynë është i rrënjësor në realitetin natyror, gjeografik, ekonomik dhe kulturor të komunitetit tonë dhe i përmbledh në mënyrë reale ambiciet dhe kapacitetet e tij. Ai ofron një udhëzim për veprim për komunitetin, qeverinë komunale dhe partnerët tanë dhe i frymëzon përpjekjet e përbashkëta për ta vënë Drenasin në ballë të menaxhimit të qëndrueshëm të mbeturinave në Kosovë dhe rajon. Në të theksohet se për ne është e rëndësishme që ta ofrojmë një shërbim efikas, efektiv dhe të vlefshëm për paratë që paguhet për të, me një përfshirje të lartë të komunitetit, dhe që konsumatori të jetë i kënaqur.

Ne i shohim mbeturinat si resurs, ndërsa e kuptojmë se reduktimi, riciklimi dhe ripërdorimi i mbeturinave, disa përmes kompostimit, do të thotë se shpenzohen më pak para në mbledhjen dhe deponimin e mbeturinave dhe se, duke e bërë këtë, shëndeti dhe mjedisi ynë mbrohen më mirë, mirëqenia e komunitetit tonë mbrohet më mirë dhe paratë publike shpenzohen më mirë.

Ne jemi të përkushtuar që t'i kontribuojmë menaxhimit të qëndrueshëm të mbeturinave, reduktimit të mbeturinave që dërgohen në deponi dhe reduktimit të gazrave serrë që lirohen në hapësirë. Ne synojmë që Vizionin tonë ta përhapim vazhdimisht në komunitetin tonë dhe e aktorët tanë, meqë jemi të përkushtuar që të ndikojmë në sjelljet e aktorëve dhe t'i angazhojmë ata në realizimin e këtij Vizioni, sepse besojmë se partneritetet e qëndrueshme

dhe të llojllojshme mund t'i trajtojnë suksesshëm sfidat e mbrojtjes së mjedisit dhe ndryshimeve klimatike.

Vizioni ynë synon ta sigurojë një mjedis të pastër dhe të shëndoshë natyror dhe t'i pakësojë ndikimet negative që i shkaktojnë ndryshimet klimatike.

Në realizimin e Vizionit tonë, ne jemi të përkushtuar që t'i sigurojmë të gjitha politikatat dhe resurset e nevojshme dhe që të jemi inovativë në veprimet e tona, në mënyrë që ta inkurajojmë menaxhimin e përgjegjshëm të mbeturinave dhe respektimin e hierarkisë së mbeturinave.

4.2.2 Objektivat

Objektivat e planit MMN i saktësojnë rezultatet e dëshiruara që komuniteti ynë synon t'i arrijë. Po ashtu, ato i identifikojnë faktorët dhe përcakton se çfarë duhet të shqyrtohet në këtë plan për ta siguruar menaxhimin e përgjegjshëm të mbeturinave. Këto objektiva janë thelbësore për monitorimin dhe vlerësimin e planit dhe ofrojnë një bazë për vlerësimin e performancës dhe të strategjive për përmirësim.

Grupi Punues i ka përcaktuar tetë objektivat në vijim për ta mbështetur realizimin e Vizionit tonë:

1. Ndërtimi i kapacitetit njerëzor dhe institucional dhe partneritetet e suksesshme që garantojnë menaxhimi i mbeturinave mjedisore dhe mbulimi i plotë i shpenzimeve sipas parimit 'ndotësi paguan'.
2. Mbledhja dhe deponimi i mbeturinave për të gjithë banorët dhe bizneset e komunës së Drenasit.
3. Krijimi i një sistemi modern, të integruar dhe efektiv të menaxhimit të mbeturinave që është efikas për nga kostoja dhe që e siguron vlerën më mirë për paratë publike.
4. Largimi i sigurt i mbeturinave të rrezikshme, kryesisht mbeturinave të kafshëve dhe mjekësore.
5. Reduktimi i sasisë së mbeturinave që shkon në deponi përmes trajtimit, ripërdorimit dhe përgatitjes për riciklimin e mbeturinave, duke krijuar dobi mjedisore dhe financiare për komunitetin dhe bizneset.
6. Deponimi i mbeturinave sipas standardeve që garantojnë mbrojtjen e shëndetit të njeriut, mjedisit dhe biodiversitetit.
7. Përfshirja aktive e komunitetit dhe partnerëve në reduktimin e prodhimit të mbeturinave dhe në menaxhimi i mbeturinave në mjedis.
8. Qëndrueshmëria financiare e shërbimeve të menaxhimit të integruar të mbeturinave që do ta siguronte shtimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe standardeve të shërbimit të mbeturinave.

4.3 Plani i punës

Grupi Punues ka përcaktuar gjithsej 73 masa për t'i trajtuar të gjitha elementet e sistemit të menaxhimit të mbeturinave. Këto masa duhet të mbështeten nga komuna si dhe nga partnerët e saj në komunitet gjatë tërë realizimit të planit.

Meqë ka një ndërvarësi midis të gjitha elementeve të sistemit të menaxhimit të mbeturinave, vendimi duhet të bazohet në vlerësimin e opsionit të sistemit si tërësi e jo vetëm duke i shikuar elementet e vetme. Për shembull, edhe nëse riciklimi nuk garanton profit, ai mund të justifikohet me kursimin e shpenzimeve në deponi dhe me vëllimin e deponisë.

Mbledhja e mbeturinave, fshirja, transportimi dhe deponimi mund të konsiderohen elemente themelore të një sistemi të menaxhimit të mbeturinave që kërkohet që çdo rast. Nevojë për një vendim ka sidomos në fushën e riciklimit dhe trajtimit të mbeturinave.

4.3.1 Identifikimi dhe skanimi i opsioneve (komponentët e MN-së)

Vlerësimi i opsioneve është prezantuar nga FLAG-u dhe është diskutuar me Këshillin për Partneritet të Drenasit për Mjedis të Shëndoshë gjatë një punëtorie të veçantë. Opsionet kanë trajtuar dhe shtjelluar potencialin e arritjes së caqeve që janë përcaktuar në strategjinë kombëtare kosovare për menaxhimin e mbeturinave dhe zbatimit të sistemit të MMN-së sipas Ligjit për Mbeturinat.

Pas prezantimit të opsioneve të përgjithshme, Grupi Punues i Drenasit e shqyrtoi përshtatshmërinë dhe mundësinë e realizimit të tyre. Kjo analizë, dhe vendimi i Grupit Punues për çështjet e diskutuara, e përcaktuan bazën dhe udhëzimet për të gjitha masat që janë përvijuar në matricën e planit të punës, duke përfshirë përshtatjen e caqeve për Drenasin. Më poshtë janë përvijuar opsionet që kanë shërbyer si udhëzime për formulimin e masave që janë përfshirë në matricën e planit të punës.

4.3.1.1 Opsionet për zgjerimin e shërbimit dhe pajisjet për mbledhjen e mbeturinave

Bazuar në analizën e situatës që është paraqitur në kapitullin 2 të këtij dokumenti, prioritet për komunën e Drenasit është zgjerimi i shërbimeve të mbledhjes së mbeturinave, i cili ndërlidhet drejtpërsëdrejti me fushat që nuk mbulohen nga sistemi i mbledhjes së mbeturinave.

Mbledhja e mbeturinave në zonat që janë zgjeruar kohëve të fundit, duke i përdorur kontejnerët 120l dhe 240l, është dëshmuar mënyrë efektive për mbledhjen e mbeturinave, posaçërisht në zonat rurale. Në zonën urbane, kontejnerët nga çeliku janë zakonisht të fortë dhe në ta vihen të gjitha llojet e mbeturinave – duke përfshirë mbeturinat e ngurta me dendësi të madhe, dheun dhe mbeturinat e fshira.

Grupi Punues ka vendosur se, për disa arsye, duke përfshirë djegien e mbeturinave, përdorimi i kontejnerëve të plastikës në zonën urbane nuk do të jetë opsion dhe se, në vend të tyre, shërbimi do të vazhdojë me kontejnerët e metalit 1.1m³.

Përzgjedhja e llojeve të kontejnerëve, në veçanti për zgjerimin e shërbimeve në zonat rurale, ka rezultuar në përvijimin e nevojës për specifikacionet e automjeteve që janë më efikase në një mbledhje relativisht më të mirë. Matrica e planit të punës, me masat e duhura, e pasqyron nevojën për një kamion të vogël kompaktues që është i përshtatshëm për viset malore me rrugë të këqija dhe me mekanizëm për kontejnerët 120l dhe 240l. Shpeshtësia e përdorimit të këtij kamioni në zonat rurale do të rishikohet duke u bazuar në kapacitetin e tij.

4.3.1.2 Monitorimi i mbeturinave

Plani i punës për menaxhimin e mbeturinave përfshin caqet për zgjerimin hap pas hapi të shërbimeve të mbledhjes së mbeturinave dhe kërkesat e tjera përkatëse.

Realizimi i objektivave dhe arritja e qaveve të planit të menaxhimit të mbeturinave si dhe cilësia dhe sasia e shërbimeve duhet të monitorohen me një sistem të monitorimit të performancës. Për ta nisur një proces të këtillë, duhet të evidentohen sasitë reale të mbeturinave, ndërsa masat specifike për krijimin dhe mirëmbajtjen e regjistrave të mbeturinave që kërkohen me ligj të përfshihen në kuadër të masave përkatëse.

Kjo lehtësohet me stacionin e sapokrijuar të transferit për Drenasin. Peshorja në këtë stacion të transferit duhet të jete funksionale në mënyrë që të evidentohet pesha, detajet për datën dhe kohën, numrin e identifikimit të automjetit, burimin e dorëzimit dhe llojin e mbeturinave të transferuara në bazë të së ciles mundësohet monitorimi dhe performanca e tyre.

Të dhënat në stacionin e transferit duhet të regjistrohen në mënyrë digjitale në mënyrë që rezultatet të mund të integrohen lehtë në sistemin e monitorimit të performancës.

Përveç sasive të mbeturinave që sillen në deponi, të dhënat teknike dhe të dhënat financiare mund të regjistrohen në sistemin e njëjtë, në mënyrë që të monitorohet performanca financiare e mbledhjes.

Sistemi i monitorimit duhet të jetë kompatibil me kërkesat kombëtare dhe raportimin tek Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Prandaj, matrica e planit të punës përcakton një tërësi të masave për sistemin e të gjitha të dhënave të nevojshme për mbeturinat.

4.3.1.3 Riciklimi

Grupi Punues i Drenasit për Mjedis të Shëndoshë i ka diskutuar caqet e riciklimit, duke i marrë parasysh edhe caqet që janë përcaktuar në Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbeturinave.

Në përgjithësi, riciklimi mund ta luajë një rol me rëndësi në Drenas. Masat që kanë të bëjnë me riciklimin do të synojnë reduktimin e sasisë së mbeturinave që hidhen si dhe ndikimin negativ të tymit që emetohet nga deponia.

Potenciali i përgjithshëm për riciklim në Drenas duke u bazuar në udhëzimet kombëtare për përbërjen dhe sasi të mbeturinave deri në 2,500 tonë për vit.

Grupi Punues i Drenasit është pajtuar se potenciali për riciklim nuk do të jetë i mundshëm për ca kohë, deri sa mekanizmat e duhur për mbledhjen e ndarë dhe trajtimin e mbeturinave të riciklueshme të përdoren me sukses. Prandaj, një sistem i plotë e ndarjes së mbeturinave të riciklueshme nuk konsiderohet i përshtatshëm në këtë kohë.

Grupi Punues ka rekomanduar nisjen e aktiviteteve të ndarjes së mbeturinave të riciklueshme në disa lokacione të koncentruara me shkallë të lartë të mbledhjes, p.sh. në qendër të qytetit. Në lokacionet e tilla mbledhet pjesa më e madhe e gjithsej mbeturinave të riciklueshme të mundshme që do të jenë në dispozicion. Zgjerimi i mëtejshëm i aktiviteteve të riciklimit do të bazohet në përparimin e bërë me pilot nismat dhe në logjistikën e mënyrës se si pilot projekti për riciklim, i cili është në zhvillim e sipër, mund të zgjerohet.

Pas përdorimit të suksesshëm të sistemeve të realizuara për riciklim në zonat urbane, aktivitetet e riciklimit mund të zgjerohen në fshatrat rurale.

Krahas sasisë së mundshme të mbeturinave të riciklueshme, metodat e mbledhjes dhe ndarjes e përcaktojnë sasinë dhe cilësinë aktuale të materialeve të riciklueshme për tu plasuar në treg.

Opsionet e riciklimit që janë diskutuar nga Grupi Punues kanë qenë i) mbledhja e përzier e mbeturinave komunale dhe ii) ndarja e materialeve të riciklueshme në objektin për ripërtëritje. Propozimet “për” dhe “kundër” dy opsioneve të diskutuara kanë qenë:

	Ndarja e materialeve të riciklueshme nga mbeturinat e përziera të amvisërisë	Mbledhja e ndarë e materialeve të riciklueshme
Për	Mund të sigurojë shkallë të lartë të ripërtëritjes Numër më i madh i materialeve mund të synohen për ripërtëritje si rezultat i ndarjes në burim	Punë më pak sfiduese për ndarje Teorikisht shkallë më të larta të përtëritjes Cilësi më e lartë e materialeve të riciklueshme të ndara
Kundër	Cilësi dhe potencial më i ulët për plasim në treg për shkak të ndotjes ose dëmtimit	Përpjekje më të mëdha për mbledhje dhe kosto më të larta për njësi

të materialeve të riciklueshme (p.sh. të letrës dhe qelqit)	Zakonisht kërkohet ndarja e pastajme, madje edhe në rast të mbledhjes së ndarë
Kushtet jo atraktive të punës për ndarje manuale	Në praktikë, shkallët e ripërtëritjes ka të ngjarë që të jenë më të ulëta

Grupi Punues po ashtu i ka diskutuar sistemet e mbledhjes dhe shkarkimit për mbledhjen e mbeturinave të riciklueshme dhe ka vendosur që të përfshijë pilot masa për fillimin e sistemit të mbledhjes derë më derë dhe sistemit të decentralizuar të shkarkimit, përmes përkufizimit të masave për ta analizuar mundësinë e përfshirjes së partneriteteve me sektorin privat, por jo vetëm me të. Megjithatë pritet që, në sistemin e sjelljes së mbeturinave, këtë sistem do ta përdorin dhe mbeturinat e riciklueshme të ndara paraprakisht te kontejnerët do t'i sjellin vetëm banorët e motivuar.

Për shkak të dendësisë së ulët të mbeturinave të riciklueshme, mbledhja e ndarë e mbeturinave kushton përherë më shumë se mbledhja e mbeturinave të përziera, sepse investimet shtesë për kontejnerë dhe, nëse ka nevojë, për automjete, i shtojnë punët administrative relevante si dhe koston e shërbimit.

Edhe integrimi i ricikluesve joformalë përmes përmirësimit të kushteve për punëtorët në atë sektor është paraqitur si domosdo në matricën e planit të punës.

4.3.1.4 Kompostimi

Ka një traditë të kompostimit të mbeturinave organike nga bujqësia dhe kopshtaria në Kosovë. Megjithatë, nuk ka ndonjë përvojë të kohëve të fundit në kompostimin e mbeturinave organike në dispozicion për shpërndarje. Grupi Punues i Drenasit ka theksuar se prodhimi i kompostit nga mbeturinat e përziera të amvisërisë është qasje e paqëndrueshme. Rekomandohet që kompostimi dhe mbledhja e ndarë e mbeturinave të kopshtit në burim të fillojë bashkë me disa pilot masa në zonat që kanë më shumë hapësirë dhe përvojë në prodhimin e kompostit të cilësisë së mirë. Për një masë të tillë të kompostimit do të përdoret kompostimi i thjeshtë në brazda, ngjashëm me përvojat e mëparshme të amvisërive në Kosovë.

Për t'i pakësuar rreziqet dhe për të fituar përvojë, kompostimi duhet të fillojë në nivel të pilot projekteve dhe të zgjerohet më vonë (nëse rezultatet janë premtuese).

4.3.1.5 Masat e korrigjimit për deponitë ekzistuese

Largimi i mbeturinave dhe rehabilitimi i deponive ekzistuese në Drenas janë diskutuar me Grupi Punues, duke përfshirë këtu një bazë të azhurnuar të të dhënave për deponitë. Inventari i deponive ka nevojë për një azhurnim të vazhdueshëm të gjendjes së tyre dhe kjo është përvijuar me masën përkatëse në matricën e planit të punës. Bazuar në vjetërsinë e deponisë, llojin e mbeturinave të deponuara dhe faktit se mbeturinat janë të pambuluara, sasi të mëdha të gazrave nuk pritet që të lirohen në deponi në planin afatgjatë. Megjithatë, sasi të gazit dhe

koncentrimi i metanit duhet të maten në deponitë e vjetra që kanë nevojë për masa të rehabilitimit.

Varësisht nga përbërja e mbeturinave dhe vendndodhja e deponisë, sa u përket zonave rezidenciale, mund të ketë nevojë për masa shtesë të shëndetit dhe sigurisë, siç janë spërkatja e materialeve për germim apo mbulojat e përkohshme gjatë heqjes dhe rehabilitimit të deponive.

4.3.1.6 Menaxhimi i rrjedhave të tjera të mbeturinave

Grupi Punues i Drenasit ka diskutuar edhe për llojet më të rëndësishme të mbeturinave të tjera, për shkak të sasisë dhe natyrës së rrezikshme të tyre. Këto përfshijnë mbeturinat e ndërtimit dhe rrënimit, mbeturinat e rrezikshme, mbeturinat shtazore (kryesisht nga mishtoret dhe thertoret) dhe mbeturinat mjekësore.

4.3.1.7 Mbeturinat e ndërtimit dhe rrënimit

Politika e BE-së i identifikon mbeturinat e ndërtimit dhe rrënimit si rrjedhë prioritare për shkak të potencialit të madh për riciklim dhe ripërdorim. Gjatë diskutimit në Grupi Punues është pranuar një potencial i tillë, p.sh. për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve, apo projektet për. Drenasi e ka pranuar edhe nevojën për t'u marrë me këtë lloj të mbeturinave duke e caktuar një lokacion për deponimin e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit.

4.3.1.8 Mbeturinat e rrezikshme

Disa masa që janë propozuar në planin e punës kanë të bëjnë me përmirësimin gradual të disa statistikave dhe komponentëve PR në mbeturinat e amvisërisë brenda rrjedhës së mbeturinave të rrezikshme. Aktualisht, nuk ka ndonjë opsion të caktuar qartë për deponimin e mbeturinave të rrezikshme dhe masat e propozuara mbesin të kufizuara.

4.3.1.9 Mbeturinat mjekësore

Për ta mundur mbledhjen, trajtimin dhe deponimin përfundimtar të mbeturinave të rrezikshme të spitalit, organizimi dhe menaxhimi i mbeturinave të rrezikshme të spitalit në nivel rajonal sigurohet përmes një incineratori në qendrën rajonale të shëndetit. Megjithatë, masat e mëtejme për fuqizimin e trajtimit të mbeturinave mjekësore dhe farmaceutike janë dizajnuar këtu, duke përfshirë masat për krijimin dhe mirëmbajtjen e të dhënave për mbeturinat mjekësore.

4.3.1.10 Mbeturinat shtazore

Për ta mundur mbledhjen, trajtimin dhe deponimin e sigurt të mbeturinave shtazore, inspektimi, mbledhja e të dhënave dhe monitorimi janë në fokus të masave që janë përfshirë në këtë plan.

4.3.1.11 Struktura institucionale

Komuna e Drenasit dhe kompania rajonale “Pastrimi” planifikojnë që t’i zbatojnë së bashku masat që janë paraparë në planin e punës.

Edhe deponia e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit do të operohet përmes një kompanie që ofron shërbim të ngjashëm.

Komuna e Drenasit aktualisht e konsideron bashkëpunimin me “Pastrimi” në sistemin e menaxhimit të mbeturinave si strukturë të cilën ajo do ta mbështesë dhe forcojë. Ende mbetet të vlerësohet dhe të përfitohet nga potenciali për përfshirjen e aktorëve të tjerë në zgjerimin dhe përmirësimin e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave. Komuna e sheh potencialin për ta përdorur sektorin privat të menaxhimit të mbeturinave në rrethana të veçanta kur kompanitë rajonale nuk janë në gjendje për të pasur qasje në objektet që tani janë në përdorim dhe për t’i përdorur ato.

4.3.1.12 Vetëdijesimi dhe pjesëmarrja publike

Masat e vetëdijesimit dhe pjesëmarrjes publike janë instrumente të rëndësishme për t’i përcaktuar caqet për menaxhimin e mbeturinave në Drenas. Kjo komunë është njëra nga komunat e pakta që është identifikuar si komunë me partneritet afatgjatë me organizatat e shoqërisë civile që ofrojnë mbështetje në aktivitetet e vetëdijesimit, në veçanti, për zgjerimin e zonës së shërbimit. Me ndihmën e masave që janë paraparë në planin e punës, qytetarët do të arrijnë t’i kenë njohuritë e nevojshme për përparësitë dhe dobitë që i ofron një sistem i përmirësuar në krahasim me dobësitë dhe dëmin nga sistemi ekzistues. Këto njohuri do të ndikojnë pozitivisht në pjesëmarrjen e qytetarëve dhe në vullnetin e tyre për të kontribuar edhe duke e ndryshuar sjelljen e tyre, edhe financiarisht.

Për më tepër, vizioni për menaxhimin e mbeturinave në Drenas mund të jetë i dobishëm kur përdoren fjalët kryesore për ta qartësuar qëllimin e përgjithshëm të sistemit të menaxhimit të mbeturinave në komunë.

Pjesëmarrja e publikut në procesin e vendimmarrjes për mbeturinat është qenësore për lehtësimin e vënies në zbatim të sistemit të menaxhimit të mbeturinave. Prandaj, rekomandohet që të ruhen mekanizmat e bashkëpunimit, siç është Këshilli për Partneritet, çfarë është reflektuar edhe në masat që janë artikuluar në planin e punës.

4.3.1.13 Financimi i shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave

Grupi Punues dhe komuna në veçanti, e pranon se, pas autorizimit që i është dhënë para pak kohësh komunës për t’i caktuar tarifat e menaxhimit të mbeturinave, komunës i duhet që:

- ta krijojë një sistem të inkasimit për mbledhjen e mbeturinave të ngurta
- ta caktojë tarifën për mbeturina
- ta vlerësojë mënyrën aktuale të inkasimit

- ta shtojë efikasitetin e inkasimit aktual.

Efikasiteti i inkasimit mund të vlerësohet në bazë të të ardhurave potenciale po që se të gjitha amvisëritë dhe bizneset e paguajnë tarifën për mbeturina. Për përcaktimin e të ardhurave potenciale merren parasysh edhe amvisëritë dhe bizneset të cilave nuk u ofrohet ky shërbim.

Financimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave duhet të bazohet në kthimin e shpenzimeve dhe në parimin 'ndotësi paguan'. Grupi Punues është pajtuar me këto parime si objektiva kryesore të sistemit të menaxhimit të mbeturinave.

Një politikë e kthimit të shpenzimeve nevojitet për t'i financuar shpenzimet e tjera që ndërlidhen me shërbimet e përmirësuara. Në shumë sisteme të menaxhimit të mbeturinave në zhvillim qasja tradicionale është që shpenzimet e shërbimeve të mbeturinave të financohen nga të ardhurat e konsoliduara. Kjo qasje shpie në financim të ulët të shpenzimeve operative dhe në mungesë të resurseve për pajisje dhe për zëvendësimin e pajisjeve të amortizuara. Mbledhja e mbeturinave është e dukshme për publikun dhe asaj i jepet prioritet deri diku, por deponimi i mbeturinave shpesh neglizhohet. Një plan apo politikë e shëndoshë e rikthimit të shpenzimeve do ta mundësojë transformimin nga nivelet aktuale në shërbime të mbeturinave të shëndosha për mjedisin me kthim të plotë të shpenzimeve.

Në politikën e kthimit të shpenzimeve zakonisht identifikohen: hapat për përmirësimin e performancës dhe mbulimit me shërbime të menaxhimit të mbeturinave, shuma e shpenzimeve vjetore të ndërlidhura dhe mënyra se si këto fonde do të sigurohen. Gjatë llogaritjes së shpenzimeve për shërbimet e mbeturinave duhet të merren parasysh edhe shpenzimet e mbledhjes dhe deponimit të mbeturinave, edhe ato të operimit dhe mirëmbajtjes, të vjetërsimit të pajisjeve si dhe të parashikohen borxhet afatgjata (shpenzimet për mbylljen e celulave të deponive).

Tarifat e mbeturinave mundësojnë krijimin e të ardhurave të reja, meqë ato janë të arsyetueshme për qytetarët, për shkak se janë të nevojshme për ofrimin e një shërbimi publik të rëndësishëm. Nëse ato zbatohen si duhet, ato do t'i detyrojnë autoritetet komunale që të jenë llogaridhënëse, efikase dhe transparente sa u përket shpenzimeve dhe financimit të shërbimeve të ofruara.

Një pengesë tjetër objektive ndaj inkasimit të suksesshëm të tarifës së mbeturinave është mungesa e një regjistri të besueshëm të banorëve. Me të njëjtin problem përballet kompania e ujësjellësit.

Në matricën e planit të punës janë përfshirë disa masa për të bërë përparim në drejtim të një sistemi të duhur të analizës financiare për mbeturinat. Këto masa përfshijnë edhe krijimin dhe mirëmbajtjen e një regjistri të përdoruesve të shërbimeve të mbeturinave, dërgimin e njoftimeve të herëpashershme amvisërive dhe përdoruesve për të gjitha pagesat e pakryera për shërbimet komunale (me informata për gjomat në rast të pagesës së vonuar apo

mospagesës) dhe miratimin e kthimit të plotë të shpenzimeve si cak i politikës komunale në lidhje me menaxhimin e mbeturinave.

Lirimi nga pagesa për shkak të gjendjes ekonomike (të dobët) duhet të kompensohet përmes ngritjes së tarifës për përdoruesit e tjerë, ose me anë të subvencionit nga komuna apo buxheti i shtetit. Në sistemet e zhvilluara sociale preferohet qasje e fondeve socialo-shtetërore për t'i mbuluar shpenzimet e shërbimit të mbeturinave për njerëzit e varfër.

Në matricën e planit të punës janë përfshirë disa masa për të bërë përparim në drejtim të një sistemi të duhur të analizës financiare për mbeturinat, duke përfshirë llojllojshmërinë e përdoruesve të sistemit të menaxhimit të mbeturinave dhe komunës që çon në të gjitha nismat për ta risistemuar financimin.

5 Matrica e planit të punës, temave të planit, objektivat, treguesit, të dhënat, programet dhe masat

Vizioni:								
Drenasi, komunë me mjedisin më të pastër e të shëndetshëm në Kosovë, që përdor burimet e saj materiale në mënyrë të qëndrueshme e kultivon konceptin e komunës pa mbeturina, me komunitet i cili krenarisht është pjesë e suksesit të sistemit 3R dhe e përfitimit të vlerës ekonomike të mbeturinave								
Fusha	Objektivi	Indikatori	Baza	Shënjestra	Programi	Kodi	Masa	Nr.
Kuari institucional	O1: Ndërtimi i kapaciteteve njerëzore dhe institucionale të avancuara dhe partneriteteve të suksesshme që garantojnë menaxhimin mjedisor të mbeturinave dhe mbulimin e plotë të kostos përmes parimit 'ndotësi paguan	% e realizimit të masave rregullatore në fushën e MM			O1:PG1: Përditësim i kuadrit legjislativ	O1:PG1:m1	Rishikimi i rregullores për mbeturinat komunale nga Asambleja e Komunës për të pasqyruar ndryshimet e ligjit "Për Mbeturina"; rregullat për menaxhimin e mbeturinave nga ndërtimet e prishjet e ndërtesave dhe të mbetjeve të tjera inerte; dhe që specifikon qendrat grumbulluese dhe të pranimit të pajisjeve elektrike dhe elektronike dhe të mbeturinave të rrezikshme shtëpiake (bojë, medikamente, bateri)	1
						O1:PG1:m2	Rishikimi i statutit (neni 81 dhe 82) për të specifikuar MMN si një funksion të Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë	2
		nr. i aplikimeve të suksesshme për fonde në fushën e MMN			O1:PG2: Zbatimi i legjislacionit	O1:PG2:m1	Trajnimi për inspektorët dhe zyrtarët e tjerë komunalë në zbatimin e rregullores të miratuara (përfshirë dhe ndëshkimet e gjobat)	3
						O1:PG2:m2	Përfshirja në të gjitha lejet për ndërtim dhe demolim që jep Komuna e vendit të deponisë së caktuar për dërgimin e mbeturinave inerte	4
						O1:PG2:m3	Ngritja e një sistemi të informimit për qytetarët, stafin komunal dhe të kompanisë, për shkelje të rregullave për menaxhimin e mbeturinave komunale	5
						O1:PG2:m4	Ngritja e një sistemi për monitorim dhe raportim, mbi shkeljet e rregullores për menaxhimin e mbeturinave komunale	6
						O1:PG2:m5	Forcimi i rolit të inspektoratit të Komunës mbi përdorimin e parregullt të shportave publike, për mbetjet e eshtrave, hirit, qelqit dhe mbeturinave ndërtimore	7
		% e të anketuarve që shprehin "të kënaqur" ose "shumë të kënaqur" mbi punën e sektorit të 1, MMN dhe 2, mbeturinave në anketimin vjetor			O1:PG3: Përmirësimi i politikave lokale për MMN	O1:PG3:m1	Shqyrtimi i përparësive për menaxhimin e mbeturinave komunale dhe rishikimi i strategjive përkatëse në pasqyrimin dhe integrimin në fushat e tjera prioritare	8
						O1:PG3:m2	Rritja e buxhetit komunal, vjetor dhe atij afatmesëm të komponentëve për masat në menaxhimin e mbeturinave komunale, përfshirë përmirësimin e shërbimeve në menaxhimin e mbeturinave, mbledhjen e ndarë, aktivitete të vetëdijësimit dhe pastrimin e zonave të ndotura	9
						O1:PG3:m3	Përpilimi, miratimi dhe përditësimi, çdo vit, i politikave tarifore për menaxhimin e mbeturinave komunale: bazuar në kategorizimin e klientëve, mbetjet inerte, prodhuesit e mbeturinave të kafshëve, vendndodhjen dhe llojin e biznesit, madhësinë dhe gjendjen ekonomike të	10

Plani i Menaxhimit të Mbeturinave i Drenasit

Fusha	Objektivi	Indikatori	Baza	Shënjestra	Programi	Kodi	Masa	Nr.
		nr. i inspektimeve nga inspektorati komunal për shkelje ligjore mjedisore			O1:PG4: Përmirësimi i njohurive dhe kapaciteteve komunale mbi MMN		amvisërisë	
						O1:PG3:m4	Raportimi i organeve përgjegjëse të Komunës çdo vit mbi gjendjen për menaxhimin e mbeturinave komunale në Kuvendin Komunal dhe në Ministrinë MMPH	11
						O1:PG4:m1	Ngritja dhe pajisja e njësive komunale për menaxhimin e mbeturinave brenda Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë	12
						O1:PG4:m2	Krijimi i platformës për bashkëpunim me qeverinë qendrore mbi çështjet e MMN, duke përfshirë shkëmbimin periodik të informacionit	13
						O1:PG4:m3	Krijimi i platformës për bashkëpunim me ekspertë të mbeturinave të kompanisë RMM, universitetin dhe OJQ-të	14
						O1:PG4:m4	Trajnimi i grupeve punuese dhe menaxherëve komunalë mbi buxhetimin për MMN, përcaktimin e tarifave dhe çështje të tjera të MM; trajnimi i personelit përgjegjës për komunikimet komunale rreth çështjeve të MM	15
						O1:PG4:m5	Shkëmbimi i përvojave me komuna të tjera në fushën e MMN	16
						O1:PG4:m6	Aftësimi i stafit për përpilimin e projekteve mbi aplikimin për fonde për aktivitete të lidhura me mbeturinat dhe pastrimin, në partneritet me sektorin privat dhe publikun	17
						O1:PG4:m7	Bërja e marrëveshjeve dhe nxitja e iniciativave të bashkëpunimit me OJQ-të që mbështesin aktivitete në fushën e menaxhimit të mbeturinave	18
					O1:PG5: Kujdesi për klientin	O1:PG5:m1	Ngritja e zyrës së informacionit dhe telefonit të gjelbër (24h) për menaxhimin e mbeturinave komunale	19
					O1:PG6: Përmirësimi i kapacitetit të kompanisë së menaxhimit të mbeturinave	O1:PG6:m1	Ngritja e sistemit për monitorimin dhe raportimin periodik mbi performancën e kompanisë RMM dhe performancën e menaxhimit të mbeturinave	20
						O1:PG6:m2	Sigurimi nga Komuna që kompanitë që ofrojnë shërbimin e menaxhimit të mbeturinave komunale kanë liçencën përkatëse	21
						O1:PG6:m3	Paraqitja në Komunë e planeve afatmesme dhe afatgjata të investimeve nga kompania RMM	22
						O1:PG6:m4	Publikimi nga Kompania RMM i raportit vjetor të auditimit të aktivitetit	23
Grumbullimi dhe transportimi i mbeturinave	O2: Grumbullimi dhe largimi i mbeturinave për të gjithë banorët dhe bizneset në Komunën Drenas	% e sip. rrugëve. trotuareve, shesheve që pastrohen % e mbulimit me shërbimin e largimit të mbeturinave a) të ekonomive familjare b) të bizneseve c) të institucioneve			O2:PG1: Zgjerimi i shërbimit të grumbullimit të mbeturinave	O2:PG1:m1	Zgjerimi i zonës së shërbimit bashkëngjitur zonave aktuale të shërbimit, duke përdorur kontenierë 120l dhe 240l	24
						O2:PG1:m2	Përfshirja e të gjitha bizneseve dhe institucioneve të zonës urbane në shërbimin e mbeturinave	25
						O2:PG1:m3	Blerja e automjeteve me mekanizmin përkatës për marrjen automatike të kontenierëve 120l dhe 240l për të mbuluar itineraret e reja	26
						O2:PG1:m4	Vazhdimi i zgjerimit të shërbimit të mbeturinave në të gjithë territorin e Komunës dhe përfshirja e të gjithë prodhuesve të mbeturinave në sistemin e faturimit	27
	O3: Ndërtimi i sistemit modern, të integruar dhe efektiv të menaxhimit të	nr. i ankesave mbi ofrimin e shërbimit			O3:PG1: Mbledhja dhe largimi i mbeturinave	O3:PG1:m1	Riorganizimi i pikave të grumbullimit të mbeturinave bazuar mbi udhëzimet kombëtare dhe lokale	28
						O3:PG1:m2	Identifikimi i përparësive për grumbullimin e mbeturinave nga ana e operatorëve privat në zona të caktuara	29
						O3:PG1:m3	Krijimi i sistemit për grumbullimin ose dorëzimin e mbeturinave të vëllimshme	30

Plani i Menaxhimit të Mbeturinave i Drenasit

Fusha	Objektivi	Indikatori	Baza	Shënjestra	Programi	Kodi	Masa	Nr.
	mbeturinave me efikasitet të kostove dhe shtim të vlerës së parasë publike	% e të anketuarve që vlerësojnë "sh.mirë" dhe "mirë" shërbimin e pastrimit dhe largimit të mbeturinave			O3:PG2: "Pastrimi" i rrugëve, parqeve, etj.	O3:PG2:m1	Caktimi i buxhetit për zbrazjen e shportave publike të vendosura në rrugë dhe sheshe	31
	O4: Largimi i sigurt i mbeturinave të rrezikshme, kryesisht i atyre shtazore e mjekësore	nr. i lejeve (mjedisore) për thertore që citojnë detyrimin mbi asgjësimin e eshtrave			O4:PG1: Mbeturinat e rrezikshme	O4:PG1:m1	Grumbullimi i të dhënave dhe rishikimi i sistemit për mbledhjen e sigurt të mbeturinave mjekësore, duke përfshirë monitorimin e zbatimit të kontratës nga ana e institucioneve shëndetësore	32
		nr. i pikave të grumbullimit për pajisjet elektrike dhe elektronike				O4:PG1:m2	Grumbullimi periodik nga agjencitë qeveritare qendrore i të dhënave mbi sasitë dhe llojet e mbeturinave të rrezikshme të prodhuara në komunë	33
		% e institucioneve shëndetësore (farmaci dhe qendra shëndetësore) që dorëzojnë mbeturinat në incineratorin rajonal				O4:PG1:m3	Bërja e analizës për vlerësimin e llojeve dhe sasisë së mbetjeve të rrezikshme shtëpiake	34
						O4:PG1:m4	Krijimi i sistemit të grumbullimit të pajisjeve elektrike e elektronike dhe të mbeturinave të tjera shtëpiake të rrezikshme (bojë, medikamente, bateri)	35
Trajtimi dhe riciklimi i mbeturinave	O5: Ulja e sasisë së mbeturinave që shkojnë në deponi nëpërmjet trajtimit, ripërdorimit dhe përgatitjes për riciklim të mbeturinave, me përfitime mjedisore dhe financiare për komunitetin dhe biznesin	% e mbetjeve të gjeneruara që shkojnë në deponi % e mbeturinave të trajtuara % e mbeturinave të ndara % e mbetjeve të biodegradueshme shkon në deponi		kombëtare: 30%, 20%, 70%	O5:PG1: Regjistrimi i llojeve të mbeturinave	O5:PG1:m1	Krijimi dhe mirëmbajtja e regjistrit të llojeve të mbeturinave dhe proceseve përkatëse të përpunimit të tyre	36
						O5:PG1:m2	Analiza e përbërjes dhe sasive të mbeturinave komunale	37
						O5:PG1:m3	Vlerësimi i sasisë së mbeturinave shtazore, të gjeneruara në tregun Komoran, Drenas, dhe të prodhuesve të tjerë	38
						O5:PG1:m4	Krijimi i sistemit për të vlerësuar sasinë e mbetjeve inerte dhe ndërtimore të prodhuara	39
						O5:PG1:m5	Vlerësimi i sasisë dhe llojeve të mbeturinave të ndara në mënyrë joformale për riciklim	40
					O5:PG2: Ndarja e mbeturinave biodegraduese dhe lëndëve dytësore bazë	O5:PG2:m1	Zbatimi i masave pilot për grumbullimin e ndarë të mbetjeve të riciklueshme të thata në institucione (plastikë, metale, letër)	41
						O5:PG2:m2	Krijimi i sistemit për grumbullimin e ndarë të mbeturinave në komunë dhe mbeturinave të kopshtarisë	42
					O5:PG3: Kompostimi	O5:PG3:m1	Inkurajimi i kompostimit, veçanërisht në zonat rurale të përzgjedhura	43
					O5:PG4: Riciklimi i lëndëve bazë dytësore	O5:PG4:m1	Hartimi i studimit mbi përdorimin e mbetjeve inerte në proceset e ndryshme, si një alternativë ndaj deponimit	44
						O5:PG4:m2	Hulumtim i operatorëve ekonomik që merren me trajtimin e mbetjeve të riciklueshme të thata, duke përfshirë mbetjet e qelqit si dhe lidhja e kontratës me kompani riciklimi për blerjen e mbetjeve të riciklueshme	45
						O5:PG4:m3	Trajnimi i stafit komunal mbi aspektet e 3R, kompostimit dhe bashkëpunimi me sektorin privat për kompostimin	46
						O5:PG4:m4	Përmirësimi i kushteve për grumbulluesit joformalë të materialeve të riciklueshme	47

Plani i Menaxhimit të Mbeturinave i Drenasit

Fusha	Objektivi	Indikatori	Baza	Shënjestra	Programi	Kodi	Masa	Nr.
						O5:PG4:m5	Bërja e analizës për mundësinë e krijimit të qendrës së dorëzimit të materialeve të riciklueshme (buy-back) me sektorin privat	48
Transporti në distancë dhe deponimi përfundimtar i mbeturinave	O6: Deponimi i mbeturinave me standarde që garantojnë mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, të mjedisit dhe biodiversitetit	ulja e koston së transportit			O6:PG1: Stacioni i transferimit dhe transporti në distancë	O6:PG1:m1	Vënia në funksionim të plotë e stacionit të transferimit	49
		mbetje që shkojnë në ST				O6:PG1:m2	Vlerësimi i kapaciteteve të transportit në distancë për të përcaktuar përdorimin optimal të automjeteve dhe kapaciteteve	50
		Sasia e mbetjeve që ndahen në fraksione				O6:PG1:m3	Hulumtimi i mundësisë për ngritjen e infrastrukturës për ndarjen e mbeturinave	51
		peshore, rrugë						
		% e deponive ilegale të rehabilituara	kombëtare: 2018 shënjestra 65% e mbetjeve shkon në deponi	O6:PG2: Rehabilitimi i deponive ilegale	O6:PG2:m1	Përditësimi dhe mirëmbajtja e bazës së të dhënave mbi deponitë ilegale, identifikimi i deponive joformale dhe krijimi i sistemit të monitorimit dhe raportimit	52	
					O6:PG2:m2	Rehabilitimi i territoreve të pastruara nga deponitë ilegale	53	
					O6:PG2:m3	Përpilimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me komunat fqinje për të parandaluar hedhjen e paligjshme të mbeturinave dhe ndotjen e trupave ujore të përbashkët	54	
				O6:PG3: Deponia e Mirashit	O6:PG3:m1	Përpilimi i një raporti në bashkëpunim me Komunën e Prishtinës dhe dërgimi i një kërkesë të përbashkët kompanisë së Deponisë së Mirashit për përmirësimin e standardeve të funksionimit të deponisë së Mirashit	55	
				O6:PG4: Mbeturinat inerte dhe të ndërtimit	O6:PG3:m1	Përgatitja për operim e deponisë për mbeturinat inerte dhe ndërtimore	56	
				O6:PG5: Depozitimi i mbeturinave të rrezikshme	O6:PG5:m1	Monitorimi i sasisë së mbetjeve mjekësore të trajtuara në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF)	57	
					O6:PG5:m2	Nisja e grumbullimit të ndarë të mbeturinave të rrezikshme shtëpiake dhe deponimi i përkohshëm nëpërmjet një ekipi lëvizës për grumbullim	58	
Vetëdijësimi i komunitetit dhe edukimi	O7: Angazhimi aktiv i komunitetit dhe partnerëve në uljen e sasisë së prodhimit dhe në menaxhimin mjedisor të mbeturinave	% e qytetarëve që marrin njohuri për menaxhimin e mbetjeve			O7:PG1: Rritja e ndërgjegjësimit mbi MMN	O7:PG1:m1	Bërja e fushatës vetëdijësuese me të gjithë komunitetin e zonës ku planifikohet zgjerimi i shërbimit, p.sh. Llapushnik, Baice, Çikatovë, me informacion në lidhje me përgjegjësitë e ndërsjellta për menaxhimin e mbeturinave dhe dobitë e tij për shëndetin dhe sigurinë e çdo konsumatori	59
		nr. i bashkëpunimeve qytetar –institucione				O7:PG1:m2	Krijimi i një linku në webfaqen e komunës për të ofruar informacion mbi shërbimet, praktikat e grumbullimit të mbeturinave	60
		nr. i broshurave ndërgjegjësuese të përgatitura për publikun				O7:PG1:m3	Bërja e fushatës vetëdijësuese në komunitet mbi praktikatat e menaxhimit të mbetjeve, duke përfshirë 3R	61
						O7:PG1:m4	Komunikimet e rregullta për opinionin qytetar përmes anketave për çështje të MMN që prekin komunitetin	62
		nr. (ose buxheti) i			O7:PG2: Ndërgjegjësim dhe	O7:PG2:m1	Organizimi i takimeve me ndërtuesit për nisjen dhe rregulloren e funksionimit të deponisë së mbetjeve inerte	63

Plani i Menaxhimit të Mbeturinave i Drenasit

Fusha	Objektivi	Indikatori	Baza	Shënjestra	Programi	Kodi	Masa	Nr.
		nismave komunitare mbështetur nga komuna			informim mbi mbetjet specifike me prodhuesit	07:PG2:m2	Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve informative mbi ndikimin e mbetjeve të rrezikshme në shëndetin e njeriut dhe në mjedis	64
						07:PG2:m3	Bërja e fushatës vetëdijësuese me prodhuesit e mbetjeve shtazore në dy tregjet kryesore blegtorale, për çështjet e shëndetit që shkaktojnë mostrajtimi dhe asgjësimi i papërshtatshëm	65
Menaxhimi financiar i shërbimit të integruar të mbeturinave	O8: Qëndrueshmëria financiare e shërbimit të menaxhimit të integruar të mbeturinave, në bashkëpunim të ngushtë me qytetarët, për të mundësuar rritjen e vazhdueshme të cilësisë dhe standardeve të shërbimit	% e familjeve paguese të tarifës së pastrimit	85%		O8:PG1: Përmirësimi i kapaciteteve për grumbullimin e tarifës	08:PG1:m1	Monitorimi i të ardhurave nga tarifat aktuale dhe potencialet e të ardhurave, në të gjithë territorin e komunës	66
		% e bizneseve paguese të tarifës së pastrimit	33%			08:PG1:m2	Konsolidimi dhe mirëmbajtja e regjistrit të saktë të klientëve në komunë: banorëve, bizneseve dhe institucioneve	67
		% e institucioneve paguese të tarifës së pastrimit	85%			08:PG1:m3	Analizimi i skenarëve për mbulimin e kostos nga të ardhurat e tarifave të mbeturinave, duke marrë në konsideratë grupet e marginalizuara	68
		% e mbulimit të kostos operative të shërbimit të ardhura nga kontrata të veçanta	08:PG1:m4			Përgatitja e një studimi mbi sistemet e grumbullimit të tarifave për amvisëritë, bizneset dhe institucionet (p.sh. komuna mbledh taksat vetë ose përmes agjentëve)	69	
			08:PG1:m5			Instalimi i sistemit TIK për kontabilitetin, lidhur me llojet e konsumatorëve dhe shumat e mbeturinave të grumbulluara dhe asgjësua	70	
			08:PG2: Rritja e numrit të klientëve që paguajnë tarifën e pastrimit	08:PG2:m1	Ndërtimi dhe funksionalizimi i mekanizmit që mundëson faturimin e të gjithë klientëve që marrin shërbimin e grumbullimit dhe largimit të mbeturinave	71		
		08:PG2:m2	Stimulimi i pagesve të rregullt përmes politikës fiskale lehtësuese	72				
		08:PG2:m3	Dizenjimi dhe prezantimi i stemës së gjelbër për bizneset paguese	73				

6 Plani financiar dhe i veprimit për planin afatshkurtër dhe afatmesëm

6.1 Planifikimi financiar, kontribuuesit, aktorët, partnerët, grupet e synuara dhe kohëzgjatja

Në tabelën e mëposhtme janë raportuar prioritetet kryesore për vitin 2016 (të hijezuara) dhe për të cilat ka një plan të veprimit; janë hijezuar edhe ata që i kontribuojnë kësaj mase. Prioritetet e tjera janë shënjuar. Informatat që mungojnë mund të plotësohen si pjesë e monitorimit dhe rishikimit të planit.

Nr.	Masa	Prioritet për vitin 2016	Vlera (€)	Kontributi financiar								Aktorët	Partnerët	Fillimi	Fundi	Grupet e synuara
				Komuna		Kompania		Qeveria qendrore		Donatorët (p.sh. GIZ)						
				€	%	€	%	€	%	€	%					
1	Rishikimi i rregullores për mbeturinat komunale nga Asambleja e Komunës për të pasqyruar ndryshimet e ligjit “Për Mbeturina”; rregullat për menaxhimin e mbeturinave nga ndërtimet e prishjet e ndërtesave dhe të mbetjeve të tjera inerte; dhe që specifikon qendrat grumbulluese dhe të pranimit të pajisjeve elektrike dhe elektronike dhe të mbeturinave të rrezikshme shtëpiake (bojë, medikamente, bateri)	□														
2	Rishikimi i statutit (neni 81 dhe 82) për të specifikuar MMN si një funksion të Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë	□														
3	Trajnim për inspektorët dhe zyrtarët e tjerë komunalë mbi zbatimin e rregulloreve të miratuara (përfshirë dhe ndëshkimet e gjobat)															
4	Përfshirja në të gjitha lejet për ndërtim dhe demolim që jep Komuna e vendit të deponisë të caktuar për dërgimin e mbeturinave inerte	□	90,000								• Institucionet shoqërore dhe private • Bizneset • Amvisëritë	• Kuvendi Komunal • Drejtoritë relevante (DShPE, DU, DI) • Kompania menaxhuese e deponisë	2016	2018	• Bizneset ndërtuese • Ekonomitë familjare • Institucionet	
5	Ngritja e një sistemi të informimit për qytetarët, stafin komunal dhe të kompanisë, për shkelje të rregullave për menaxhimin e mbeturinave komunale															
6	Ngritja e një sistemi për monitorim dhe raportim, mbi shkeljet e rregulloreve për menaxhimin e mbeturinave komunale															
7	Forcimi i rolit të inspektoratit të Komunës mbi përdorimin e parregullt të shportave publike, për mbetjet e eshtrave, hirit, qelqit dhe mbeturinave ndërtimore	□														
8	Shqyrtimi i përparësive për menaxhimin e mbeturinave komunale dhe rishikimi i strategjive përkatëse në pasqyrimin dhe integrimin në fushat e tjera prioritare															
9	Rritja e buxhetit komunal, vjetor dhe atij afatmesëm të komponentëve	□														

Plani i Menaxhimit të Mbeturinave i Drenasit

Nr.	Masa	Prioritet për vitin 2016	Vlera (€)	Kontributi financiar								Aktorët	Partnerët	Fillimi	Fundi	Grupet e synuara
				Komuna		Kompania		Qeveria qendrore		Donatorët (p.sh. GIZ)						
				€	%	€	%	€	%	€	%					
	për masat në menaxhimin e mbeturinave komunale, përfshirë përmirësimin e shërbimeve në menaxhimin e mbeturinave, mbledhjen e ndarë, aktivitete të vetëdijësimit dhe pastrimin e zonave të ndotura															
10	Perpilimi, miratimi dhe përditësimi, çdo vit, i politikave tarifore për menaxhimin e mbeturinave komunale: bazuar në kategorizimin e klientëve, mbetjet inerte, prodhuesit e mbeturinave të kafshëve, vendndodhjen dhe llojin e biznesit, madhësinë dhe gjendjen ekonomike të amvisërisë	□														
11	Raportimi i organeve përgjegjëse të Komunës çdo vit mbi gjendjen për menaxhimin e mbeturinave komunale në Kuvendin Komunal dhe në Ministrinë MMPH															
12	Ngritja dhe pajisja e njësisë komunale për menaxhimin e mbeturinave komunale brenda Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë	□	17,700								• Komuna • Kompania për MMN • Klientët	• Kryetari i Komunës • Komuna (DShPE) • Donatorët	2017	2018	• Komuna (DShPE) • Kompania • Klientë	
13	Krijimi i platformës për bashkëpunim me qeverinë qendrore mbi çështjet e MMN, duke përfshirë shkëmbimin periodik të informacionit															
14	Krijimi i platformës për bashkëpunim me ekspertë të mbeturinave të kompanisë RMM, universitetin dhe OJQ-të															
15	Trajnimi i grupeve punuese dhe menaxherëve komunalë mbi buxhetimin për MMN, përcaktimin e tarifave dhe çështje të tjera të MMN; trajnimi i personelit përgjegjës për komunikimet komunale rreth çështjeve të MMN															
16	Shkëmbimi i përvojave me komuna të tjera në fushën e MMN	□	2,500								• Komuna e Drenasit dhe Komunitat partnere • Kompania për menaxhimin e mbeturinave (“Pastrimi”) • OJQ	• Komuna • Kompania për menaxhimin e mbeturinave (“Pastrimi”) • Donatorët e mundshëm të jashtëm dhe të brendshëm	2016	2020	• Komunitat partnere • Kompanitë regionale për MMN	
17	Aftësimi i stafit për përpilimin e projekteve mbi aplikimin për fonde për aktivitete të lidhura me mbeturinat dhe pastrimin, në partneritet me sektorin privat dhe publikun															
18	Bërja e marrëveshjeve dhe nxitja e iniciativave të bashkëpunimit me OJQ-të që mbështesin aktivitete në fushën e menaxhimit të mbeturinave															
19	Ngritja e zyrës së informacionit dhe telefonit të gjelbër (24h) për menaxhimin e mbeturinave komunale															
20	Ngritja e sistemit për monitorimin dhe raportimin periodik mbi performancën e kompanisë RMM dhe performancën e menaxhimit të mbeturinave															
21	Sigurimi nga Komuna që kompanitë që ofrojnë shërbimin e menaxhimit të mbeturinave komunale kanë licencën përkatëse															

Plani i Menaxhimit të Mbeturinave i Drenasit

Nr.	Masa	Prioritet për vitin 2016	Vlera (€)	Kontributi financiar								Aktorët	Partnerët	Fillimi	Fundi	Grupet e synuara
				Komuna		Kompania		Qeveria qendrore		Donatorët (p.sh. GIZ)						
				€	%	€	%	€	%	€	%					
22	Paraqitja në Komunë e planeve afatmesme dhe afatgjata të investimeve nga kompania RMM															
23	Publikimi nga Kompania RMM i raportit vjetor të auditimit të aktivitetit															
24	Zgjerimi i zonës së shërbimit bashkëngjitur zonave aktuale të shërbimit, duke përdorur kontenierë 120l dhe 240l	□	186,869								• Departamenti i Shërbimeve Publike • Te gjithë individët apo familjet e zonës • OJF, sidomos ato mjedisore • Kompania që ofron shërbimin • Vendbanimet e tjera	• Komuna Drenas • Keshilli • Donatorë (GIZ, KfW)	2015	2016	• 1,713 familje ose 11,202 banorë • 4 biznese të mëdhenj • 32 të vegjël • 11 institucione	
25	Përfshirja e të gjitha bizneseve dhe institucioneve të zonës urbane në shërbimin e mbeturinave	□	9,000								• Komuna • Kompania • Banorët	• Komuna (DI, DSHPE) • Kompania • OJQ	2016	2017	• Institucionet • Bizneset	
26	Blerja e automjeteve me mekanizmin përkatës për marrjen automatike të kontenierëve 120l dhe 240l për të mbuluar itineraret e reja	□	120,000								• Kompania • Komuna • Fshatrat (të cekura në rezultatet e pritshme)	• Komuna • Kompania • Donatorë	2016	2018	• 3.695 familje ose 26.143 banorë • Bizneset dhe institucionet (në këto fshatra)	
27	Vazhdimi i zgjerimit të shërbimit të mbeturinave në të gjithë territorin e Komunës dhe përfshirja e të gjithë prodhuesve të mbeturinave në sistemin e faturimit															
28	Riorganizimi i pikave të grumbullimit të mbeturinave bazuar mbi udhëzimet kombëtare dhe lokale	□	81,185	6,750	8	20,620	25			53,815	66	• Komuna • Kompania • Institucionet • Bizneset • Ekonomitë familjare	• Komuna • Kompania • Institucionet • Bizneset • Ekonomitë familjare • Donatorët • OJQ	2016	2017	• 1.378 familje ose 7.114 banorë • 533 biznese • 25 institucione
29	Identifikimi i përparësive për grumbullimin e mbeturinave nga ana e operatorëve privat në zona të caktuara															
30	Krijimi i sistemit për grumbullimin ose dorëzimin e mbeturinave të vëllimshme															
31	Caktimi i buxhetit për zbrazjen e shportave publike të vendosura në rrugë dhe sheshe															
32	Grumbullimi i të dhënave dhe rishikimi i sistemit për mbledhjen e sigurt të mbeturinave mjekësore, duke përfshirë monitorimin e zbatimit të kontratës nga ana e institucioneve shëndetësore															
33	Grumbullimi periodik nga agjencitë qeveritare qendrore i të dhënave mbi sasi të dhe llojet e mbeturinave të rrezikshme të prodhuara në komunë															
34	Bërja e analizës për vlerësimin e llojeve dhe sasisë së mbetjeve të															

Plani i Menaxhimit të Mbeturinave i Drenasit

Nr.	Masa	Prioritet për vitin 2016	Vlera (€)	Kontributi financiar								Aktorët	Partnerët	Fillimi	Fundi	Grupet e synuara
				Komuna		Kompania		Qeveria qendrore		Donatorët (p.sh. GIZ)						
				€	%	€	%	€	%	€	%					
	rrezikshme shtëpiake															
35	Krijimi i sistemit të grumbullimit të pajisjeve elektrike e elektronike dhe mbeturinave të tjera shtëpiake të rrezikshme (bojë, medikamente, bateri)															
36	Krijimi dhe mirëmbajtja e regjistrit të llojeve të mbeturinave dhe proceseve përkatëse të përpunimit të tyre															
37	Analiza e përbërjes dhe sasive të mbeturinave komunale															
38	Vlerësimi i sasisë së mbeturinave shtazore, të gjeneruara në tregun Komoran, Drenas dhe të prodhuesve të tjerë															
39	Krijimi i sistemit për të vlerësuar sasinë e mbetjeve inerte dhe ndërtimore të prodhuara	□														
40	Vlerësimi i sasisë dhe llojeve të mbeturinave të ndara në mënyrë joformale për riciklim															
41	Zbatimi i masave pilot për grumbullimin e ndarë të mbetjeve të riciklueshme të thata në institucione (plastikë, metale, letër)	□														
42	Krijimi i sistemit për grumbullimin e ndarë të mbeturinave në komunë dhe mbeturinave të kopshtarisë															
43	Inkurajimi kompostimit, veçanërisht në zonat rurale të përzgjedhura	□														
44	Hartimi i studimit mbi përdorimin e mbetjeve inerte në proceset e ndryshme, si një alternativë ndaj deponimit	□														
45	Hulumtimi i operatorëve ekonomik që merren me trajtimin e mbetjeve të riciklueshme të thata, duke përfshirë mbetjet e qelqit si dhe lidhja e kontratës me kompani riciklimi për blerjen e mbetjeve të riciklueshme	□														
46	Trajnimi i stafit komunal mbi aspektet e 3R, kompostimit dhe bashkëpunimi me sektorin privat për kompostimin															
47	Përmirësimi i kushteve për grumbulluesit joformalë të materialeve të riciklueshme															
48	Bërja e analizës për mundësinë e krijimit të qendrës së dorëzimit të materialeve të riciklueshme (buy-back) me sektorin privat	□														
49	Vënia në funksionim të plotë e stacionit të transferimit	□	58,000									• Komuna • Kompania “Pastrimi” • Kompani të tjera, private • OJQ	• Komuna • Kompania “Pastrimi” • KEDS (KEK) • Ujësjetësi • Kompanitë private të interesuara • OJQ	2017	2020	Kompania “Pastrimi” (me theks të veçantë punëtorët në srtacionin e transferit)
50	Vlerësimi i kapaciteteve të transportit në distancë për të përcaktuar përdorimin optimal të automjeteve dhe të kapaciteteve															
51	Hulumtimi i mundësisë për ngritjen e infrastrukturës për ndarjen e mbeturinave															
52	Përditësimi dhe mirëmbajtja e bazës së të dhënave mbi deponitë ilegale, identifikimi i deponive joformale dhe krijimi i sistemit të monitorimit dhe raportimit															

Plani i Menaxhimit të Mbeturinave i Drenasit

Nr.	Masa	Prioritet për vitin 2016	Vlera (€)	Kontributi financiar								Aktorët	Partnerët	Fillimi	Fundi	Grupet e synuara
				Komuna		Kompania		Qeveria qendrore		Donatorët (p.sh. GIZ)						
				€	%	€	%	€	%	€	%					
53	Rehabilitimi i territoreve të pastruara nga deponitë ilegale	□														
54	Përpilimi i marrëveshjeve të bashkëpunimi me komunat fqinje për të parandaluar hedhjen e paligjshme të mbeturinave dhe ndotjen e trupave ujore të përbashkët															
55	Përpilimi i një raporti në bashkëpunim me Komunën e Prishtinës dhe dërgimi i një kërkesë të përbashkët kompanisë së Deponisë së Mirashit për përmirësimin e standardeve të funksionimit të deponisë së Mirashit															
56	Përgatitja për operim e deponisë për mbeturinat inerte dhe ndërtimore															
57	Monitorimi i sasisë së mbetjeve mjekësore të trajtuara në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF)															
58	Nisja e grumbullimit të ndarë të mbeturinave të rrezikshme shtëpiake dhe deponimi i përkohshëm nëpërmjet një ekipi lëvizës për grumbullim															
59	Bërja e fushatës vetëdijësuese me të gjithë komunitetin e zonës ku planifikohet zgjerimi i shërbimit, p.sh. Llapushnik, Baice, Çikatovë, me informacion në lidhje me përgjegjësitë e ndërsjellta për menaxhimin e mbeturinave dhe dobietë e tij për shëndetin dhe sigurinë e çdo konsumatori	□														
60	Krijimi i një linku në webfaqen e komunës për të ofruar informacion mbi shërbimet, praktikat e grumbullimit të mbeturinave	□														
61	Bërja e fushatës vetëdijësuese në komunitet mbi praktikat e menaxhimit të mbetjeve, duke përfshirë 3R															
62	Komunikimet e rregullta për opinionin qytetar përmes anketave për çështje të MMN që prekin komunitetin	□														
63	Organizimi i takimeve me ndërtuesit për nisjen dhe rregulloren e funksionimit të deponisë së mbetjeve inerte	□	500								• Komuna • Banorët & bizneset	• Komuna • Kompanitë private ndërtuese • Qytetarët • OJQ	2016	2017	Ndërmarrjet private	
64	Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve informative mbi ndikimin e mbetjeve të rrezikshme në shëndetin e njeriut dhe në mjedis															
65	Bërja e fushatës vetëdijësuese me prodhuesit e mbetjeve shtazore në dy tregjet kryesore blegtorale, për çështjet e shëndetit që shkaktojnë mostrajtimi dhe asgjësimi i papërshtatshëm															
66	Monitorimi i të ardhurave nga tarifat aktuale dhe potencialet e të ardhurave, në të gjithë territorin e komunës	□														
67	Konsolidimi dhe mirëmbajtja e regjistrit të saktë të klientëve në komunë: banorëve, bizneseve dhe institucioneve	□														
68	Analizimi i skenarëve për mbulimin e kostos nga të ardhurat e tarifave të mbeturinave, duke marrë në konsideratë grupet e marginalizuara	□														
69	Përgatitja e një studimi mbi sistemet e grumbullimit të tarifave për amvisëritë, bizneset dhe institucionet (p.sh. komuna mbledh taksat vetë ose përmes agjentëve)	□														

Plani i Menaxhimit të Mbeturinave i Drenasit

Nr.	Masa	Prioritet për vitin 2016	Vlera (€)	Kontributi financiar								Aktorët	Partnerët	Fillimi	Fundi	Grupet e synuara
				Komuna		Kompania		Qeveria qendrore		Donatorët (p.sh. GIZ)						
				€	%	€	%	€	%	€	%					
70	Instalimi i sistemit TIK për kontabilitetin, lidhur me llojet e konsumatorëve dhe shumat e mbeturinave të grumbulluara dhe asgjësuar															
71	Ndërtimi dhe funksionalizimi i mekanizmit që mundëson faturimin e të gjithë klientëve që marrin shërbimin e grumbullimit dhe largimit të mbeturinave															
72	Stimulimi i paguesve të rregullt përmes politikës fiskale lehtësuese															
73	Dizenjimi dhe prezantimi i stemës së gjelbër për bizneset paguese															
	Total	28	565,754	6,750		20,620				53,815						

7 Monitorimi dhe rishikimi

Matrica operative e lartpërmendur i përfshin masat, programet, objektivat dhe treguesit relevant që e mundësojnë monitorimin e zbatimit të planit. Një matricë e dytë ndërtohet edhe për futjen e të dhënave themelore, planin kohor dhe të dhënat financiare, duke e ofruar planin me një tërësi mjetesh që e mundësojnë monitorimin gjithëpërfshirës të zbatimit të tij.

Këto dy matrica e paraqesin planin në një format lehtësisht të qasshëm dhe të vlerësueshëm, si në aspektin sasior, edhe në atë cilësor. Kjo përfshin strukturën e planit, nga lista e masave e deri te vizioni. Posa të përcaktohet statusi i secilës masë, mund të përcaktohet edhe statusi i secilit nivel tjetër më të lartë në hierarki.

Në ndërkohë, emërimi i një personi kontaktues përgjegjës për monitorimin e progresit të një mase është qenësor për suksesin e planit. Pa një emërim të tillë, masat rrezikojnë që të mbeten të pamonitoruara nga administrata. Në ndërkohë, Drejtoria për Shërbime Publike do të jetë përgjegjëse për bashkërendimin, monitorimin dhe përpilimin e një raporti vjetor për progresin e arritjeve në realizimin e planit.

Është mençuri që plani të vlerësohet çdo vit, si pjesë e praktikave standarde të administratës. Kur të përgatitet buxheti vjetor, do të ishte praktikë e mirë që të vlerësohen matricat e planit. Qëllimi i përgjithshëm i një vlerësimi të tillë është që të ofrohen informata për marrjen e vendimeve për ta përmirësuar realizimin e planit dhe për t'i mbështetur vendimet që merren gjatë përgatitjes së buxhetit.

Vlerësimi dhe monitorimi ia mundësojnë administratës që të shohë nëse masat po zbatohen sipas planit dhe nëse rezultatet e arritura janë rezultate që janë planifikuar. Përgjigjet në këto pyetje çojnë në vendimet që do të merren në mënyrë që të përmirësohet realizimi i planit dhe të përmirësohen objektivat e planifikuara.

Vlerësimi i planit do të fillojë me gjendjen e zbatimit të masave komponentë të tij: një proces i thjeshtë që bëhet duke e numëruar numrin e masave që janë zbatuar, numrin e masave në proces të zbatimit dhe numrin e masave që ende nuk janë zbatuar. Numri i masave të zbatuara si proporcion i të gjitha projekteve të përfshira në plan shërben i pikë reference për ne (mesatarja në kuadër të tërë planit) për ta vlerësuar statusin e realizimit të niveleve të tjera të hierarkisë.

Krahasimi i gjendjes të zbatimit të programeve dhe objektivave mundëson që secili nivel të grupohet në njërin nga tri kategoritë në vijim:

- i) ato që janë në gjendje në apo mbi nivelin mesatar të zbatimit të masave në tërë planin (nivel i mirë).

ii) Ato që bien nën nivelin mesatar, por në të cilat së paku gjysma e masave janë realizuar apo janë në proces të realizimit (nivel mesatar).

iii) Ato në kuadër të të cilave më shumë ka masa që ende nuk kanë filluar se sa masa që janë duke u zhvilluar apo që janë përfunduar (nivel i ulët).

Në këtë mënyrë mund të skicohet përparimi në realizimin e planit, ku mund të shfaqen fushat në të cilat është bërë përparim i mirë dhe fushat në të cilat duhet të bëhet më shumë përparim. Trungu i gjendjes së zbatimit i koduar në ngjyra ofron një përshkrim vizual të qartë të gjendjes së pjesëve të ndryshme të strategjisë. Një shembull teorik i vlerësimit të zhvillimit është shfaqur në figurën 6. Në të janë përfshirë 98 projekte (masa), 13 përqind e të cilave janë realizuar, 30 përqind nga të cilat janë në realizim i sipër dhe realizimi i 57 përqind të të cilave ende mbetet të fillojë.




Figura 6: Trungu nga vlerësimi i një plani shabllon

Nëse ka masa që nuk kanë nisur të zbatohen dhe programe në të cilat është bërë pak përparim, duhet të pyetet nëse ato janë të realizueshme apo se cilat janë problemet që kanë rezultuar në një shkallë të ulët të realizimit. Një analizë e tillë do të çojë në vendime që do të merren për zbatimin më të mirë të këtyre masave dhe programeve me qëllim të avancimit të shkallës së zbatimit të tërë planit. Në ndërkohë, objektivat, programet dhe masat në të cilat është bërë përparim i mirë mund ta tërheqin vëmendjen për financim të mëtejshëm.

Pas një periudhe të paracaktuar (p.sh. pas 5 viteve), plani i menaxhimit të mbeturinave të ngurta do të ketë nevojë të rishikohet, duke u bazuar në ndryshimin e rrethanave në komunë dhe në përparimin e bërë në realizimin e planit.

8 Referencat

- Infrastruktur & Umwelt. 2012. *Koncepti i Menaxhimit të Mbeturinave për Komunën e Drenasit*. Nëntor 2012. GIZ, Komuna e Drenasit.
- Infrastruktur & Umwelt. 2012. *Plani Komunal i Menaxhimit të Mbeturinave i Drenasit: Punëtorja për Analizimin e Opsioneve*. Tetor 2012. GIZ, Komuna e Drenasit.
- Infrastruktur & Umwelt. 2012. *Plani Komunal i Menaxhimit të Mbeturinave i Drenasit: Punëtorja për Rezultatet dhe Planin e Veprimit*. Dhjetor 2012. GIZ, Komuna e Drenasit.
- Infrastruktur & Umwelt, **FAQËFLAG**. 2015. *Shtjellim i Studimit të Fizibilitetit për një Sistem të Integruar të Menaxhimit të Mbeturinave të Ngurta për Rajonin e Vlorës*. Draft, qershor 2015.
- GIZ. 2014. *Procesverbali i Punëtorisë për Menaxhimin e Mbeturinave*, Bogë. 30 dhe 31 korrik 2014.
- GIZ. 2015. *Dokument Koncepti për Stacionin e Transferit*. 2015.
- GIZ. 2015. *Dokument Koncepti për Qendrën e Qytetit të Drenasit*. 2015.
- CEDE. 2015. *Raport Mjor*. Mars 2015. GIZ, Komuna e Drenasit, “Pastrimi”.
- Agjencia e Statistikave të Kosovës. 2011. *Regjistrimi i Popullsisë 2011*. ask.rks-gov.net/rekos2011/?cid=2,1
- Agjencia e Statistikave të Kosovës. 2014. *Vjetari Statistikor, 2014*. ask.rks-gov.net/ENG/publikimet/cat_view/36-general-statistics
- Agjencia e Statistikave të Kosovës. 2014. *Anketa e Fuqisë Punëtore, 2014*. ask.rks-gov.net/ENG/labour-market/publications
- Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës. 2009. *Raport: Gjendja e Mbeturinave në Kosovë, 2008*.
- Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës. 2011. *Raport: Hotspotet Mjedisore në Kosovë*.
- Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës. 2014. *Raport: Gjendja e Mbeturinave dhe Kimikateve*.
- Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës. 2011. *Raporti i Auditimit për Komunën e Drenasit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010*.
- Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës. 2012. *Raporti i Auditimit për Komunën e Drenasit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011*.
- OSCE. 2014. *Profili i Komunës së Glogocit*.
- Komuna e Drenasit. 2009. *Strategjia e Zhvillimit Lokal*.
- Komuna e Drenasit. 2012. *Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Drenasit*. Nr. 501–1768, data 27/12/2012.

Komuna e Drenasit. 2013. *Buxheti Afatmesëm, 2014–2016*.

Komuna e Drenasit. 2014. *Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal, 2015–2019*.

Komuna e Drenasit. 2015. *Raporti i Kryetarit të Komunës për vitin 2014*.

Komuna e Drenasit. 2015. *Pyetësor: Vlerësimi i Gjendjes Aktuale të Menaxhimit të Mbeturinave të Ngurta*.

Planco Consulting. 2015. *Llogaritja e Kostos së Menaxhimit të Mbeturinave të Ngurta: Mësimet e Mësuara nga Peja dhe Drenasi*. GIZ, 16 mars 2015.

Republika e Kosovës. 2008. *Ligji Nr. 03/L-041 për Kufijtë Administrativë të Komunave*. Gazeta Zyrtare. gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2518

ZRRUM. 2010. *Licenca që i është dhënë Kompanisë Rajonale të Mbeturinave “Pastrimi”, Prishtinë*. Nëntor 2010.

9 Shtojca 1. Planet e veprimit (për masat)

Kjo shtojcë i mban planet e veprimit për masat prioritare për vitin 2016.

Për një regjistër për referencë të përhershme bëhet një plan i veprimit për secilën masë. Secili plan i veprimit përfshin një informacion përmbledhës për masën, numrin e matricës së masës, titullin, programin, një përmbledhje të masës, rezultatet e pritura, grupet e synuara, aktorët, kontribuuesit, parakushtet, rreziqet, financimin, personin kontaktues, kohëzgjatjen dhe kohën e ndikimit të pritur.

Nëse është e mundur, një tërësi e plotë e planeve të veprimit duhet të hartohet për secilën masë të paraqitur në planin e punës. Në kohën e rishikimit të planit, pas zbatimit të masës së veçantë, duhet të hartohet një tërësi e planeve të veprimit.

Nr. i Masës 4	Titulli i Masës: Përfshirja në të gjitha lejet për ndërtim dhe demolim që jep Komuna e vendit të deponisë së caktuar për dërgimin e mbeturinave inerte	Programi i PMM O1:PG2: Zbatimi i legjislacionit
Objektivi i PMM që synon të përmbushë masa: O1: Përmirësimi i kuadrit institucional për të arritur mbulimin e plotë të kostos përmes parimit 'ndotësi paguan'		
a. Përshkrim i shkurtër i masës i Situata (pëshkrim i shkurtër i problemit) - Në Komunën e Drenasit deri tani nuk ka pasur trajtim të mirëfilltë të mbeturinave inerte dhe kjo në vazhdimësi po paraqet probleme. Gjendja e trashëguar me këtë kategori të mbeturinave e ka bërë të domosdoshëm caktimin e lokacioneve për mbeturina inerte. Komuna e Drenasit deri tani ka caktuar 1 lokacion (viti 2015, në Komoran). - Caktimi i këtij lokacioni nuk i përmbush të gjitha nevojat për trajtim të kësaj kategorie të mbeturinave për shkak të distancës së fshatrave me deponinë e caktuar dhe të mënyrës së funksionimit. - Rëndësia e kësaj mase qëndron në trajtimin në mënyrë specifike të mbeturinave inerte nga gjeneruesit e këtij lloji mbeturinash. - Është e domosdoshme që të bëhet një analizë për nevojën e deponive të tjera varësisht nga koncentrimi i fshatrave dhe nr i banorëve. ii Synimi i masës Trajtimi në mënyrë të kontrolluar i mbetjeve inerte iii Aktivitete kyçe të masës: 1. Inicimi i nxjerrjes së vendimeve dhe rregulloreve që rregullojnë aspektet formale të funksionalizimit të deponive inerte 2. Eliminimi i deponive ilegale inerte 3. Rregullimi i infrastrukturës: rrethoja, sistemi i drenazhimit, ndriçimi, ujësjellësi, kanalizimi, sinjalistika, etj. 4. Data baza (të dhënat e deponimit, lloji i mbeturinave, sasia dhe faturimi) 5. Zbatimi i masës (blerja e mjeteve dhe pajisjeve)		
b. Rezultatet e pritshme - Eliminimi i deponive ilegale (inerte) - Funksionalizimi i plotë i deponisë (aspektet legjislative dhe operative) - Mbeturinat inerte deponohen në deponinë e caktuar (banorët përfitojnë me largimin e tyre – ambient i pastër)		c. Grupi/et e shënjestruara - Bizneset ndërtuese - Ekonomitë familjare (individët) - Institucionet
d. Palët e interesuara (stakeholdërsat) kryesore - Institucionet shoqërore dhe private - Bizneset - Amvisëritë		e. Kontribuesit e mundshëm për masën - Kuvendi Komunal - Drejtoritë relevante (DShPE, DU dhe DI) - Kompania menaxhuese e deponisë
f. Parakushtet - Statusi i deponisë inerte - Vendimet dhe aspektet ligjore të funksionimit		h. Faktorë rrezikues - Buxheti i limituar - Pengesat e banorëve përreth deponisë - Stafi menaxhues dhe mbikëqyrës (i deponisë) - Shkaqet natyrore (reshjet, era)
h. Shpenzimet e llogaritura sipas hapave në pikën ‘a.iii’ më sipër Aktiviteti 1. 0 € Aktiviteti 2. 10.000 € Aktiviteti 3. 50.000 € Aktiviteti 4. 0 € Aktiviteti 5. 30.000 € Gjithsej, 90.000 € (shuma e siguruar aktualisht, 10.000 €, ose 11%, burimi i financimit: Kuvendi Komunal & donatorët)		

i. Periudha e zbatimit të masës 2016–2018	j. Koha e ndikimit 2018
k. Personi i kontaktit për ndjekjen e zbatimit të masës dhe raportimin Drita Gjoka, 038585036, drita.gjoka@rks-gov.net	

Nr. i Masës 12	Titulli i Masës: Ngritja dhe pajisja e njësisë komunale për menaxhimin e mbeturinave komunale, brenda Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë	Programi i PMM: O1:PG4: Përmirësimi i njohurive dhe kapaciteteve komunale mbi MMN
Objektivi i PMM që synon të përmbushë masa: O1: Përmirësimi i kuadrit institucional për të arritur mbulimin e plotë të kostos përmes parimit 'ndotësi paguan'		
a. Përshkrim i shkurtër i masës i Situata (përshkrim i shkurtër i problemit) - Aktualisht në Komunën e Drenasit DShPE mbulon fushën e trajtimit të mbeturinave. Në kuadër të kësaj drejtorie është një person përgjegjës që ndër të tjera ka përshkrim të detyrave të punës edhe çështjen e mbeturinave, mirëpo është e nevojshme që kjo të jetë ose si njësi e veçantë ose zyrë që mbulon këtë sektor. - Nevoja për trajtim të veçantë në këtë sektor e bën të domosdoshme ngritjen e një njësie ose sektori për menaxhimin e mbeturinave. Kjo do të ishte shumë e rëndësishme për arsye se do të ketë vëmendje të veçantë dhe dihen përgjegjësit. ii Synimi i masës Menaxhimi i qëndrueshëm i mbeturinave komunale iii Aktivitete kyçe të masës: 1. Rishikimi i organogramit për ngritjen e këtij sektori ose zyre 2. Përshkrimi i detyrave të punës (termat e referencës; harmonizuar me masën 2) 3. Përzgjedhja e ekipit (zyrtarëve) 4. Pajisja e zyrës (me mjete të punës).		
b. Rezultatet e pritshme - Komuna krijon një sistem të mirëfilltë rreth menaxhimit të mbeturinave; monitorim, raportim dhe inicim - Mban komunikimin Komunë–Ministri, Komunë–Kompani, kontakte me klientët dhe kontakte me donatorët rreth menaxhimit të mbeturinave	c. Grupi/et e shënjestruara - Komuna (DShPE) - Kompania - Klientë	
d. Palët e interesuara (stakeholdersat) kryesore - Komuna - Kompania për MMN - Klientët	e. Kontribuesit e mundshëm për masën - Kryetari i Komunës - Komuna (DShPE) - Donatorët	
f. Parakushtet - Ana ligjore - Mundësitë buxhetore - Trajnimet	h. Faktorë rrezikues Vullneti politik	
h. Shpenzimet e llogaritura sipas hapave në pikën ‘a.iii’ më sipër Aktiviteti 3. 16.200 € (në vite) Aktiviteti 4. 1.500 € Gjithsej, 17.700 € (burimi i financimit: komuna 2017)		
i. Periudha e zbatimit të masës 2017–2018	j. Koha e ndikimit 2017	
k. Personi i kontaktit për ndjekjen e zbatimit të masës dhe raportimin Hyrije Xhemajli-Thaçi, Drejtorja për Shërbime Publike dhe Emergjencë, 038 585036, hyrijexhemajli@rks-gov.net		

Nr. i Masës 16	Titulli i Masës: Shkëmbimi i përvojave me komuna të tjera në fushën e MMN	Programi i PMM: O1:PG4: Përmirësimi i njohurive dhe kapaciteteve komunale mbi MMN
Objektivi i PMM që synon të përmbushë masa: O1: Përmirësimi i kuadrit institucional për të arritur mbulimin e plotë të kostos përmes parimit 'ndotësi paguan'		
a. Përshkrim i shkurtër i masës i Situata (përshkrim i shkurtër i problemit) - Bashkëpunimi ndërkomunal është një rrugë e rëndësishme për komunat në lidhje me ofrimin efikas dhe efektiv të shërbimeve rreth menaxhimit të mbeturinave - Me qëllim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve në fushën e menaxhimit të mbeturinave, Komuna e Drenasit e sheh të arsyeshme shkëmbimin e përvojave ndërmjet komunave të tjera - Me këtë rast do të ishte në interes ndërkomunal të mbahen konferenca të përbashkëta rreth përvojave të menaxhimit të mbeturinave - Shkëmbimi i përvojave me komunat: Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Ferizaj, etj. ii Synimi i masës Përfitimi i praktikave të mira nga komunat partnere iii Aktivitete kyçe të masës: 1. Zgjedhja e komunave partnere 2. Caktimi i përvojave ndërmjet komunave të tjera 3. Vizita studimore 4. Konferenca të përbashkëta rreth menaxhimit të mbeturinave		
b. Rezultatet e pritshme - Rritja e kapaciteteve dhe njohurive teknike dhe profesionale të punonjësve dhe stafeve të sektorit të MM - Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimit të MM si rezultat i aplikimit të praktikave më të mira të komunave partnere		c. Grupi/et e shënjestruara - Komunat partnere - Kompanitë regjionale për MMN
d. Palët e interesuara (stakeholders) kryesore - Komuna e Drenasit dhe Komunat partnere - Kompania për menaxhimin e mbeturinave ("Pastrimi") - OJQ		e. Kontribuesit e mundshëm për masën - Komuna - Kompania për menaxhimin e mbeturinave ("Pastrimi") - Donatorët e mundshëm të jashtëm dhe të brendshëm
f. Parakushtet - Ndarja e buxhetit - Inicimi për bashkëpunim nga Komuna		h. Faktorë rrezikues Mungesa e buxhetit
h. Shpenzimet e llogaritura sipas hapave në pikën ‘a.iii’ më sipër Aktiviteti 1. 0 € Aktiviteti 2. 0 € Aktiviteti 3. 1.000 € Aktiviteti 4. 1.500 € Gjithsej 2.500 € (burimi i financimit: komunat partnere dhe donatorët)		
i. Periudha e zbatimit të masës 2016–2020		j. Koha e ndikimit 2017
k. Personi i kontaktit për ndjekjen e zbatimit të masës dhe raportimin Hyrije Xhemajli-Thaçi, DSHPE, 038585036, hyrije.xhemajli@rks-gov.net		

Nr. i Masës 24	Titulli i masës: Zgjerimi i zonës së shërbimit bashkëngjitur zonave aktuale të shërbimit, duke përdorur kontenierë 120l dhe 240l	Programi i PMM: O2:PG1: Zgjerimi i shërbimit të grumbullimit të mbeturinave
Objektivi i PMM që synon të përmbushë masa: O2: Përmirësimi i shërbimit të pastrimit dhe grumbullimit të mbeturinave		
a. Përshkrim i shkurtër i masës i Situata (përshkrim i shkurtër i problemit) Komuna Drenas mbulon vetëm 51% të zonës me shërbim. Banorëve dhe bizneseve në vendbanimet në Bajicë, Çikatovë e Vjetër, Llapushnik, Polek i Vjetër, Dobroshec dhe Gllanasella nuk u ofrohet shërbimi i mbledhjes së mbeturinave të gjeneruara. Ka dy arsye që nuk ofrohet shërbimi në këtë zonë. Ka pamundësi financiare për të investuar dhe kompania nuk i mbledh mbetjet me pretekstin që këto vendbanime nuk paguajnë tarifën. Këto vendbanime janë rurale dhe ndodhen në territorin e Komunës Drenas, bashkëngjitur me vendbanimet ku është duke u kryer shërbim. Banojnë 11.202 banorë ose 1.713 familje, kryesisht në banesa private si dhe ushtrojnë aktivitetet 36 biznese dhe 11 institucione. Të gjithë i hedhin mbetjet në vendgrumbullime ilegale që janë 10, duke shkaktuar ndotje të mjedisit në përgjithësi. Shpesh ka dhe djegie të mbeturinave. Komuna mbështetur dhe në objektivat kombëtare, duke filluar nga viti 2016, do të shtrijë shërbimin edhe në këto vendbanime.		
ii Synimi i masës Vendbanimet e reja të Komunës Drenas të pastra dhe banorë të kënaqur me shërbimin e largimit të mbeturinave		
iii Aktivitete kyçe të masës: 1. Krijimi i bazës së të dhënave për zonën e zgjerimit të shërbimit (banesat, nr. i familjeve ose banesave, banorët, rrugët që lidhin banesat, bizneset, institucionet); evidentimi i vendgrumbullimeve informale të mbetjeve; llogaritja e gjenerimit të mbetjeve, struktura merceologjike (sipas llojit) 2. Pyetësor ose fokus grup me familjet & biznese, grupe interesi (për mënyrën & sistemin e ri të organizimit të shërbimit, tipin e kontenierëve, frekuencën e mbledhjes, orarin) 3. Organizimi i shërbimit (sistemi logjistik i shërbimit; hartëzimi, rrugët e lëvizjes, pikat e grumbullimit, kontenierët specifikë, kamionët, transferimi, transporti); itinerari efektiv i lëvizjes; rregullore për ofrimin e shërbimit (si do të mbledhen mbeturinat, datat, orët e mbledhjes, ku do të grumbullohen dhe ku do të trajtohen, kush është përgjegjës) 4. Zbatimi i masës (procedura dokumentacioni dhe tenderimi, vendimmarrje, blerja e pajisjeve; shpërndarja e kontenierëve në çdo familje, sistemi i monitorimit; kontraktimi i shërbimit sipas kostos së shërbimit).		
b. Rezultatet e pritshme - Banorët e zonës përfitojnë largimin e mbeturinave të ngurta - Familjet e zonës pajisen me kosha 120 litra - Mbetjet e gjeneruara depozitohen në deponi		c. Grupi/et e shënjestruara - 1.713 familje ose 11.202 banorë - 4 biznese të mëdhenj - 32 të vegjël - 11 institucione
d. Palët e interesuara (stakeholdërsat) kryesore - Departamenti i Shërbimeve Publike në Komunë - Të gjithë individët apo familjet e zonës - OJF, sidomos ato mjedisore - Kompania që ofron shërbimin - Vendbanimet e tjera		e. Kontribuesit e mundshëm për masën - Komuna Drenas - Këshilli - Donatorë (GIZ, KfW)
f. Parakushtet Vendimi i kuvendit komunal		g. Faktorë rrezikues - Grupe familjesh që nuk mbështesin procesin - Tërheqje e donatorit
h. Shpenzimet e llogaritura sipas hapave në pikën 'a iii' më sipër Aktiviteti ofrimi i shërbimit _____ € Kosto operimi 117.140 €		

Kosto kapitale 68.490 € Kosto deponimi 1.239 € Gjithsej, 186.869 € (burimi i financimit:)	
i. Periudha e zbatimit të masës 2015	j. Koha e ndikimit 2016
k. Personi i kontaktit për ndjekjen e zbatimit të masës dhe raportimin Shpend Bogiqi, DSHPE, 038585036, shpend.bogiqi@rks-gov.net	

Nr. i Masës 25	Titulli i Masës: Përfshirja e të gjitha bizneseve dhe institucioneve të zonës urbane në shërbimin e mbeturinave	Programi i PMM: O2:PG1: Zgjerimi i shërbimit të grumbullimit të mbeturinave
Objektivi i PMM që synon të përmbushë masa: O2: Përmirësimi i shërbimit të pastrimit dhe grumbullimit të mbeturinave		
a. Përshkrim i shkurtër i masës i Situata (përshkrim i shkurtër i problemit) Komuna e Drenasit, përkatësisht kompania “Pastrimi” ofron shërbim të organizuar të grumbullimit të mbeturinave në qendër (qytet) dhe në disa zona rurale (20 fshatra, mbi 50% e territorit), mirëpo edhe brenda zonës ku ofrohet shërbimi një numër i institucioneve, bizneseve dhe ekonomive familjare nuk i janë përgjigjur këtij shërbimi dhe si pasojë e kësaj gjendje, kemi mbeturina të patrajtuara brenda zonës së shërbimit.		
ii Synimi i masës Përfshirja e të gjitha institucioneve dhe bizneseve në sistemin e faturimit.		
iii Aktivitete kyçe të masës: 1. Identifikimi i institucioneve dhe bizneseve që nuk janë të përfshira në shërbim 2. Takime informuese (arsyet pse nuk janë në shërbim, obligimet ligjore, domosdoshmëria e pagesës për shërbimin dhe masat ligjore) 3. Shpërndarja e shportave (240l, ata që pranojnë) 4. Inspektimi i situatës (pas shpërndarjes).		
b. Rezultatet e pritshme - Përfshirja e të gjitha institucioneve dhe bizneseve në sistemin e menaxhimit të mbeturinave - Përmirësimi i situatës në terren - Ngritja e shkallës së inkasimit	c. Grupi/et e shënjestruara - Institucionet - Bizneset	
d. Palët e interesuara (stakeholdërsat) kryesore - Komuna - Kompania - Banorët	e. Kontribuuesit e mundshëm për masën - Komuna (DI, DSHPE) - Kompania - OJQ	
f. Parakushtet - Fuqizimi i inspektoratit - Fushata e vetëdijesimit (obligimet ligjore)	h. Faktorë rrezikues - Vullneti politik (roli dhe efikasiteti i inspektoratit) - Përcaktimi i tarifës; çmimi	
h. Shpenzimet e llogaritura sipas hapave në pikën ‘a.iii’ më sipër Aktiviteti 1. 500 € Aktiviteti 2. 1.000 € Aktiviteti 3. 7.500 € Aktiviteti 4. 0 € Gjithsej 9.000 € (shuma e siguruar aktualisht, 1.960 € , ose 21% burimi i financimit: Komuna & GIZ–ShQK)		
i. Periudha e zbatimit të masës 2016–2017	j. Koha e ndikimit 2017	
k. Personi i kontaktit për ndjekjen e zbatimit të masës dhe raportimin Haki Bekolli, Drejtoria e Inspeksionit, 049744796, haki.bekolli@rks-gov.net		

Nr. i Masës 26	Titulli i Masës: Blerja e automjeteve me mekanizmin përkatës për zbrazjen automatike të kontejnerëve 120l dhe 240l për të mbuluar territoret e reja	Programi i PMM: O2:PG1: Zgjerimi i shërbimit të grumbullimit të mbeturinave
Objektivi i PMM që synon të përmbushë masa: O2: Përmirësimi i shërbimit të pastrimit dhe grumbullimit të mbeturinave		
a. Përshkrim i shkurtër i masës i Situata (përshkrim i shkurtër i problemit) Automjetet që janë në dispozicion të KRM ““Pastrimi””–Drenas nuk sigurojnë vazhdim të zgjerimit të shërbimit në zona të tjera, për shkak të numrit të limituar dhe mungesës së mekanizmit përkatës. Për këtë arsye paraqitet domosdoshmëria e blerjes së automjeteve të reja me mekanizëm përkatës për marrjen automatike të kontejnerëve. ii Synimi i masës Blerja e automjeteve me mekanizmin përkatës për marrjen automatike të kontejnerëve 120l dhe 240l për të mbuluar territore të reja iii Aktivitete kyçe të masës: 1. Blerja e kamionit të ri me kapacitet 16 m ³ , me mekanizëm për ngritjen dhe zbrazjen e kontejnerëve për mbeturina me kapacitet 120l dhe 240l, si dhe kryerja e grumbullimit të mbeturinave në këto fshatra: Çikëtove e Vjetër, Llapushnik dhe Baicë 2. Blerja e 3 kamionëve të rinj me kapacitet 16 m ³ , me mekanizëm për zbrazjen e kontenierëve standard me kapacitet 1.1 m ³ dhe kontejnerëve me kapacitet 120l dhe 240l.		
b. Rezultatet e pritshme Do të bëhet grumbullimi i mbeturinave në këto fshatra: Çikëtove e Vjetër, Llapushnik, Baicë, Likoshan, Gradicë, Godancë, Gllanasellë, Shtuticë Polluzhë, Abri e Eperëme, Tërdec, Vuçak, Negroc, Arllat, Fushticë e Epërme, Fushticë e Ultë, Sankoc Vasilevë dhe Dobroshec		c. Grupi/et e shënjestruara - 3.695 familje ose 26.143 banorë - Bizneset dhe institucionet (në këto fshatra)
d. Palët e interesuara (stakeholdërsat) kryesore - Kompania - Komuna - Fshatrat (të cekura në rezultatet e pritshme)		e. Kontribuuesit e mundshëm për masën - Komuna - KRM ““Pastrimi”” - Donatorë
f. Parakushtet - Ndarja e buxhetit (Kompania dhe Komuna) - Procedurat e prokurimit (lehtësimet në prokurim) - Specifikacionet për automjete (madhësia, sasia, etj.)		h. Faktorë rrezikues Buxheti (ndarja paraprake)
h. Shpenzimet e llogaritura sipas hapave në pikën ‘a.iii’ më sipër Aktiviteti 1. 30.000 € Aktiviteti 2. 90.000 € Gjithsej, 120.000 € (shuma e siguruar aktualisht, 30.000 € , ose 25%, burimi i financimit: Komuna, KRM ““Pastrimi””, GIZ–ShQK)		
i. Periudha e zbatimit të masës 2016–2018		j. Koha e ndikimit 2017
k. Personi i kontaktit për ndjekjen e zbatimit të masës dhe raportimin Hyrije Xhamajli, DSHPE dhe KRM ““Pastrimi””, 038585036, 038588140, hyrije.xhamajli@rks-gov.net		

Nr. i Masës 28	Titulli i Masës: Riorganizimi i pikave të grumbullimit të mbeturinave bazuar mbi udhëzimet kombëtare dhe lokale	Programi i PMM: O3:PG1: Mbledhja dhe largimi i mbeturinave
Objektivi i PMM që synon të përmbushë masa: O3: Ndërtimi i sistemit modern, të integruar dhe efektiv të menaxhimit të mbeturinave me efikasitet të kostove dhe shtim të vlerës së parasë publike		
a. Përshkrim i shkurtër i masës i Situata (përshkrim i shkurtër i problemit) Në qytetin e Drenasit ofrohet shërbimi i grumbullimit të mbeturinave, mirëpo në vazhdimësi po paraqiten probleme si çështja e gjithëpërfshirjes, inkasimi dhe cilësia e shërbimit. Për këtë arsye është paraparë një masë e tillë për riorganizim, e cila ka për qëllim që të arrihet përmirësimi i shërbimit në qendër të qytetit, të përmirësohet standardi i shërbimit dhe të ndërtohet një eksperiencë e re e suksesshme dhe e qëndrueshme. ii Synimi i masës Vendosja e një sistemi funksional, i cili do të sigurojë komoditetin dhe kushte higjienike e mjedisore optimale për qytetarët, veprimtaritë ekonomike dhe institucionet që operojnë në zonën e shërbimit. iii Aktivitete kyçe të masës: 1. Përgatitja e specifikimeve teknike për kontejnerët, prokurimi dhe furnizimi 2. Përgatitja e specifikimeve teknike, skicave 3. Vendosja e një sistemi të pikave të grumbullimit & kontejnerëve të rinj në ato pika që nuk kërkojnë platforma të reja 4. Fillimi i fushatës së vetëdijesimit, vendosja e afisheve, fletët informuese, citylights, transmetimi i spotit TV 5. Blerja dhe instalimi i shportave rrugore 6. Identifikimi, krijimi i bazës së të dhënave për faturimin dhe inkasimin nga amvisëritë, bizneset dhe institucionet 7. Faturimi i të gjithë klientëve dhe forcimi i punës për mbledhjen e tarifës sipas skemës së aprovuar 8. Blerja e kontejnerëve (1.1m³, 240l) 9. Riparimi i kontejnerëve 10. Ndërtimi i platformave në pikat e grumbullimit për vendosjen e kontejnerëve 11. Ndërtimi i mbulesave për pikat e grumbullimit.		
b. Rezultatet e pritshme - Mbledhja dhe largimi i mbeturinave bëhet 1 herë në ditë, 7 ditët e javës - Përmirësimi i standardit të shërbimit - Sigurimi i një mjedisi të pastër që mbron shëndetin e qytetarëve dhe që inkurajon zhvillimin e biznesit në këtë zonë specifike të qytetit - Rritja e normës ose përqindjes së arkëtimit & inkasimit të pagesave nga tarifa e shërbimit nga të gjitha kategoritë e klientëve, veçanërisht nga bizneset (operatorët ekonomik) që veprojnë në këtë zonë - Ndërgjegjësimi dhe edukimi i banorëve dhe përfaqësuesve të bizneseve për mbajtjen pastër të mjedisit ku jetojnë dhe punojnë - Inspektimi dhe zbatimi i ligjit dhe rregulloreve për menaxhimin e mbetjeve	c. Grupi/et e shënjestruara - 1.378 familje ose 7.114 banore - 533 biznese - 25 institucione	
d. Palët e interesuara (stakeholders) kryes - Komuna - Kompania - Institucionet - Bizneset - Ekonomitë familjare	e. Kontribuesit e mundshëm për masën - Komuna - Kompania - Institucionet - Bizneset - Ekonomitë familjare - Donatorët - OJQ	
f. Parakushtet - Hartimi dhe aprovimi i planit për riorganizim	h. Faktorë rrezikues - Çështjet pronësore	

- Infrastruktura - Hapësira e nevojshme për caktimin e lokacioneve - Distanca mes pikave	- Hiri
h. Shpenzimet e llogaritura sipas hapave në pikën ‘a.iii’ më sipër Aktiviteti 1–4. 0 €; Aktiviteti 5. 29.315 €; Aktiviteti 6. 4.420 €; Aktiviteti 7. 0 €; Aktiviteti 8. 24.500 €; Aktiviteti 9. 2.700 €; Aktiviteti 10. 13.500 €; Aktiviteti 11. 6.750 €. Gjithsej, 81.185 € (shuma e siguruar aktualisht, 81.185 €, ose 100 %, burimi i financimit: Komuna dhe Kompania “Pastrimi”, në vlerën 20.620 € dhe GIZ, në vlerën 53.815 €)	
i. Periudha e zbatimit të masës 2016–2017	j. Koha e ndikimit 2016–2017
k. Personi i kontaktit për ndjekjen e zbatimit të masës dhe raportimin Drita Gjoka, DSHPE, 038585036, drita.gjoka@rks-gov.net	

Nr. i Masës 49	Titulli i Masës: Vënia në funksionim të plotë e stacionit të transferit	Programi i PMM: O6:PG1: Stacioni i transferimit dhe transporti në distancë
Objektivi i PMM që synon të përmbushë masa: O6: Deponimi i mbeturinave me standarde që garantojnë mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, të mjedisit dhe biodiversitetit		
a. Përshkrim i shkurtër i masës i Situata (përshkrim i shkurtër i problemit) - Komuna e Drenasit ka stacion transferi për mbeturina (në fshatin Çikatovë e Vjetër), i cili është nën menaxhim të kompanisë ““Pastrimi”” (njësia në Drenas). Për këtë menaxhim ka memorandum me komunën e Drenasit. Ky stacion transferi shërben për vendosjen e mbeturinave përkohësisht (mbeturinave ditore që grumbullohen), ka rol lehtësues për kompaninë, pasi zvogëlon koston e operimit dhe njëkohësisht siguron shërbim më efikas. - Gjendja në stacionin e transferit nuk ofron mundësi për trajtim të mirëfilltë të mbeturinave, për arsye se mungon funksionalizimi i peshores, energjia elektrike, uji dhe elementët e tjerë përcjellës.		
ii Synimi i masës Funksionalizimi i plotë i stacionit të transferit		
iii Aktivitete kyçe të masës: 1. Lidhja e ujit dhe energjisë elektrike 2. Shtrimi i platos në stacionin e transferit (në pjesën e mbetur) 3. Vënia në funksion e peshores 4. Trajnimi i personelit 5. Rehabilitimi i rrugës hyrëse 6. Shqyrtimi i mundësive për ndarje të mbeturinave në stacionin e transferit.		
b. Rezultatet e pritshme - Përfundimi i aktiviteteve të parapara në masë në mënyrë që të arrihet funksionalizimi - Përmirësimi i kushteve higjieno-sanitare dhe teknike për punonjësit e stacionit të transferit - Ndarja e mbeturinave në stacionin e transferit (krijimi i mundësive)		c. Grupi/et e shënjestruara Kompania ““Pastrimi”” (me theks të veçantë punëtorët në stacionin e transferit)
d. Palët e interesuara (stakeholdersat) kryesore - Komuna - Kompania ““Pastrimi”” - Kompani të tjera private që operojnë në sektorin e menaxhimit të mbeturinave - OJQ		e. Kontribuuesit e mundshëm për masën - Komuna - Kompania ““Pastrimi”” - KEDS (KEK) - Ujësjiellësi - Donatorët - Kompanitë private të interesuara - OJQ
f. Parakushtet - Marrëveshja e pranim – dorëzimit - Marrëveshja me palët e tjera të interesit që janë kontribues në funksionalizim		h. Faktorë rrezikues - Aspektet buxhetore - Pronësia - Efektet negative mjedisore
h. Shpenzimet e llogaritura sipas hapave në pikën ‘a.iii’ më sipër Aktiviteti 1. 26.000 € Aktiviteti 2. 15.000 € Aktiviteti 3. 500 € Aktiviteti 4. 500 € Aktiviteti 5. 16.000 € Aktiviteti 6. Nuk kemi ende planin konkret se çfarë do të vendoset në këtë qendër transferi		

Gjithsej, 58.000 € (burimi i financimi: komuna, donatorët, kompania)	
i. Periudha e zbatimit të masës 2017–20	j. Koha e ndikimit 2018
k. Personi i kontaktit për ndjekjen e zbatimit të masës dhe raportimin Hyrije Xhamajli, DShPE dhe KRM ““Pastrimi””, 038585036, 038588140, hyrije.xhamajli@rks-gov.net	

Nr. i Masës 63	Titulli i Masës: Organizimi i takimeve me ndërtuesit për nisjen dhe rregulloren e funksionimit të deponisë së mbetjeve inerte	Programi i PMM: O7:PG2: Ndërgjegjësim dhe informim mbi mbetjet specifike me prodhuesit
Objektivi i PMM që synon të përmbushë masa: O7: Angazhimi aktiv i komunitetit dhe partnerëve në uljen e sasisë së prodhimit dhe në menaxhimin mjedisor të mbeturinave		
a. Përshkrim i shkurtër i masës i Situata (përshkrim i shkurtër i problemit) - Komuna e Drenasit ka marrë një seri masash për largimin e deponive ilegale në hapësira publike, të krijuara me mbeturina të llojeve të ndryshme, por një problem mjaft i madh po del të jetë edhe hedhja e mbetjeve inerte (ndërtimore) në hapësirat publike. - Hedhja e këtyre mbeturinave në hapësira publike po e shëmton imazhin e ambientit ku jetojmë dhe veprojmë. Pikërisht për këtë arsye Komuna ka caktuar një lokacion për deponimin e mbetjeve inerte (ndërtimore) dhe të gjitha kompanitë dhe individët obligohen që t'i hedhin mbeturinat inerte në këtë deponi. - Komuna ka paraparë një seri të aktiviteteve dhe takimeve me ndërtuesit dhe qytetarët për mënyrën e shfrytëzimit të kësaj deponie. ii Synimi i masës Në hapësirat publike të mos ketë mbeturina inerte (ndërtimore) iii Aktivitete kyçe të masës: 1. Identifikimi i ndërmarrjeve ndërtuese 2. Takime me kompanitë ndërtuese të objekteve afaristo-banesore, për informimin rreth lokacionit të Deponisë dhe masat që duhet të merren gjatë deponimit të mbetjeve inerte 3. Përgatitja e broshurave për rëndësinë e menaxhimit të mbeturinave inerte.		
b. Rezultatet e pritshme - “Pastrimi” i deponive të mbetjeve inerte - Të gjitha kompanitë private ndërtuese të obligohen për hedhjen e materialeve ndërtimore në deponi		c. Grupi/et e shënjestruara Ndërmarrjet private
d. Palët e interesuara (stakeholdersat) kryesore - Komuna e Drenasit - Banorët dhe bizneset		e. Kontribuuesit e mundshëm për masën - Komuna - Kompanitë private ndërtuese - Qytetarët - OJQ
f. Parakushtet - Funksionalizimi i plotë i deponisë së inerteve (ndërtimore) - Informimi i banorëve dhe bizneseve		h. Faktorë rrezikues Mosfunksionalizimi i plotë i deponisë
h. Shpenzimet e llogaritura sipas hapave në pikën ‘a.iii’ më sipër Aktiviteti 1. 0 € Aktiviteti 2. 0 € Aktiviteti 3. 500 € Gjithsej, 500 € (burimi i financimit: komuna dhe donatorët)		
i. Periudha e zbatimit të masës 2016–2017		j. Koha e ndikimit 2016
k. Personi i kontaktit për ndjekjen e zbatimit të masës dhe raportimin		



Plani i Menaxhimit të Mbeturive të Drenasit



11 Shtojca 3: Lista e njerëzve që i kanë kontribuar përpilimit të planit të MMN-së të Drenasit

1.
2.
3.
- 4.
- 5.
- 6.
- 7.
- 8.
- 9.
10. Arben Nika
11. Astrit Bilalli
12. Visar Gashi

12 Shtojca 4: Vendimi i Këshillit Komunal të Drenasit për Planin Komunal të Menaxhimit të Mbeturinave, Komuna e Drenasit 2015–2020